



European
Union
Kosovo

Analiza Gjimore e Kosovës



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

Analiza Gjimore e Kosovës

© Rrjeti i Grave të Kosovës 2018

Autorë: Nicole Farnsworth, Donjeta Morina, David JJ Ryan, Gresa Rrahmani, Vanessa Robinson-Conlon dhe Iliriana Banjska për Rrjetin e Grave të Kosovës

ISBN 978-9951-737-27-2

Ky botim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Rrjetit të Grave të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret për të pasqyruar pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Botimi është realizuar me shtyp eko-miqësor.

Falënderimet

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) falënderon zyrën e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë që ia ka besuar RrGK-së detyrën e rëndësishme të përgatitjes së kësaj analize gjinore për të informuar programimin e BE-së në të ardhmen në Kosovë.

Në punën kërkimore dhe në hartimin e kësaj analize punoi me zell ekipi i përbërë nga Nicole Farnsworth, Donjeta Morina, David JJ Ryan, Gresa Rrahmani, Vanessa Robinson-Conlon dhe Iliriana Banjska. Kërkimtarë dhe hartues të tjerë që kontribuan në pjesë të ndryshme të raportit janë Andrea Pulido, Adelina Berisha, Dardan Hoti, Lauren Hanna dhe Miranda Avdullahu. Autorët e falënderojnë drejtoreshën ekzekutive të RrGK-së, Igballë Rogova, menaxheren e financave, Besa Shehu, dhe anëtarët tjerë të stafit të RrGK për mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

Kjo analizë nuk do të ishte e mundur pa kontributin e respondentëve të intervistave, të renditur te Shtojca 1. Autorët falënderojnë recensentët për sugjerimet e tyre të dobishme: Agnieszka Stolarczyk, këshilltare e lartë, Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë; Ajete Kërqeli, eksperte për çështje gjinore, Brikena Hinterberger, bashkëpunëtoresh pranë Programit për Çështje Gjinore, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë; Lina Andeer, këshilltare për çështje gjinore, Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX); Luljeta Demolli, drejtore ekzekutive, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ); Selma Cekic-Dincsoy, pikë fokale për barazi gjinore, Zyra e Bashkimit Evropian (ZBE) në Kosovë; Ulf Färnsveden, kreu i bordit, Nordic Consulting Group; Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Misioni në Kosovë; Valentina Bejtullahu, zyrtare vendore e programit, Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, OSBE, Misioni në Kosovë; dhe Violeta Rexha, specialiste për përfshirje shoqërore dhe çështje gjinore pranë Fondacionit të Mijëvjeçarit në Kosovë.

Ekipi falënderon gjithashtu të gjithë ata që morën pjesë në konsultimet lidhur me metodologjinë (Shtojca 2) dhe në procesin e verifikimit me hisedarët (Shtojca 3).

Përmbajtja

Shkurtesat.....	ii
Përmbledhje ekzekutive.....	I
Gjetjet kyçe	I
Objektivat potencialë të PVGJ-së.....	4
Ku mund të japë vlerë të shtuar BE-ja.....	4
Hyrja	7
Metodologjia	8
Kufizimet.....	8
Mbi përmbajtjen e analizës gjinore.....	8
Demokracia dhe qeverisja	9
Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore	15
Të drejtat e pronës dhe trashëgimisë	16
Drejtësia dhe institucionet përgjegjëse	18
Kryesit e krimeve	22
Dhuna në bazë gjinore	23
Dhuna seksuale e lidhur me konfliktin	28
Të drejtat LGBTQI	30
Të drejtat fetare	32
Kthimi dhe riatdhesimi	33
Kapitali njerëzor: Arsimi dhe punësimi	34
Arsimi	34
Punësimi	38
Konkurrueshmëria dhe novacioni	44
Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit.....	46
Bujqësia.....	47
Energjia	48
Mjedisi.....	50
Transporti.....	52
Shëndetësia.....	53
Punimet e cituara	58
Ligji.....	58
Të tjera	65
Shtojcat.....	71
Shtojca 1. Lista e të intervistuarve.....	71
Shtojca 2. Pjesëmarrësit në Analizën Gjinore, konsultimi me palët e interesit	73
Shtojca 3. Personat e konsultuar në verifikimin e palëve të interesit	74
Shtojca 4. Harta e aktorëve kryesorë	75
Shtojca 5. Kërkesat e Analizës Gjinore dhe Termat e Referimit	92
Shtojca 6. Të dhëna shtesë që lidhen me secilin sektor	96
Shtojca 7. Harta e boshllëqeve në informacion	121
Shtojca 8. Prioritetet Tematike të PVGJ II - Të dhënat e pikënisjes për Kosovën.....	124
Shënime	134

Shkurtesat

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
ARE	Agjenda për Reforma Evropiane
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
D4D	Demokracia për Zhvillim
DPS	Dokumenti i Planifikimit Sektorial
DSI	Dokument Strategjik Indikativ
DV	Dokumentet e Veprimit
DHNGV	Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
EULEX	Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë
GIZ	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit</i>
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IPA	Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimit
IUD	Spiralja intrauterine
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KAZH	Komiteti i Asistencës për Zhvillim
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni Evropian
KEDS	Kompania Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIBP	Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KRBE	Kuadri i Rezultateve të BE-së
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
LGBTQI	Lezbike, Gej, Biseksual, Transgjinor, Queer dhe Interseks
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MIE	Ministria e Integritetit Evropian
MKBGJ	Mekanizmat Kombëtarë për Barazi Gjinore, ku përfshihen ABGJ-ja dhe ZBGJ-ja
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NDI	Instituti Demokratik Kombëtar
NEET	As në arsim, as në punësim, ose në trajnim
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OGSHC	Organizatat e Grave të Shoqërisë Civile
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
OPDAT	Zyra për Trajnim dhe Asistencë Zhvillimore Prokuroriale përtej Oqeanit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve

PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
PPSP	Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat
PVGJ	Plani i Veprimit Gjinor
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
RAE	Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptianë
RAP	Reforma e Administratës Publike
RKSOKB I 325	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara I 325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
Sida	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
SKMDHF	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
STIKK	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës
SZHQ	Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VNGJ	Vlerësimet e Ndikimit Gjinor
YIHR	Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian
ZBGJ	Zyrtar për Barazi Gjinore
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
ZP	Zyrtar e Punësimit
ZHSP	Zhvillimi i Sektorit Privat

Përmbledhje ekzekutive

Dokumenti i përbashkët i punës së stafit të Komisionit Evropian (KE) në temën: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: Transformimi i jetëve të vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020”, i njohur edhe si Plani i Veprimit Gjinor II (PVGJ II) i BE-së, iu bënë thirrje misionëve të BE-së që të kryejnë analiza gjinore për të informuar programimin në të gjithë sektorët. Zyra e Bashkimit Evropian (ZBE) në Kosovë ndau kontratën për këtë Analizë Gjinore për të ndihmuar në identifikimin e objektivave, treguesve, të dhënave të pikënisjes dhe caqeve lidhur me PVGJ II. Puna kërkimore me metoda të kombinuara përfshiu kërkimin në tavolinë, analizën e politikave, mbledhjen e të dhënave statistikore dhe intervistat me aktorët kryesorë në secilin sektor, që u realizuan më 2017 dhe 2018.

Gjetjet kyçe

Gjetjet përqendrohen në pabarazitë më të mëdha gjinore që, hëpër hë, ekzistojnë në Kosovë në lidhje me secilin nga sektorët e mëposhtëm, sipas gjendjes në vitin 2017.

Qeverisja dhe demokracia

- Gratë, duke përfshirë gratë nga pakicat kombëtare, mbeten të nënpërfaqësuar si zyrtare të zgjedhura në kuvendet komunale (35%) dhe në Kuvend të Kosovës (32%); si nëpunëse civile në pozita të larta vendimmarrëse në nivel komunal (20%) dhe në nivel kombëtar (27%); në poste politike si kryetare të partive, ministre (2 nga 21) dhe kryetare të komunave (0 nga 38); si dhe në dialog dhe negociatë.
- Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) ende nuk është institucionalizuar plotësisht, përkundër përmirësimeve, siç është përmendja e rregullt e BPGJ-së në qarkoret buxhetore, dorëzimi i të dhënave të zbërthyer sipas gjinisë nga disa ministri dhe komuna, dhe njohuritë e përmirësuara të ca zyrtarëve në vitet e fundit rreth BPGJ-së.
- Pjesa më e madhe e legjislacionit primar dhe sekondar në Kosovë nuk e përfshin pikëpamjen gjinore, duke mos vënë në shënjestër nevojat dhe prioritetet potencialisht të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve.
- Organizatat e grave të shoqërisë civile (OGSHC) dhe mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore (MKBGJ) nuk janë konsultuar sa duhet gjatë procesit të hartimit të ligjeve dhe politikave.

Sundimi i ligjit dhe liritë themelore

- Përkundër përmirësimeve, gratë në masë të madhe ende zotërojnë shumë më pak pasuri (17% të pronave) sesa burrat.
- Në krahasim me gratë, gjasat janë shumë më të mëdha që burrat të kryejnë krime dhe të dënohen. Në vitin 2015, prej 16,344 personave madhorë të dënuar nga gjykatat themelore, 95% ishin burra. Në vitin 2016, nga 692 të mitur të dënuar, 96% ishin djem.
- Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në radhët e policisë (14%), prokurorëve (31%) dhe gjyqtarëve (27%), veçanërisht në nivelet vendimmarrëse.
- Niveli i njohurive dhe qëndrimet në radhët e disa policëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve mund të pengojnë qasjen në drejtësi për gratë, veçanërisht lidhur me rastet e dhunës në bazë gjinore.
- Mungesa e sistemit informatik ndërinstitucional për të dhëna dhe menaxhim të lëndëve që do të përfshinte të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë e bën të vështirë të përcillet nëse gratë dhe burrat kanë qasje të barabartë në drejtësi, duke përfshirë edhe dhunën në bazë gjinore.
- Dhuna në bazë gjinore, veçanërisht dhuna në familje, mbetet e përhapur gjerësisht. Në faktorët kontribues përfshihen normat e socializuara gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit që mbështesin dhunën mashkullore; dhe traumat e patrajtura. Përgjigjja institucionale mbetet e dobët.
- Personat lezbikë, gejë, biseksualë, transgjinorë, queer dhe interseks (LGBTQI) vazhdojnë të përballen me diskriminim dhe qasje të pabarabartë në shërbime.
- Në Kosovë ka diskriminim fetar, veçanërisht ndaj grave dhe vajzave myslimane të mbuluara.

- Kthimi dhe riatdhesimi mund të kenë ndikime të ndryshme te gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.

Arsimi

- Vijueshmëria në arsimin parashkollor është e ulët dhe nën përmbushjen e caqeve të caktuara me Objektivat e Barcelonës të BE-së për shkak të pamjaftueshmërisë së institucioneve parashkollore me çmim të përballueshëm. Kjo dobëson rezultatet arsimore, por gjithashtu pengon pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, duke marrë parasysh rolin e tyre mbizotërues shoqëroro-kulturor si ofruese të kujdesit.
- Raporti midis femrave dhe meshkujve në radhët e mësimdhënësve është 40% ndaj 60% për mësimdhënës të shkollave të mesme, dhe 99.6% ndaj 0.4% për mësimdhënës të institucioneve parashkollore, respektivisht. Gratë gjithashtu janë të nënpërfaqësuar edhe në radhët e profesorëve universitarë.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kanë qasje në arsim. Ata përballen me stigma shoqërore rreth aftësisë së kufizuar, me pengesa financiare, me mungesë të mësimdhënësve mbështetës (të paraparë me ligj, por jo me ndarje të financave), dhe me mungesë të librave e të pajisjeve mësimore. Vajzat me aftësi të kufizuara përballen me më shumë sfida sesa djemtë.
- Në vitin 2015, gratë përbënin vetëm 39% të studentëve të regjistruar në Qendrat e Aftësisit Profesional (QAP) dhe 36% të vijuesve të kurseve të arsimimit për të rritur. Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të segregacionit gjinor të profesioneve dhe perceptimeve se QAP-të më tepër i plotësojnë nevojat për profesionet "mashkullore", megjithëse lypset kërkim i mëtejshëm në këtë drejtim.

Punësimi

- Zyrtarisht, vetëm 13% e grave të moshës së punës janë të punësuar, krahasuar me 47% të burrave. Shkalla e papunësisë në mesin e grave është 37%, por 64% në radhët e të rejave (moshat 15-24 vjeç). Sipas statistikave, 29% e burrave dhe 48% e të rinjve janë të papunë. Vlerësimet sugjerojnë se më shumë se një e treta e punëtorëve janë të punësuar në ekonominë joformale.
- Ekziston segregacioni gjinor i profesioneve. Sektorët e arsimit, të shëndetësisë dhe të tregtisë punësojnë 48% të të gjitha grave të punësuar. Sektorët e prodhimit, të ndërtimtarisë dhe të tregtisë punësojnë 46% të të gjithë burrave.
- Një faktor kyç që kontribuon në pjesëmarrjen e ulët të grave në fuqinë punëtore është përgjegjësia e ofrimit të kujdesit, kryesisht kujdesi për fëmijët; 32% e grave thonë se kjo pengon punësimin e tyre. Vetëm 1% e burrave ia atribuojnë pasivitetin përgjegjësi të ofrimit të kujdesit. Burrat janë të prirë të jenë joaktivë për shkak të vijimit të shkollës, arsimit ose trajnimit (37%). Dispozitat për pushimin prindëror në Ligjin e punës duhet të ndryshohen, pasi çekuilibri aktual gjinor paraqet pengesë për punësimin e grave.
- Kosovës i mungojnë të dhënat lidhur me hendekun gjinor të pagave, duke përfshirë të dhënat sipas sektorit.
- Zyrat e Punësimit kanë mbështetur më pak gra (39%) sesa burra (61%) në gjetjen e punësimit.

Konkurrueshmëria dhe novacioni

- Në vitin 2017, gratë zotëronin 13% të të gjitha ndërmarrjeve dhe 18% të bizneseve të reja të regjistruara në 2014-2016.
- Gratë morën 17% të granteve të Agjencisë Kosovare për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) për ndërmarrjet e tyre, dhe burrat 83%. Ndërmarrjet e zotëruara nga gratë morën 25 herë më pak fonde si subvencione, ndonëse raporti i ndërmarrjeve në pronësi të grave ndaj atyre në pronësi të burrave është një me gjashtë, gjë që sugjeron se ndarja e fondeve është joproporcionale.
- Në Kosovë mungon analiza gjinore lidhur me ndikimin e tregtisë në barazinë gjinore.
- Vetëm 22% e punonjësve të sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë gra.

- Në barrierat kryesore me të cilat ballafaqohen gratë pronare të bizneseve përfshihen normat tatimore, barra administrative dhe tregu përgjithësisht i vogël në Kosovë.
- Vetëm 15% e grave që janë pronare të bizneseve kanë marrë hua nga bankat komerciale.
- Bizneset në pronësi të grave janë të orientuara nga sektorët e tregtisë, të prodhimit dhe të shërbimeve; 31% e të gjitha bizneseve në pronësi të grave ofruan shërbime; 29% u angazhuan në tregti dhe 15% në prodhim. Pjesa më e madhe ofruan shërbime të tilla si floktaria dhe shërbimet e tjera estetike.

Bujqësia

- Në aspektin formal, gratë janë të nënpërfaqësuar në sektorin e bujqësisë, duke përbërë 5% të fermerëve të licencuar. Mungesa e zotërimit të pronës, niveli i ulët arsimor, puna e paregjistruar, qasja e dobët në informata rreth subvencioneve dhe rolet e socializuara gjinore minojnë pjesëmarrjen e tyre formale.
- Ka kërkime të pamjaftueshme në lidhje me përfshirjen e grave dhe të burrave në ekonominë joformale.
- Në vitin 2015 dhe 2016, gratë përbënin vetëm 2% të të gjithë përfituesve të subvencioneve për bujqësi.

Energjia

- Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në këtë sektor, pjesërisht për shkak të normave gjinore lidhur me atë se çka përbën mjedis të përshtatshëm të punës për gratë.
- Analizat gjinore dhe të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë në lidhje me këtë sektor janë të pamjaftueshme.

Mjedis

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) rrallë ka kryer analiza të mirëfillta gjinore për të informuar politikat, programet dhe aktivitetet.
- MMPH-ja dhe autoritetet përgjegjëse komunale rrallë organizuan konsultime publike, dhe gratë ishin të nënpërfaqësuar në radhët e pjesëmarrësve.
- Gratë janë të nënpërfaqësuar në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Transporti (hekurudhat)

- Gratë janë të nënpërfaqësuar në kompanitë hekurudhore të Kosovës, veçanërisht në vendimmarrje.

Shëndetësi

- Më shumë gra sesa burra punojnë në institucionet shëndetësore. Mungojnë të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë për profesionet.
- Qasja në kujdesin shëndetësor mund të jetë e ndryshme për gratë dhe burrat, duke përfshirë edhe ndryshimet në bazë të përkatësisë etnike dhe vendndodhjes gjeografike. Kufizimet shoqëro-kulturore dhe qasja në financa minojnë qasjen e grave në veçanti.
- Më shumë gra (17%), sesa burra (12%), përdorin medikamente pa recetë, dhe gratë kanë më shumë gjasa të pranojnë marrjen e qetësuesve për të lehtësuar ankthin dhe stresin. Stigmat shoqërore rreth shëndetit mendor, shqetësimet rreth konfidencialitetit dhe kujdesi i paarritshëm shëndetësor kontribuojnë në vetëtrajtim.
- Ndonëse janë të paligjshme dhe si të tilla rrallë shpalosen, ende bëhen abortet selektive sipas seksit, duke favorizuar djemtë (110:100).
- Shumica e kosovarëve seksualisht aktivë (64%) nuk përdorin mjete kontraceptive. Më sa duket, pak njerëz mësojnë në shkollë rreth përdorimit të kontraktivëve, dhe thuhet se mësimdhënësit rregullisht e anashkalojnë edukatën e shëndetit riprodhues pa e ligjëruar fare. Disa ofrues të kujdesit shëndetësor japin informacione të pasakta mbi kontraktivët.

Objektivat potencialë të PVGJ-së

Nga kjo analizë gjinore pritej që të mbështesë ZBE-në me identifikimin e së paku tre objektivave nga lista potenciale e objektivave të parapara në kuadër të PVGJ II, duke përfshirë nga një në secilin prej prioriteteve tematike në vijim, ku BE-ja mund të kontribuojë përmes programit. ZBE-ja duhet të marrë parasysh objektivat e mëposhtëm, të cituar fjalë për fjalë nga PVGJ II, të cilët do të kontribuonin në adresimin e pabarazive më të ndjeshme gjinore në Kosovë, të identifikuar përmes kësaj analize. Pjesët brenda secilit sektor i shtjellojnë këto dhe objektiva, tregues dhe veprime të tjera të mundshme që ZBE-ja mund t'i marrë parasysh. Këto janë harmonizuar me strategjitë dhe planet e veprimit të Kosovës, si dhe me treguesit e PVGJ II për atë që është e mundur. Këta objektivë mund të jenë pjesë e programeve më të gjera ose programeve të mëvetësishme. Përzgjedhja përfundimtare e objektivave duhet të bëhet në konsultim me aktorët e tjerë që punojnë drejt qëllimeve të ngjashme, veçanërisht shtetet anëtare të BE-së, për hir të shfrytëzimit efektiv dhe efikas të resurseve.

Integriteti fizik dhe psikologjik

- **PVGJ II Objektiv 7:** Vajzat dhe gratë të lira nga të gjitha format e dhunës ndaj tyre (DHNGV) si në sferën publike, ashtu edhe në atë private.
- **Objektiv 10:** Qasja e barabartë në shërbime të kujdesit shëndetësor cilësor fizik dhe mendor, parandalues, shërues dhe rehabilitues për vajzat dhe gratë.
- **Objektiv 11:** Promovimi, mbrojtja dhe përmbytja e të drejtës së çdo individi për të pasur kontroll të plotë, dhe për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi, mbi çështjet që kanë të bëjnë me seksualitetin dhe shëndetin seksual dhe riprodhues, pa diskriminim, shtrëngim dhe dhunë.

Të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore - Fuqizimi ekonomik dhe shoqëror

- **Objektiv 13:** Qasja e barabartë për vajzat dhe gratë në të gjitha nivelet e arsimit dhe në arsim e aftësim profesional (AAP) cilësor pa diskriminim.
- **Objektiv 14:** Qasja në punë të denjë për gratë e të gjitha moshave.
- **Objektiv 15:** Qasja e barabartë për gratë në shërbimet financiare, resurset prodhuese, përfshirë tokën, tregtinë dhe ndërmarrësinë.
- **Objektiv 16:** Vajzat dhe gratë gëzojnë qasje dhe kontroll të barabartë ndaj ujit të pastër, energjisë, infrastrukturës së transportit, dhe angazhim të drejtë në menaxhimin e tyre.

Të drejtat politike dhe civile - Zëri dhe pjesëmarrja

- **Objektiv 17:** Të drejta dhe mundësi të barabarta për gratë për pjesëmarrje në proceset e politikave dhe të qeverisjes në të gjitha nivelet.
- **Objektiv 18:** Organizatat e grave dhe OSHC-të e tjera dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut që punojnë për barazi gjinore e fuqizim dhe të drejta të grave dhe vajzave punojnë lirshëm dhe mbrohen me ligj.
- **Objektiv 20:** Gratë gëzojnë të drejta të barabarta për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në proceset vendimmarrëse për çështjet klimatike dhe mjedisore.

Ku mund të japë vlerë të shtuar BE-ja

Më konkretisht, drejt sendërtimit të disa prej objektivave të lartpërmendur, Zyra e BE-së në Kosovë mund të shtojë vlerë duke mbështetur programet e mëposhtme, të cilat do të adresonin pabarazitë kyçe gjinore në Kosovë. Pjesët e mëvonshme në këtë analizë përfshijnë rekomandime shtesë, më specifike për çdo sektor.

- **PVGJ 15: Mbështetja e të drejtave pronësore të grave:** Duke pasur parasysh se shkalla e pabarabartë e zotërimit të pronës nga gratë qëndron në rrënjë të disa prej pabarazive të tjera lidhur me pronësinë e bizneseve, qasjen në subvencione dhe pavarësinë ekonomike, të vazhdohet me mbështetje dhe

inkurajim politik për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe punën e gjyqësorit, të noterëve dhe të aktorëve të tjerë që merren me çështjet e trashëgimisë, shkurorëzimeve dhe ato pronësore. Të inkurajohet zgjerimi i mëtejme i udhëzimit administrativ për regjistrimin e përbashkët të pronës dhe që aty të përfshihen gratë e pamartuara. Të mbështeten përpjekjet tashmë të dëshmuara të shtrirjes së veprimtarisë informative të OGSHC-ve në nivel lokal për të transformuar normat dhe traditat shoqërore që qëndrojnë në rrënjë të shkallës së ulët të zotërimit të pronës nga gratë, dhe për t'iu ndihmuar grave në kërkimin e të drejtave të tyre pronësore, duke përfshirë ndihmën juridike. Të bashkërendohen përpjekjet specifike me USAID-in dhe Bankën Botërore për të shmangur mbimbullimin.

- **PVGJ 7. 13. 14. 17: Investimi në institucione të kujdesit për fëmijë, të arsimit parashkollor dhe fillor, duke përfshirë transformimin e normave të socializuara gjinore:** Duke pasur parasysh se mungesa e institucioneve të qasshme dhe të përballueshme të kujdesit për fëmijë minon pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore dhe në politikë, të mbështetet qeveria në krijimin e më shumë qendrave të kujdesit për fëmijë dhe të institucioneve parashkollore. Kjo do të krijojë vende pune, do të kontribuojë në pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore dhe do të përmirësojë rezultatet arsimore për fëmijët, duke i kualifikuar më mirë ata për punë më vonë. Të mbështeten investimet në kurrikula të reja të bazuara në shembujt më të mirë nga Shtetet Anëtare Nordike që do të transformojnë rolet gjinore në Kosovë. Të sigurohet rikualifikimi i mësimitdhënësve dhe mbështetja e institucionalizimit të masave afirmative për baraspeshë gjinore të mësimitdhënësve në të gjitha nivelet. Transformimi i roleve të socializuara gjinore dhe trajtimi i temave si dhuna mashkullore përmes edukimit të hershëm, mund të çojë përpara barazinë gjinore në të gjitha sferat dhe të zvogëlojë dhunën e kryer nga burrat më vonë gjatë jetës, duke përfshirë edhe dhunën në bazë gjinore. Ndërsa USAID-i mund të punojë në këtë dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) ka programe edukimi, investimet që kërkohen janë të konsiderueshme.
- **PVGJ 7. ndër të tjera: Mbështetje për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë të Kosovës dhe Universitetin e Prishtinës për të institucionalizuar kurikula të përmirësuar dhe trajnim të detyrueshëm për prokurorët, gjyqtarët dhe studentët e drejtësisë që do të transformojnë normat e socializuara gjinore në lidhje me dhunën në bazë gjinore, diskriminimin, të drejtat e komunitetit LGBTQI, zotërimit të pronës nga gratë dhe kujdestarinë e fëmijëve. Të mbështetet institucionalizimi i rikualifikimit dhe trajnimit të rregullt rifreskues të detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët. Veprimet duhet të ndërmerren së bashku me USAID-in, EULEX-in, UNDP-në, UN Women, dhe OGSHC-të me ekspertizë në këtë fushë.**
- **PVGJ 17: Mbështetja e programimit për të rritur pjesëmarrjen politike të grave në të gjitha nivelet.** Duke marrë parasysh nënpërfaqësimin e ndjeshëm të grave në të gjitha nivelet, të mbështetet reforma e ligjit zgjedhor si masë afirmative, veprimet në bashkëpunim me partitë politike për demokratizim dhe barazi gjinore, dhe veprimet jopartiake që do të fuqizojnë më shumë gra që të kandidojnë për pozita në zgjedhje dhe të çojnë më tej kapacitetet e tyre. Të bashkërendohet programimi me USAID-in, IKD-në, OSBE-në dhe Helvetas-in.
- **PVGJ 17. ndër të tjera: Si pjesë e reformës së financave publike dhe programimit të reformës së administratës publike, të mbështetet qeveria në institucionalizimin e trajnimit të detyrueshëm për të gjithë nëpunësit publikë në të gjitha nivelet për barazinë gjinore, përfshirjen e aspektit gjinor në politikat publike, BPGJ-në dhe strategjitë për përmirësimin e pjesëmarrjes publike, duke shfrytëzuar kurrikulat ekzistuese dhe trajnuesit e kualifikuar të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Të punohet në ndërlidhje me Sida-n, USAID-in, OSBE-në, GIZ-in dhe Helvetas-in.**
- **PVGJ 17. ndër të tjera: Nënpermjet Programit për Përkrahje të Shoqërisë Civile, të destinohet mbështetja për OGSHC-të për të mundësuar angazhimin e tyre të vazhdueshëm në sjelljen e ndryshimeve transformuese për barazi gjinore, ngritje të vetëdijes dhe mbajtjen e qeverisë llogaridhënëse për reforma në sektorët e tjerë.**
- **PVGJ 14: Mbështetja e kërkimeve të orientuara drejt politikave mbi ekonominë joformale dhe hendekun gjinor të pagave për të kuptuar më mirë pabarazitë gjinore dhe zgjidhjet specifike të politikave dhe veprimet për adresimin e tyre. Kjo nënkupton përfshirjen më të mirë të grave dhe të**

burra në ekonominë joformale në sektorin e bujqësisë. Të bashkërendohet mbështetja për përmirësimin e statistikave gjinore me Sida-n dhe Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit.

- **PVGJ 14 dhe 15:** Mbështetje për KIESA-n dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), respektivisht, në krijimin e masave afirmative për të siguruar që subvencionet do të arrijnë më mirë te ndërmarjet në pronësi të grave. Të bashkërendohet me USAID-in dhe Sida-n.
- **PVGJ 7, 10 dhe 11:** Mbështetja e Ministrisë së Shëndetësisë në: 1) organizimin e rikualifikimit të detyrueshëm për punonjësit e shëndetësisë për normat gjinore, identifikimin e shenjave të dhunës në bazë gjinore, referimin e personave që kanë pësuar dhunë në bazë gjinore, ofrimin e ndihmës për pacientët me trauma nga dhuna, dhe mjetet kontrceptive bashkëkohore, respektivisht; 2) përmirësimin e inspektimeve të institucioneve shëndetësore dhe barnatoreve; 3) shtimin e kujdesit të shëndetit mendor cilësor dhe konfidencial më të disponueshëm dhe publikisht më të pranueshëm nëpërmjet shtrirjes së informacionit në terren; dhe 4) përmirësimin e qasjes të ofruesit të kujdesit shëndetësor që janë gra, veçanërisht në zonat rurale. Nxitja dhe mbështetja e qeverisë në zgjidhjen e çështjeve të financimit në lidhje me sigurimet shëndetësore dhe qasjen në kujdes shëndetësor. Të mbështetet ngritja e vetëdijes publike, duke prekur zonat rurale në veçanti, mbi qasjen në kujdesin shëndetësor në nivelin e duhur, nevojat për shqyrtimin e kancerit, përdorimin e mjeteve bashkëkohore të kontracepcionit, rreziqet e vetëtrajtimit me produkte farmaceutike. Të bashkëpunohet me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

Hyrja

Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit (MSA) e vitit 2016, Ministria e Integritimit Evropian (MIE) ka zhvilluar Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA).¹ Ky program zëvendësoi të gjitha dokumentet dhe strategjitë ekzistuese që lidhen me integrimin në BE dhe ka për synim të informojë procesin e paraaderimit të Kosovës. ZBE-ja mbështet Qeverinë e Kosovës në përparimin drejt përmbushjes së kritereve të pranimit në BE nëpërmjet ndihmës financiare dhe teknike.

Financimi ofrohet përmes Instrumentit për Asistencë Paraanëtarësimit (IPA). Dokumenti Strategjik Indikativ (DSI) përvijon prioritetet e asistencës financiare të BE-së për vitet 2014-2020. Në vitin 2017, u ndërmor shqyrtimi afatmesëm i mbështetjes së BE-së për rajonin, me qëllim të informimit të mbështetjes financiare të BE-së në të ardhmen.² Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës në konsultim të ngushtë me ZBE-në harton Dokumentet e Planifikimit Sektorial (DPS), që ofrojnë një pasqyrë të secilit sektor përkatës dhe caktojnë prioritetet e fushave që kanë nevojë për mbështetje nga BE-ja në afat të mesëm dhe të gjatë. DPS-të pastaj informojnë Dokumentet e Veprimit (DV) për secilin sektor. Këto përvijojnë veprimet specifike afatshkurtra të mbështetura nga BE-ja.

PVGJ II i BE-së kërkon që “dëshmi të palëkundshme gjinore” të informojnë “të gjitha shpenzimet, programimin dhe politikëbërjen e jashtme të BE-së”.³ Planet e veprimit për “programe tematike, dypalëshe dhe rajonale” duhet të informohen nga analiza gjinore dhe “konsultimet me mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore, OSHC-të, [dhe] organizatat e grave”. Një tregues i PVGJ II është zbatimi sistematik i shënjesit të politikave për barazi gjinore të Komitetit të Asistencës për Zhvillim (KAZH) të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në shënjimin e të gjitha programeve, të tilla si DV-të.⁴ PVGJ II në mënyrë ambicioze zotohet që BE-ja të shënojë 85% të të gjitha programeve të reja me fonde nga BE-ja me “1” ose “2” deri në vitin 2020. Për të arritur këtë, kriteri minimal është kryerja e analizës gjinore për të informuar veprimin. Madje, brenda veprimeve, barazia gjinore duhet të jetë objektivi kryesor (shënuar me “2”) ose “objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm” (shënuar me “1”).

Përveç këtyre qëllimeve të PVGJ II të BE-së, Kosova duhet të zbatojë Ligjin e vet për barazi gjinore (LBGJ), i cili kërkon që pikëpamja gjinore të informojë të gjitha politikat dhe programet,⁵ duke përfshirë dokumentet e përgatitura nga ministritë dhe institucionet e tjera publike, siç janë DPS-të dhe DV-të. Kështu, analiza gjinore është e rëndësishme si për Qeverinë e Kosovës ashtu edhe për BE-në për të informuar ndërhyrjet.

ZBE-ja ka angazhuar me kontratë Rrjetin e Grave të Kosovës (RrGK) për ta përgatitur këtë analizë gjinore për të informuar programimin e ardhshëm të IPA-s duke propozuar objektiva, tregues dhe

Figura 1. Logjika e financimit të BE-së përmes IPA-s




Figura 2. Përkufizimet e shënjesit gjinor të OECD-së

Shënjimi	Përkufizimi
2	Barazia gjinore është objektivi kryesor i projektit/programit dhe është thelbësore në hartimin e tij dhe rezultatet e pritshme. Projekti/programi nuk do të ishte ndërmarrë pa këtë objektiv.
1	Barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por jo arsyeja parësore për ndërmarrjen e projektit/programit.
0	Projekti/programi është shoshitur kundrejt shënjesit gjinor, por nuk është gjetur që vë si cak barazinë gjinore

Burimi: OECD

veprime specifike në lidhje me PVGJ II. Analiza është kryer për të mbështetur ZBE-në në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas PVGJ II.⁶

Metodologjia

Fillimisht, RrGK-ja u konsultua me hisedarët për të vlerësuar nevojat dhe rezultatet e pritura të analizës gjinore, të rëndësishme për secilin sektor. RrGK-ja pastaj kreu një shqyrtim të kuadrit ligjor që lidhet me secilin sektor nga pikëpamja gjinore. Kjo përfshiu shqyrtimin e ligjeve, politikave dhe strategjive ndërkombëtare dhe kombëtare. Aty ku është relevante, gjithashtu ka referime ndaj Traktateve dhe Direktivave të BE-së, duke marrë parasysh zotimin e Kosovës për të përafruar legjislacionin e saj me acquis-të e BE-së, sipas MSA-së⁷. Kërkimtarët kryen shqyrtimin e plotë në tavolinë të të gjitha botimeve ekzistuese, duke përfshirë artikujt akademikë dhe literaturën “gri” të prodhuar nga institucionet, OSHC-të dhe donatorët. Gjithashtu, u mbledhën të dhëna edhe nga institucionet dhe hisedarët relevantë. Në drejtim të kontekstualizimit të gjetjeve sasiore dhe mbledhjes së informacionit aty ku mungonin të dhënat, kërkimtarët intervistuan 51 informatorë kryesorë.⁸ Kërkimi u krye kah mesi i qershorit të vitit 2017 dhe në fillim të qershorit të vitit 2018. Raporti u shkrua duke përdorur qasjen e procesit përsëritës. Vlefshmëria e gjetjeve është rritur më tej përmes trekëndëzimit të kërkimtarëve, burimeve të të dhënave dhe metodave të përdorura, si dhe përmes kontrolleve të pjesëmarrësve.

Kufizimet

Ndryshimet në qeveri, së bashku me reagimin e ngadalshëm të institucioneve ndaj kërkesave zyrtare për informacion, kontribuan në vonesat në marrjen e të dhënave dhe përfundimin e analizës. Në disa raste, të dhënat e zërthyer sipas gjinisë nuk ekzistojnë. Disa informatorë sugjeruan se të dhënat në sektorë të caktuar ishin të vjetruara ose nuk pasqyronin me saktësi situatën aktuale. Kjo doli në pah te të dhënat e fuqisë punëtore dhe statistikave të arsimit për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Nënraportimi i diskriminimit dhe i krimeve që përfshijnë dhunën në bazë gjinore nënkuptojnë se ekzistojnë mospërputhje midis prevalencës aktuale dhe të dhënave zyrtare.

Mbi përmbajtjen e analizës gjinore

Kjo analizë gjinore është zërthyer sipas sektorëve, ku përfshihen: sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore; qeverisja dhe demokracia; kapitali njerëzor: arsimit dhe punësimi; konkurrueshmëria dhe novacioni; bujqësia; energjia; mjedisi; transporti; dhe shëndetësia. Disa pjesë janë zërthyer më tej në nënpjesë. Secila pjesë përfshin një vlerësim të shpejtë të ligjeve dhe të politikave ekzistuese që kanë të bëjnë me sektorin e dhënë, nga pikëpamja gjinore, pasuar nga gjetjet lidhur me situatën aktuale të grave dhe burrave në atë sektor. Secila pjesë përfundon me objektiva, tregues dhe veprime potenciale që BE-ja dhe aktorët e tjerë mund të konsiderojnë t'i ndërmarrin për të adresuar pabarazitë gjinore. Për aq sa është e mundur, këto janë harmonizuar me strategjitë dhe planet e veprimit të Kosovës, si dhe me PVGJ II të BE-së. Këto do të duhet të përafrohen me edicionin e pritur të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ), si dhe PVGJ-në e ardhshme të BE-së. Përderisa nismat e njohura që janë në vazhdim e sipër janë referuar në shënime, koordinimi me donatorët dhe aktorët e tjerë në programim ka rëndësi thelbësore për të shmangur mbimbullimin. Një nga shtojcat detajon të dhëna shtesë që i përkasin secilit sektor, duke identifikuar të metat në disponueshmërinë e të dhënave. Kjo mund të informojë aktivitetet brenda programimit për sektorin drejt përmirësimit të disponueshmërisë së të dhënave nga pikëpamja gjinore, siç rekomandohet nga PVGJ II.⁹ Për hir të leximit më të lehtë, të gjithë numrat në raport janë rrumbullakuar në numrin më të afërt të plotë.

Demokracia dhe qeverisja

Demokracia dhe qeverisja konsiderohen si prioritet për vendet candidate potenciale, pasi zhvillimi institucional, gjithashtu, mund të kontribuojë në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagës.¹ Kjo pjesë përfshin analizën gjinore të temave të ndryshme lidhur me demokracinë dhe qeverisjen, duke përfshirë zyrtarët e zgjedhur, emërimet politike, dialogun dhe negociatat, partitë politike, bordet e pavarura, ndërmarrjet publike, administratën publike, mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore, pjesëmarrjen politike nëpërmjet konsultimeve publike, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor si aspekt të menaxhimit financiar publik dhe zhvillimit të shoqërisë civile.

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- Konventa e Kombeve të Bashkuara (KB) për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)² pohon se shtetet marrin të gjitha masat e duhura “për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën: (a) Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike si dhe për të qenë të zgjedhura, në të gjitha organet e zgjedhura publikisht; (b) Për të marrë pjesë në përpunimin e politikës së shtetit dhe në zbatimin e saj; për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes; (c) Për të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit”. CEDAW është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.³
- Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (RKSOKB) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë⁴ bën thirrje për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në vendet pas konfliktit, duke përfshirë zgjidhjen e konflikteve dhe proceset paqësore.
- Kushtetuta garanton gjerësisht barazinë gjinore për burrat dhe gratë, duke konsideruar mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave si vlerë themelore demokratike.⁵ Ajo mbron të drejtat zgjedhore dhe pjesëmarrëse.⁶ Tutje, ajo thotë se përbërja e Kuvendit dhe e shërbimit civil respekton parimet e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.⁷
- Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës⁸ parasheh kuotën gjinore prej 30% në Kuvend dhe që në secilën nga listat e kandidatëve të subjekteve politike, së paku 30% janë burra dhe së paku 30% janë gra.
- Ligji për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës⁹ parasheh kuotën gjinore prej 30% në kuvend komunal dhe që në secilën nga listat e kandidatëve të subjekteve politike, së paku 30% janë burra dhe së paku 30% janë gra.
- Ligji për barazi gjinore (LBGJ) përkufizon përfaqësimin e pabarabartë si atëherë kur pjesëmarrja apo përfaqësimi i njëres gjini, është më i ulët se pesëdhjetë përqind (50%) në çdo organ dhe nivel vendimmarrës në jetën politike dhe publike. Së këndejmi, Ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligji për zgjedhjet lokale nuk janë të harmonizuar me LBGJ-në. LBGJ-ja parasheh gjithashtu masa të ndryshme për të parandaluar diskriminimin gjinor dhe për të siguruar barazinë gjinore, siç janë: kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë; programet mbështetëse për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në jetën publike; dhe trajtimi preferencial në rekrutim, punësim dhe ngritje në detyrë. Ligji po ashtu e bën BPGJ-në të detyrueshëm për të gjitha organizatat buxhetore.¹⁰ Ai parasheh themelimin e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ) pranë Zyrës së Kryeministrit, si dhe zyrtarët e barazisë gjinore (ZBGJ) në të gjitha komunat, ministritë dhe institucionet e nivelit qendror. ABGJ-ja është përgjegjëse për promovimin, mbështetjen dhe koordinimin e zbatimit dhe reformës së LBGJ-së, si dhe sigurimin e analizave rreth barazisë gjinore në Kosovë dhe rreth ngritjes së vetëdijes.¹¹ ABGJ-ja merr pjesë në përgatitjen e ligjeve, akteve nëligjore, strategjive dhe programeve për të siguruar zbatimin e përfshirjes së aspektit gjinor dhe BPGJ-së.¹² ABGJ-ja gjithashtu përgatit PKBGJ-në dhe monitoron zbatimin e tij. Të gjitha ministritë dhe komunat duhet të emërojnë një zyrtar përkatës për barazi gjinore për të koordinuar zbatimin e LBGJ-së.¹³ Zyrtarët e tillë kanë për përgjegjësi integrimin gjinor, buxhetimin dhe raportimin vjetor për zbatimin e PKBGJ-së.

- Ligje të tjera që lidhen me këtë sektor, por që nuk përmbajnë pikëpamje gjinore, janë Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Kosovës,¹⁴ dhe Ligji për shërbimin konsullor të misionëve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.¹⁵
- Rregullorja për standardet minimale për procesin e konsultimit publik¹⁶ synon të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike duke siguruar pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të palëve të interesuara dhe publikut në procesin e hartimit të politikave dhe ligjeve. Të gjitha organet publike duhet të mbajnë konsultime publike, të jenë transparente dhe të sigurojnë mundësi të barabarta dhe praktika jo-diskriminuese.¹⁷ Duhet të mbahen konsultime personale dhe projekt-propozimet e politikave duhet të ndahen me palët e interesuara për dhënie të komenteve.¹⁸ Standardet minimale nuk përfshijnë pikëpamje gjinore.

Dokumentet e politikave

- Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026¹⁹ inkurajon mbështetjen e të rinjve dhe grave në biznes përmes ofrimit të huave me kamata të ulëta, thjeshtësimit të procedurave për hapjen e bizneseve ose lirimit nga tatimet. Ajo i detyron komunat të hartojnë politika për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara dhe politika për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe kategorive të ndjeshme shoqërore.
- Qarkoret buxhetore vjetore²⁰ nga Ministria e Financave kanë përkufizuar BPGJ-në dhe kanë inkurajuar të gjitha organizatat buxhetore që ta zbatojnë atë në proceset e planifikimit dhe ndarjes së buxhetit. Ministria ka ofruar shabllone për këtë qëllim.
- Strategjia për rregullim më të mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021 kërkon reformimin e legjislacionit ekzistues primar dhe sekondar dhe rritjen e efektivitetit të komunikimit dhe konsultimit publik.²¹ Strategjia thekson se vlerësimi i ndikimit gjinor (VNGJ) do të futet si mjet i analizës së politikave ex-ante që synon parandalimin e pasojave negative të padëshiruara, duke forcuar pasojat e dëshiruara pozitive të politikave dhe legjislacionit të propozuar që ndikojnë në “pabarazitë tashmë ekzistuese ndërmjet burrave dhe grave në shoqëri.” Strategjia e bën ABGJ-në përgjegjëse për mbikëqyrjen e futjes në përdorim të VNGJ-së.
- Ndonëse nuk është drejtpërdrejt i zbatueshëm në Kosovë, një prioritet tematik i PVGJ II fokusohet te Zëri dhe Pjesëmarrja, duke përfshirë disa objektiva dhe tregues relevantë për demokracinë dhe qeverisjen.²² Ai gjithashtu kërkon që BE-ja të mbështesë MKBGJ-të, si dhe që të gjitha programet e sektorit të konsultohen dhe të bashkëpunojnë me MKBGJ-të.

Gjetjet

Kuvendi i Kosovës dhe kuvendet komunale

Pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, 38 gra (32%) dhe 82 burra (68%) u zgjedhën në Kuvendin e Kosovës. Nga gratë, 17 morën vendet në Kuvend në sajë të kuotës (43%), krahasuar me 49% në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014.²³ Kjo sugjeron një rritje të lehtë në përqindjen e grave të zgjedhura drejtpërdrejt nga votuesit. Vetëm një parti politike brenda Kuvendit të Kosovës udhëhiqet nga një grua (partia “Alternativa”, e cila ka vetëm 2.4% të vendeve). Gjatë fushatës zgjedhore, gratë kandidate morën pjesë në më pak debate televizive, kishin më pak afishe në hapësira publike dhe më pak postime të sponsorizuara në portalet online.²⁴ Asnjë grua nuk garoi për pozitën e kryeministrit. Të nëntë grupet parlamentare drejtohen nga burra.²⁵ Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë në lidhje me votuesit nuk janë të disponueshme.²⁶

Gjersa ekziston kuota për pjesëmarrjen e grupeve etnike të pakicave në Kuvend,²⁷ në praktikë numri i vogël i vendeve që mbajnë pakicat shpesh ka nënkuptuar që gratë nga grupet etnike minoritare kanë qenë të nënpërfaqësuar.²⁸ Që nga viti 2017, burrat shqiptarë janë të mbipërfaqësuar në Kuvend, ndërsa gratë shqiptare janë dukshëm të nënpërfaqësuar. Gratë rome, ashkalie, egjiptiane dhe gorane, si dhe burrat goranë nuk janë të përfaqësuar.²⁹

Për zgjedhjet komunale të tetorit 2017, nga 204 kandidatë për kryetarë komunash vetëm 4% ishin gra.³⁰ Përfaqësuesit e partive politike kanë deklaruar se nënpërfaqësimi i grave është pjesërisht për shkak

se gratë nuk janë të interesuara të kandidojnë në zgjedhjet për kryetar komune.³¹ Pas zgjedhjeve, Kosova ka 38 kryetarë komunash, dhe asnjë nuk është grua. Gratë mbajnë 35% të të gjitha vendeve të kuvendeve komunale në Kosovë.³² Prej tyre, 67% morën vende në sajë të kuotës, ndërsa 33% u zgjedhën drejtpërdrejt.³³ Kjo paraqet rritje inkurajuese në zgjedhjen e drejtpërdrejtë të grave, pa kuotë, në nivelin komunal, nga vetëm 30 gra në zgjedhjet e fundit në 109 gra në 2017. Në krahasim me përpjesën që kanë në popullsinë e Kosovës, burrat shqiptarë, serbë dhe turq, si dhe gratë serbe dhe turke, me sa duket, janë të mbipërfaqësuar në radhët e anëtarëve të kuvendeve komunale. Ndërkohë që, gratë shqiptare, boshnjake, turke dhe gorane, si dhe burrat ashkali, egjiptianë dhe boshnjakë, janë të nënpërfaqësuar në radhët e anëtarëve të kuvendeve komunale. Gratë rome, ashkale dhe egjiptiane dhe burrat romë nuk janë të përfaqësuar në asnjë kuvend komunal.³⁴ Një nga nëntë zëvendëskryesuesit e kuvendeve komunale për komunitete është grua (11%).³⁵

Vazhdojnë të ekzistojnë shqetësimet rreth praktikës së “votimit familjar”, ku një grup voton në të njëjtën kabinë votimi në të njëjtën kohë.³⁶ Në raste të tilla, kryefamiljarët burra shpesh votojnë në emër të anëtarëve të familjes që janë gra. Në zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2017, kjo dukuri u raportua në 845 vendvotime (34%).³⁷ Prevalenca ishte e ngjashme me zgjedhjet e vitit 2014.³⁸ Kjo praktikë i pengon gratë që të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës së lirë dhe në mënyrë të pavarur.³⁹

Emërimet politike

Nga 21 ministra, vetëm dy janë gra.⁴⁰ Nga 64 zëvendësministra, tri janë gra dhe 61 janë burra.⁴¹ Nga 66 këshilltarë politikë, 14 janë gra dhe 52 janë burra.⁴² Për 11 ministritë për të cilat kishte të dhëna të disponueshme, vetëm një grua ishte emëruar shefe e kabinetit të Ministrit, në krahasim me dhjetë burra që mbanin këtë pozitë. Hëpërhë, vetëm një grua është sekretare e përgjithshme dhe një grua ushtruese detyre e sekretarit të përgjithshëm; 16 të tjerët janë burra.⁴³ Në nivel komunal, dy nga 15 nënkryetarët e komunave për komunitete janë gra (13%).⁴⁴

Dialogu dhe negociatat

Deri në vitin 2016, dialogu Kosovë-Serbi ishte udhëhequr nga zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, grua. Sidoqoftë, duke pasur një grua që udhëheq dialogun nuk do të thotë gjithmonë se janë diskutuar nevojat dhe prioritetet e grave.⁴⁵ Janë mbajtur pak konsultime me gratë dhe burrat për të përcaktuar prioritetet e tyre për dialogun, dhe gratë ishin të nënpërfaqësuar në mesin e ekspertëve tematikë të përfshirë.⁴⁶ Hëpërhë, dialogu është duke u udhëhequr nga Presidenti i Kosovës, që është burrë. Nuk kishte të dhëna të disponueshme lidhur me numrin e ekspertëve të përfshirë, gra dhe burra.

Partitë politike

LBGJ-ja i detyron partitë politike të zbatojnë masa për të promovuar pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave.⁴⁷ Midis partive politike që u pajtuan të intervistohen, 41% e udhëheqjes së PDK-së janë gra, dhe tri nga gjashtë degë komunale të PDK-së drejtohen nga gratë.⁴⁸ Sa i përket AAK-së, 30% e të gjithë anëtarëve të regjistruar janë gra.⁴⁹ Nga 27 anëtarë të udhëheqjes së LDK-së, 23 janë burra dhe katër janë gra. Sa i përket AKR-së, gratë mbajnë 35% të pozitave udhëheqëse. Pjesa më e madhe e partive politike kanë forumin e grave që punon drejt barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave.⁵⁰

Bordet e pavarura dhe ndërmarrjet publike

Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në bordet e pavarura dhe ndërmarrjet publike, edhe si anëtare edhe si udhëheqëse. Në 31 ndërmarrje publike në Kosovë, prej 159 anëtarëve të bordit, 85% janë burra dhe 15% janë gra. Ngjashëm, gratë drejtojnë vetëm 16% të të gjitha bordeve të ndërmarrjeve publike.⁵¹ Sa u përket institucioneve dhe agjencive të pavarura, 80% e të gjithë anëtarëve të bordeve janë burra, ndërsa 16% janë gra.⁵²

Pengesat për pjesëmarrjen e grave në politikë

Stereotipat e socializuar gjinorë që sugjerojnë se gratë nuk janë mjaft të kualifikuara apo të afta për të qenë udhëheqëse politike, minojnë pjesëmarrjen e grave në politikë.⁵³ Disa faktorë të tjerë që kontribuojnë në pjesëmarrjen e ulët të grave në politikë përfshijnë: aktivitetet e papaguara të grave të

kujdesit shtëpiak që kufizojnë kohën që ato kanë në dispozicion për t'u angazhuar në politikë; pamundësia për të marrë pjesë në ngjarje të rrjetëzimit politik dhe ngritje të fondeve për shkak të aktiviteteve të kujdesit në shtëpi; ndërlidhur me këtë, qasja e pamjaftueshme në financim për fushatë politike; dhe disponueshmëria e dobët e transportit publik gjatë natës, gjë që do t'ua bënte të mundur atyre vajtjen e kthimin nga takimet.⁵⁴

Administrata publike

Kërkesat e përfaqësimit të përcaktuara me LBGJ⁵⁵ nuk plotësohen nga shumica e institucioneve qendrore dhe komunale. Gratë përbëjnë 40% të të gjithë të punësuarve dhe 27% të vendimmarrësve në institucionet e nivelit qendror.⁵⁶ Në nivel qendror, burrat shqiptarë janë të mbipërfaqësuar në shërbimin civil, ndërsa gratë shqiptare dhe shumica e grupeve të tjera etnike janë të nënpërfaqësuar. Gratë ashkalie dhe egjiptiane nuk janë të përfaqësuar fare.⁵⁷ Gratë nga të gjitha grupet etnike, përveç goraneve, janë të nënpërfaqësuar në administratat publike komunale, edhe si staf dhe në pozita udhëheqëse.⁵⁸ Në gusht të vitit 2017, gratë mbanin 33% të të gjitha pozitave të administratës publike komunale dhe vetëm 20% të të gjitha pozitave drejtuese.⁵⁹

Mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore

Kosova ka dy mekanizma kryesorë kombëtarë për barazi gjinore (MKBGJ) si vijon: Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), agjenci ekzekutive në Zyrën e Kryeministrit, dhe zyrtarët për barazi gjinore (ZBGJ) në ministri dhe komuna. Përgjegjësitë e ABGJ-së përfshijnë nxitjen, mbështetjen dhe koordinimin e zbatimit të LBGJ-së; propozimin e ndryshimeve legislative në përputhje me LBGJ-në; monitorimin e zbatimit të legjislacionit që rregullon barazinë gjinore në Kosovë; bashkëpunimin me shoqërinë civile lidhur me barazinë gjinore; dhe sigurimin e analizave të gjendjes së pa/barazisë gjinore në Kosovë.⁶⁰ ABGJ-ja gjithashtu është përgjegjëse për koordinimin e përgatitjes së PKBGJ-së dhe monitorimin e zbatimit të tij.⁶¹ PKBGJ-ja e fundit ka skaduar në vitin 2013 dhe është zbatuar vetëm pjesërisht.⁶² PKBGJ-ja e re është paraparë të adoptohet më 2018. Përgjegjësitë e ZBGJ-ve përfshijnë zbatimin e LBGJ-së dhe PKBGJ-së në institucionet e tyre gjegjëse, integrimin gjinor në politika dhe programe dhe koordinimin e aktiviteteve me ABGJ-në.⁶³

Edhe ABGJ-ja edhe ZBGJ-të vazhdojnë të përballen me disa sfida. Puna e ABGJ-së është penguar nga mbështetja e pamjaftueshme politike, mosplotësimi i numrit të punonjësve, mungesa e buxhetit dhe dështimi i qeverisë për ta përfshirë mjaftueshëm ABGJ-në në të gjitha aktivitetet e politikë-bërjes.⁶⁴ Ngjashëm, ZBGJ-të janë përballur me vullnetin e pamjaftueshëm politik për t'i përfshirë ata në proceset e politikave, që potencialisht ka kontribuar në mungesën e pikëpamjes gjinore në disa ligje dhe politika të Kosovës.⁶⁵ Ata rrallë kanë qenë të përfshirë në diskutimet për proceset dhe programimin për aderim në BE.⁶⁶ Disa ZBGJ kanë kapacitete të dobëta të analizës gjinore dhe në procese të tjera të politikave, gjë që i pengon ata që të kryejnë përgjegjësitë e tyre. Mungesa e kompetencave ekzekutive, fondet e pamjaftueshme dhe agjendat e partive politike minojnë gjithashtu punën e tyre.⁶⁷ Thuhet se ZBGJ-ve shpesh u jepen detyra jashtë përgjegjësisë së tyre, gjë që merr kohë nga zbatimi i mandatit të tyre.⁶⁸ Në nivel qendror dhe lokal, të gjithë ZBGJ-të, me përjashtim të një prej tyre, janë gra. Kjo mund të përforcojë perceptimin se barazia gjinore është "punë e grave".

Konsultimet publike

Standardet minimale për procesin e konsultimit publik nuk krijojnë detyrim për të siguruar konsultimin e grave dhe burrave të ndryshëm, megjithëse kanë për synim për të "siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje jo-diskriminuese".⁶⁹ Historikisht, gratë janë të nënpërfaqësuar në konsultimet publike mbi projekt-politikat dhe ligjet, duke përfshirë edhe buxhetin. Për shembull, vetëm 19% e të gjithë pjesëmarrësve në konsultimet publike në lidhje me legjislacionin primar dhe sekondar të hartuar nga MBPZHR-ja ishin gra në vitin 2017, dhe vetëm 17% në 2016.⁷⁰ Disa ministri të tjera janë përballur me sfida në konsultimet me gratë, duke përfshirë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT),⁷¹ MMPH-në,⁷² dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI).⁷³

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) nënkupton përfshirjen e aspektit gjinor në proceset dhe dokumentet buxhetore. Që nga viti 2015, është i detyrueshëm për të gjitha organizatat buxhetore në Kosovë, duke përfshirë ministritë, komunat, agjencitë dhe institutet. BPGJ-ja kërkon sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në proceset e planifikimit të buxhetit, dhe shpërndarjen e fondeve publike për të trajtuar nevojat e ndryshme të burrave dhe grave në secilin sektor. BPGJ-ja nuk kërkon as fonde shtesë, as shpërndarje të barabartë me përpikëri midis grave dhe burrave. Nëse zbatohet siç duhet, BPGJ-ja mund të çojë në përdorim më të barabartë, më transparent, më efektiv dhe më efikas të fondeve publike.

Pavarësisht nga detyrimet ligjore, në vitin 2017 vetëm 42% e komunave (16 nga 38) paraqitën shtojcën e BPGJ-së të kërkuar nga Ministria e Financave me Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB).⁷⁴ Si praktika më të mira, komuna e Kamenicës, Gjakovës dhe Hanit të Elezit kanë ndërmarrë disa hapa drejt zbatimit të BPGJ-së dhe e kanë përfshirë atë në KAB dhe buxhetin vjetor komunal. Ngjashëm, vetëm 35% e të gjitha ministrive dhe organizatave të tjera buxhetore, paraqitën shtojcën e BPGJ-së me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve në vitin 2017 (19 nga 54).⁷⁵ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), MBPZHR-ja, MASHT-i, MMPH-ja, MTI-ja dhe Ministria e Diasporës që të gjitha kanë kryer analiza gjinore me mbështetjen e ekspertëve gjinorë për të informuar BPGJ-së në ministritë e tyre.⁷⁶ Disa nëpunës civilë në nivel qendror dhe komunal kanë ndjekur trajnime për BPGJ-në dhe IKAP-i ka adoptuar një kurrikulë për trajnim në të ardhmen.⁷⁷ Megjithatë, proceset e trajnimit dhe BPGJ-së ende nuk janë institucionalizuar plotësisht si pjesë e procesit të planifikimit buxhetor vjetor dhe afatmesëm, e lëre më në lidhje me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e shpenzimeve buxhetore.

Shoqëria civile

BE-ja ka njohur rëndësinë e fondeve për shoqërinë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë organizatat e të drejtave të njeriut dhe organizatat e grave.⁷⁸ Roli i OGSHC-ve dhe lëvizjeve të grave për të kontribuar në ndryshimet transformuese është dokumentuar.⁷⁹ Megjithatë, Udhëzuesi për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile është kryesisht i mangët për nga aspekti gjinor. BE-ja hëpërhë nuk mban statistika të zbërthyera sipas gjinisë në lidhje me numrin e granteve dhe shumën e fondeve të ofruara për OGSHC-të dhe lëvizjet e grave.

OGSHC-të tregojnë tendencë të resurseve të pakta; burimet e pamjaftueshme njerëzore e bëjnë të vështirë për to që të angazhohen në proceset e demokracisë dhe qeverisjes.⁸⁰ Përkundër disa përmirësimeve, disa OGSHC, veçanërisht në zonat rurale, ende nuk kanë ekspertizë dhe nuk i kuptojnë këto procese. Fare pak OGSHC kanë mbështetje institucionale, si për shembull përmes granteve operative. Pjesa më e madhe e OGSHC-ve kanë grante afatshkurtra që kontribuojnë në ndërhyrje të pjesshme dhe me kronologji të çrregullt, të cilat pengojnë ndikimin afatgjatë në transformimin e normave dhe marrëdhënieve gjinore.⁸¹ Ndryshimet e qëndrueshme të politikave dhe ato shoqërore kërkojnë bukuri shumë kohë. Gjithashtu, koha e kaluar në ngritje të fondeve dhe raportim merr kohë nga puna e tyre në avokim dhe aktiviteteve të tjera.

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: “Të drejta dhe mundësi të barabarta për gratë për pjesëmarrje në proceset e politikave dhe qeverisjes në të gjitha nivelet” (PVGJ 17).
 - o Treguesit:
 - 1) “Përpjesa e ulëseve që mbajnë gratë në parlamentet kombëtare” (Kuari i Rezultateve të BE-së [KRBE] Niveli I, PVGJ 17.1). *Pikënisja: 32% gra.*
 - 2) Përqindja e grave dhe e burrave në kuvendet komunale. *Pikënisja: 33% gra, 67% burra;*
 - 3) Përqindja e “ulëseve që mbajnë gratë dhe pakicat në parlamentin kombëtar dhe ose në zyrën e zgjedhur në nivel nënkombëtar sipas pjesës së tyre gjegjëse të popullsisë (Synim i Zhvillimit të Qëndrueshëm, SZHQ, 5.43)”. *Pikënisja 31.4% e ulëseve në parlament mbahen nga gratë, duke përfshirë gratë nga grupet etnike në vijim: 25.6% shqiptare, 3.3% serbe, 1.7% boshnjake, 0.8% turke dhe 0% rome, ashkale, egjiptiane dhe gorane, gjegjësisht. Në kuadër të kuvendeve komunale, 35.4% e ulëseve mbahen nga gratë, duke përfshirë: 28.7%*

shqiptare, 5.6% serbe, 0.3% boshnjake, 0.7% turke 0.1% gorane, dhe 0% rome, ashkallie dhe egjiptiane, gjegjësisht.

- 4) Përqindja e grave dhe e burrave në administratën publike, të zbërthyera sipas gjinisë dhe pozitës së vendimmarrjes. *Pikënisja: 40% gra, 60% burra në përgjithësi; 27% gra, 73% burra në pozita vendimmarrëse në nivel qendror; 33% gra, 67% burra në nivel komunal; dhe 20% gra, 80% burra në pozita vendimmarrëse në nivel komunal.*
- 5) Përqindja e grave dhe e burrave në pozita udhëheqëse në institucionet kombëtare. *Pikënisja: 27% gra, 83% burra.*
- 6) “Përfaqësimi i grave në radhët e ndërmjetësve, negociatorëve dhe ekspertëve teknikë në negociata zyrtare të paqes” (SZHQ 16.8, PVGJ 17.4).

o Veprimet:

- 1) “Mbështetje për legjislacionin dhe politikat që largojnë pengesat për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në përputhje me CEDAW, Planin e Veprimit të Pekinit, RKSOKB1325 dhe SZHQ-të” (PVZH 17), të tillë si: a) mbështetje për institucionalizimin dhe futjen në përdorim të masave afirmative në procesin e punësimit dhe ngritjes në detyrë të nëpunësve civilë; b) mbështetje për institucionalizimin dhe futjen në përdorim të masave afirmative në proceset e përzgjedhjes për bordet e pavarura dhe ndërmarrjet publike; c) mbështetje për përmirësimin e infrastrukturës në lidhje me shërbimet e transportit publik dhe të kujdesit që janë në dispozicion, duke iu bërë të mundur më shumë grave që të hyjnë në politikë.
 - 2) Inkurajimi politik i qeverisë që të “garantojë pjesëmarrjen e organizatave autonome të grave në proceset legjislative dhe politikë-bërje” (PVGJ).
 - 3) “Promovimi i rolit të grave në radhët e ndërmjetësve, negociatorëve dhe ekspertëve teknikë në parandalimin formal të konflikteve, negociata të paqes dhe paqe-bërje” (PVGJ).
 - 4) “Promovimi i ndryshimeve të sjelljes në vendimmarrje, luftimi i normave diskriminuese sociale dhe stereotipave gjinorë në nivel familjar dhe komunitar, nëpërmjet edukimit publik dhe fushatave mediatike, angazhimi me po aq gra sa edhe burra të të gjitha moshave” (PVGJ).
- Objekti: “Organizatave të grave dhe OSHC-të e tjera dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut që punojnë për barazi gjinore dhe fuqizim dhe të drejta të grave dhe vajzave punojnë lirshëm dhe mbrohen me ligj” (PVGJ 18).
 - Treguesit:
 - 1) Numri i OSHC-ve që angazhohen në procese politike me mbështetje nga BE-ja.⁸² *Pikënisja: E përcaktueshme në bazë të projekteve të mëparshme.*
 - 2) Numri i grave që marrin pjesë në procese vendimmarrëse me mbështetjen e BE-së. *Pikënisja: E përcaktueshme në bazë të projekteve të mëparshme.*
 - Veprimet:
 - 1) “Mbështetja për pjesëmarrjen e organizatave të grave si faktorë të llogaridhënies në proceset buxhetore, legjislative dhe të politikëbërjes në të gjitha nivelet” (PVGJ). Të inkurajohen fuqishëm organet qeveritare për të siguruar që OSHC-të ftohen të marrin pjesë në mënyrë kuptimplotë në grupet punuese qeveritare.
 - 2) Të mbështetet përdorimi i “Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) si katalizator për fuqizimin politik dhe social të vajzave dhe grave, dhe për të promovuar lirinë e tyre të shprehjes, barazinë gjinore dhe fuqizimin dhe të drejtat dhe politikëbërjen e grave dhe vajzave” (PVGJ).
 - 3) Sigurimi i mbështetjes financiare për organizatat dhe lëvizjet për të drejtat e grave në mobilizimin dhe angazhimin me zgjedhësit, veçanërisht gratë, për të marrë pjesë në proceset politike. Të konsiderohen në veçanti grantet operationale dhe përkrahja afatgjatë.
 - Objekti: “Kultivimi i partneriteteve ndërmjet BE-së dhe hisedarëve për të ndërtuar kapacitetet kombëtare për barazi gjinore” (PVGJ 6).
 - o Treguesit:
 - 1) Përqindja e komunave që dorëzojnë shtojcën e BPGJ-së me KAB-in e tyre. *Pikënisja: 42%.*
 - 2) Përqindja e ministrive, agjencive dhe organizatave të tjera buxhetore që dorëzojnë shtojcën e BPGJ-së. *Pikënisja: 35%.*

o Veprimet:

- 1) Mbështetje për BPGJ-në (PVGJ 6.1 dhe 17.7), duke përfshirë: a) inkurajimin e ABGJ-së dhe Ministrisë së Financave për të finalizuar, adoptuar dhe zbatuar konceptin për inkorporimin e BPGJ-së në sistemet dhe proceset e menaxhimit financiar publik; b) mbështetjen për IKAP-in për të vazhduar me ofrimin e trajnimit interaktiv mbi BPGJ-në për nëpunësit civilë, duke e përditësuar atë sipas nevojës bazuar në çdo ndryshim në sistemet dhe procedurat ekzistuese; c) inkurajimin e të gjitha organizatave buxhetore që të kryejnë analiza gjinore, si dhe ta përdorin analizën gjinore për të informuar programimin dhe buxhetimin, me mbështetje nga OGSHC-të me përvojë; dhe d) inkurajimin e organizatave buxhetore për t'i angazhuar qytetarët, gra e burra, duke përfshirë MKBGJ-të, në konsultimet publike për buxhetin.

Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore

Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore janë boshti i politikës së BE-së, veçanërisht për vendet kandidate potenciale si Kosova. Arritja e stabilitetit të institucioneve që garantojnë të drejtat e njeriut, sundim të ligjit dhe mbrojtje të të drejtave të pakicave është prioritet në kriteret e Kopenhagës.¹ Kjo pjesë ofron analizën gjinore të politikave dhe praktikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe sundimin e ligjit. Edhe pse ka një bollëk temash që mund të diskutohet, kjo pjesë fokusohet në fushat ku janë identifikuar pabarazitë kyçe gjinore. Pas një pasqyre të ligjit të zbatueshëm gjerësisht, në nënpjesë shqyrtohen: të drejtat e pronësisë dhe trashëgimisë; drejtësia dhe institucionet përkatëse; kryesit e krimeve; dhuna në bazë gjinore; dhuna seksuale e lidhur me konfliktin; të drejtat e komunitetit LGBTQI; të drejtat fetare; dhe kthimi dhe riatdhesimi.

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- CEDAW përkufizon diskriminimin ndaj grave si: “Çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë”.² Konventa gjithashtu deklaron qëllimin e saj për të promovuar dhe mishëruar barazinë gjinore në legjislacionin e brendshëm, që shtetet të shfuqizojnë nga ligjet e tyre të gjitha dispozitat diskriminuese dhe të synojnë të miratojnë ligje të reja të cilat ndalojnë çdo formë të diskriminimit ndaj grave.³ Më tej, shtetet duhet: “Të marrin masa në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore, dhe të gjitha praktikat e tjera që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit apo të tjetrit seks, ose në rolet stereotipe të burrit dhe të gruas”.⁴
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj, Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë sipas Kushtetutës.⁵
- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian përmban të drejtat dhe liritë nën gjashtë kapituj: Dinjiteti, Liritë, Barazia, Solidariteti, Të drejtat e qytetarëve dhe Drejtësia. Barazia midis burrave dhe grave duhet të sigurohet në të gjitha fushat, duke përfshirë punësimin, punën dhe pagën.⁶
- Direktiva për qasje të barabartë për nga aspekti gjinor në mallra dhe shërbime⁷ vendos kuadrin për luftimin e diskriminimit në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime. Ajo vlen për të gjithë ofruesit në sektorin publik dhe privat. Direktiva është transpozuar formalisht në ligjin kosovar. Mirëpo, nuk ka informata se si po zbatohet legjislacioni.⁸

- Direktiva për barazi racore⁹ synon të luftojë diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike dhe pranon se gratë shpesh janë viktime të diskriminimit të shumëfishtë. Kjo është pjesërisht e transpozuar në kuadër të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi.
- Kushtetuta “siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore”.¹⁰ Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të gjinisë, sipas Kushtetutës¹¹; dhe përbërja e institucioneve të ndryshme duhet të pasqyrojë parimin e barazisë gjinore.¹²
- Ligji për barazi gjinore¹³ garanton “mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera”. Ligji përcakton masa të ndryshme të përgjithshme (për “parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore”)¹⁴ dhe masa të përkohshme të veçanta (me qëllim të “përsheptimit të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi”)¹⁵ që ndërmerren nga institucionet publike. Masat e përgjithshme përfshijnë përfshirjen e aspektit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe strategjitë, BPGJ-në dhe regjistrimin e të dhënave të zbërthyera sipas gjinisë.¹⁶ Masat e veçanta përfshijnë kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë dhe veprime pozitive.¹⁷
- Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi¹⁸ ka fushëveprim të gjerë që mbulon qasjen në punësim dhe aftësim profesional, kushtet e punësimit, anëtarësimin në organizatat e punëtorëve, mbrojtjen sociale, arsimin dhe trajnimin, banimin, furnizimin me mallra dhe shërbime, dhe qasjen në hapësira publike. Zbatimi me sa duket është penguar nga informimi i pamjaftueshëm i qytetarëve, vetëdijesimi i kufizuar rreth Ligjit në organet gjyqësore dhe administrative dhe përdorimi i rrallë i Ligjit në gjykata.¹⁹
- Ligji për Avokatin e Popullit²⁰ detajon kompetencat, përgjegjësitë dhe procedurat e ankesave të këtij institucioni të pavarur, i cili pranon dhe heton ankesat që kanë të bëjnë me diskriminimin. Avokati i Popullit gjithashtu referohet në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi,²¹ dhe në LBGJ.²² Të gjitha shërbimet duhet të jenë falas. Rekomandimet e nxjerra nga Avokati i Popullit nuk janë të detyrueshme, por ilustron praktikën më të mirë në lidhje me të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mirë.

Gjetjet

Në përgjithësi, kuadri i lartpërmendur ligjor dhe politik në Kosovë parasheh barazinë gjinore, duke përfshirë të drejtat e barabarta për gratë dhe burrat. Sidoqoftë, mbeten sfida në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, siç është shtjelluar në pjesët e mëvonshme të kësaj analize.²³

Të drejtat e pronës dhe trashëgimisë

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- CEDAW kërkon të drejta të barabarta për secilin prej bashkëshortëve lidhur me pronësinë, blerjen, administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë.²⁴
- Kushtetuta përcakton që e drejta e pronës është e garantuar për të gjithë dhe se askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona.²⁵
- Ligji për familjen²⁶ përmban një kapitull për marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve. Pasuria e cila i ka takuar një bashkëshorti në çastin e lidhjes së martesës do të mbetet pasuri e veçantë. Pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimin të martesës është pasuri e përbashkët. Kur gjykata vlerëson pjesën e secilit bashkëshort në pasurinë e përbashkët, vendimi bazohet në kontributin e secilit bashkëshort, duke marrë parasysh jo vetëm të ardhurat personale por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër (duke përfshirë “kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët”).

- Ligji për trashëgiminë²⁷ parasheh që të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi. Ligji parasheh që “fëmijët e lindur jashtë martesë, kur atësia është njohur ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent”, si dhe fëmijët e adoptuar barazohen me fëmijët e tjerë. Kur nuk është bërë testament ose testamenti është i pavlefshëm, fëmijët dhe bashkëshorti i të ndjerit trashëgojnë së pari, në pjesë të barabarta.²⁸ Trashëgimtarët mund të heqin dorë nga trashëgimia e tyre para gjykatës, nëse nuk janë nën shtrëngim.²⁹ Çifti që bashkëjeton në bashkësi jashtëmartesore mund të trashëgojnë njëri-tjetrin si bashkëshortë, nëse marrëdhënia ka zgjatur të paktën 10 vjet, e nëse nga kjo marrëdhënie kanë lindur fëmijë-të paktën 5 vjet.³⁰
- Qëllimi i Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit është “krijimi i kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t’i përballojnë ofertat e tregut të lirë” [sic].³¹ Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë disa grupe të caktuara të përfituesve, duke përfshirë “familjet ku kryefamiljari është grua-mbajtëse e familjes” [sic].³²
- Disa ligje të tjera adresojnë të drejtat pronësore, siç është Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,³³ Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve,³⁴ Ligji për procedurën jokontestimore³⁵ dhe Ligji për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.³⁶ Këto ligje nuk përbajnë pikëpamje gjinore.
- Udhëzimi Administrativ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve synon të stimulojë regjistrimin e pronave të paluajtshme të përbashkëta në emër të të dy bashkëshortëve në regjistrat publik.³⁷ Ai ka për qëllim rritjen e numrit të grave të regjistruara si pronare të përbashkëta dhe përshejtimin e realizimit të barazisë midis burrave dhe grave në kuptim të të drejtave pronësore.³⁸ Ky akt normativ është i detyrueshëm për të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, autoritetet tjera dhe personat fizikë që kryejnë autorizime publike që ndërlidhen me regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve. Fillimisht, ky Udhëzim Administrativ ishte i zbatueshëm për një vit, por periudha e zbatueshmërisë është vazhduar për vitin 2019.³⁹
- Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore⁴⁰ në kuadër të qëllimeve të saj përfshin synimin e garantimit dhe zbatimit të të drejtave pronësore të grave. Rekomandimet e Strategjisë përfshijnë sigurimin e njohjes ligjore të bashkëjetesës që është ekuivalente me martesën pas pesë viteve apo tri viteve në rast se ka fëmijë. Aty gjithashtu sugjerohet futja e masave mbrojtëse për trashëgimtarët që janë gra, për t’u informuar plotësisht për të drejtat e tyre ligjore dhe vlerën e pjesës së tyre të pasurisë para marrjes së vendimit përfundimtar, nëse e kanë ndërmend të heqin dorë nga e drejta e trashëgimisë.

Gjetjet

Sipas Agjencisë Kadastrale, në shtator 2017 gratë zotëronin 17% të të gjitha pronave në Kosovë.⁴¹ Ky posedim është rritur nga 14% në vitin 2016. Shkalla e ulët e zotërimit të pronës krijon probleme të ndryshme ekonomike dhe sociale për gratë, të tilla si mospasja e kolateralit të mjaftueshëm për hua, ose mospasja e mundësisë për të realizuar të drejtat pas vdekjes së bashkëshortit ose shkurorëzimit.⁴² Pa të drejta pronësore, gratë mund të qëndrojnë në martesë të vështira, duke pasur frikë se shkurorëzimi mund t’i bëjë ato të pastrehë.⁴³ Asnjë monitorim i njohur nuk ka shqyrtuar zbatimin praktik të dispozitave të Ligjit për familjen që parashikojnë që gjykatat duhet të marrin parasysh kontributin e bashkëshortëve nëpërmjet aktiviteteve të papaguara në shtëpi kur të merren vendime mbi hisen e secilit bashkëshort në pronën e përbashkët në rastet e shkurorëzimit.

Përafërsisht 38% e burrave dhe 33% e grave mendojnë se gratë nuk duhet të trashëgojnë pronën nga familjet e tyre të lindjes/gjinisë.⁴⁴ Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore vë në dukje se gratë përjashtohen nga e drejta e trashëgimit prej partnerëve të tyre, përveç kur arrijnë të dëshmojnë se kanë bashkëjetuar për 10 vite ose 5 vite me fëmijë. Ndonjëherë gratë përjashtohen nga e drejta e trashëgimit të pasurisë nga familja e lindjes për shkak se ato nuk përfshihen në Aktin e Vdekjes, që është dokumenti civil që përdoret për të vendosur mbi ndarjen e trashëgimisë midis anëtarëve të familjes.

Vlerësohet se rreth 19% e grave heqin dorë nga të drejtat e tyre pronësore ose të trashëgimisë. Faktorët që kontribuojnë që gratë të heqin dorë nga e drejta e tyre për pronë ose trashëgimi përfshijnë:

frikën e bartjes së pronës së familjes ku kanë lindur te familja e bashkëshortit të tyre (12%); dhe arsye të tjera (18%), të tilla si: “unë nuk dua hise nga prindërit e mi”; “unë dua të krijoj pasuri me familjen time/me familjen e burrit”; “dëshirë personale”; dhe “mundësia e krijimit të armiqësisë në familje”.⁴⁵ Qeveria e Kosovës është në procesin e krijimit të një Kodi Civil të ri, dhe ka pasur diskutime lidhur me atë sesi mund të adresohen sfidat me të cilat ballafaqohen gratë në lidhje me trashëgiminë dhe pronësinë.⁴⁶

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: Rritja e përqindjes së pronës së zotëruar nga gratë⁴⁷ (duke kontribuar në PVGJ 15: “Qasja e barabartë për gratë në shërbimet financiare, resurset prodhuese, përfshirë tokën, tregtinë dhe ndërmarrësinë”).
 - o Treguesit:
 - 1) Përqindja e “grave, burrave, popujve indigjenë dhe komuniteteve lokale me dëshmi të dokumentuara ose të njohura të zotërimit” (SZHQ 1.5, PVGJ 15.1). *Pikënisja: 17% e grave dhe 79% e burrave në vitin 2017.*⁴⁸
 - 2) Numri i “grave dhe burrave që kanë [siguruar] zotërim të sigurt të tokës me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 15.7).
 - o Veprimet:
 - 1) “Mbështetja e legjislacionit transformues për pronësinë, trashëgiminë dhe kontrollin e tokës dhe resurseve të tjera prodhuese nga gratë, me vëmendje të veçantë për popujt indigjenë” (PVGJ 15). Më konkretisht: a) të inkurajohet qeveria që të vazhdojë me ripërtëritjen e Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e përbashkët të pronës, duke zgjeruar atë për të përfshirë gratë e pamartuara, sidomos të vejat; b) të mbështetet finalizimi i Kodit Civil, duke përfshirë masat e veçanta për parandalimin e diskriminimit ndaj grave në zotërimin dhe trashëgiminë e pronës; dhe c) të mbështetet njohja e martesave faktike pas pesë vjetësh, apo tre vjetësh ku përfshihen fëmijët, si dhe të krijohet mundësia ligjore për regjistrimin e marrëdhënieve të bashkëjetesës në të cilat palët nuk dëshirojnë të martohen.⁴⁹
 - 2) Të mbështetet zhvillimi i shtysave që inkurajojnë familjet ku kryefamiljari është grua që të formalizojnë të drejtat e tyre pronësore.⁵⁰
 - 3) Të mbështeten përmirësimet në proceset e trashëgimisë, duke siguruar përfshirjen e grave në diskutimin e Aktit të Vdekjes dhe pjesën e barabartë të trashëgimisë.⁵¹ Të mbështetet qasja elektronike në Zyrën e Regjistrimit Civil nga gjykatat dhe noterët për sigurimin e dokumenteve të regjistrimit civil për të informuar rastet e trashëgimisë dhe të drejtave pronësore.
 - 4) Të mbështeten proceset e ndryshimit social dhe të sjelljes për të përmirësuar pranimin social të zotërimit të pronës nga gratë.⁵²
 - 5) Të mbështetet monitorimi nga shoqëria civile për zbatimin e dispozitës së Ligjit për familjen që parasheh se gjykatat duhet të vlerësojnë kontributin e secilit bashkëshort kur e bëjnë ndarjen e pronës së përbashkët.

Drejtësia dhe institucionet përgjegjëse

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- Direktiva për të drejtat e viktimave synon të “sigurojë që viktimat e krimit marrin informacion, mbështetje dhe mbrojtje të përshtatshme dhe janë në gjendje të marrin pjesë në procedurat penale”. Direktiva ka për synim, mes tjerash, “promovimin e parimit të mosdiskriminimit, parimit të barazisë midis grave dhe burrave, të drejtave të fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe të drejtës për proces të rregullt gjyqësor”.⁵³ Direktiva është transpozuar pjesërisht në Kodin e Procedurës Penale.
- Ligji për gjykatat⁵⁴ siguron që përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe është në pajtim me parimin e barazisë gjinore. Një kuotë prej 15% (por jo më pak se 10 vende) në Gjykatën e Apelit është vendosur për gjyqtarët nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.⁵⁵

Një kuotë e ngjashme është vendosur për Gjykatën Supreme.⁵⁶ Asnjë kuotë e tillë gjinore nuk ekziston në Ligj. Megjithatë, LBGJ-ja përkufizon përfaqësimin e barabartë gjinor si 50% për secilën gjini.⁵⁷ Sa i përket qasjes në gjykatë, Ligji thotë që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë, “pa diskriminim në bazë të [...] gjinisë”, orientimit seksual ose ndonjë statusi tjetër.⁵⁸

- Kodi Penal⁵⁹ përshkruan disa vepra penale që mund të përfshijnë dhunë me bazë gjinore (p.sh. dhunimi, sulmi seksual dhe trafikimi, e të tjera). Edhe pse Kodi po rishikohej në vitin 2018, në atë kohë nuk kishte përkufizime përkatëse për dhunën në familje, ngacmimin seksual, gjymtimin gjenital femëror dhe abortin e detyruar. Dispozita të kufizuara në Kodin Penal autorizojnë shqiptimin e dënimit më të lartë për krimet e kryera me “motive parajgykimi” (krimet e urrejtjes).
- Në Kodin e Procedurës Penale⁶⁰ mungon procedura e qartë për mbledhjen e provave mjeko-ligjore dhe mbështetjen psikologjike për viktimat. Frikësimi i dëshmitarëve mbetet shqetësim për shkak të mungesës së përpikërisë në Kod në përcaktimin e asaj që mund të përbëjë frikësim.
- Ligji për ndihmë juridike falas⁶¹ themelon Këshillin për Ndihmë Juridike Falas dhe përcakton kriteret që duhet t'i plotësojnë qytetarët për realizimin e ndihmës juridike falas (kriteret për kualifikim, ato financiare dhe ligjore).⁶² Ligji thotë se përfituesit e ndihmës juridike kanë të drejtë pavarësisht nga identiteti gjinor apo orientimi seksual, ndër të tjera. Megjithatë, ai këtu nuk i referohet shprehimisht seksit apo gjinisë. Ndihma juridike gjithashtu parashihet në Kushtetutë, por kjo kufizohet në gjykimet penale kur i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme financiare.⁶³ Kodi i Procedurës Penale e shtjellon këtë dispozitë në dy nene; një për mbrojtjen e detyrueshme (situatat në të cilat i akuzuari *duhet të* ketë avokat mbrojtës) dhe tjetri për mbrojtje jo të detyrueshme (situatat në të cilat i pandehuri mund të kërkojë avokat mbrojtës).⁶⁴
- Ligji për ndërmjetësim⁶⁵ rregullon procedurën e ndërmjetësimit, funksionimin e Komisionit të Ndërmjetësimit, si dhe të drejtat, detyrat dhe kualifikimet e ndërmjetësuesve. Ky ligj nuk përmban pikëpamje gjinore. Sipas Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërmjetësimi ose pajtimi mund të shfrytëzohen vetëm sipas zgjedhjes së parashtruesit të kërkesës. Kështu, ndërmjetësimi i detyrueshëm është i ndaluar.
- Ligji për policinë⁶⁶ thekson se veprimet e policisë udhëhiqen nga parimet e trajtimit të barabartë dhe të drejtë të të gjithë personave, ndër të tjera dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Në punësim, ngritje në detyrë dhe caktim të detyrave, policia duhet të veprojë pa diskriminim duke reflektuar karakterin shumetnik të Kosovës “dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutë”. Ligji parasheh që personat nën ndalim të përkohshëm policor nuk mbahen së bashku me personat e “gjinisë së kundërt”.⁶⁷
- Ligji për inspektoratin policor⁶⁸ kërkon që inspektorati të pasqyrojë përbërjen shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë.
- Ligji për Prokurorin e Shtetit⁶⁹ kërkon që secili Prokuror i Shtetit të sigurojë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa parajgykime për të gjithë personat para ligjit, “pavarësisht gjinisë”. Emërimi i prokurorëve duhet të pasqyrojë përbërjen shumetnike të Kosovës dhe të respektojë barazinë gjinore. Kjo parashihet si në Kushtetutë ashtu edhe në Ligj.⁷⁰
- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale⁷¹ rregullon masat e paraburgimit. Gratë dhe burrat duhet të akomodohen ndaras, “[g]ratë shtatzëna, gratë që lindin fëmijë dhe nënat që përkujdesen për fëmijët e tyre vendosen ndaras nga gratë e tjera të dënuara”.⁷² Gratë shtatzëna kanë të drejtë për shërbime të kujdesit shëndetësor dhe kudo që është e mundur bëhen përgatitje që fëmijët të lindin në spital jashtë institucionit.⁷³ Ekzekutimi i dënimit me burgim mund të shtyhet nëse gruaja e dënuar e ka përfunduar muajin e gjashtë të shtatzënisë, ose e ka fëmijën më të vogël se një (1) vjeç, derisa fëmija të arrijë moshën tre vjeç.⁷⁴ Gratë e dënuara kanë të drejtë të mos punojnë për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë.⁷⁵
- Udhëzim Administrativ për funksionimin e shërbimeve shëndetësore të burgjeve⁷⁶ për gratë e burgosura parasheh ofrimin e trajtimit gjinekologjik dhe “trajtimin e shtatzënave dhe foshnjave deri në moshën 18 muajsh”.
- Rregullorja për mandatin, strukturën dhe funksionimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave⁷⁷ detajon rolin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave. Nga mbrojtësit e viktimave kërkohet të

veprojnë pa diskriminim në bazë të racës, përkatësisë kombëtare, gjinisë, orientimit seksual, moshës, statusit martesor, etj.⁷⁸

Gjetjet

Policia e Kosovës

Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në numër gjithsej dhe në pozita udhëheqëse në Policinë e Kosovës. Në vitin 2017, vetëm 14% e 8,820 punonjësve të Policisë së Kosovës ishin gra (11% të zyrtarëve të uniformuar). Arsyet përfshijnë kushtet e vështira të punës, pagat e ulëta dhe stereotipat mbizotërues gjinor.⁷⁹ Zyrtaret kanë themeluar Shoqatën e Grave të Policisë së Kosovës për të mbështetur njëra-tjetrën dhe për të avokuar për interesat e përbashkëta.

Prokuroria

Burrat janë në krye të të gjitha 10 zyrave të prokurorisë në Kosovë. Nga 201 prokurorë, 63 janë gra (31%).⁸⁰ Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) shtoi një kuotë gjinore në rregulloren e vet të punës, sipas së cilës tre nga 13 anëtarët e KPK-së duhet të jenë gra. Kjo nuk përmbush kërkesat e LBGJ-së për përfaqësim të barabartë. Barra e dyfishtë me të cilën përballen gratë lidhur me aktivitetet e amvisërisë dhe kujdesit është një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen prokuroret.⁸¹ Diskriminimi i tërthortë gjithashtu mund të luajë rol, pasi që panelet e intervistave përbëhen kryesisht nga burrat që vazhdojnë të preferojnë të punojnë me kolegë të tjerë burra.⁸² Prokurorët burra dhe gra nuk trajtohen gjithmonë në mënyrë të barabartë; prokuroret shpesh nuk konsultohen dhe me to nuk ndahen informata të mjaftueshme. Fakti që prokurorët burra ndajnë një sasi të konsiderueshme informacioni pas orarit të punës, si në kafene apo bare, minon qasjen e prokuroreve në informata, shpesh për shkak të përgjegjësive shtëpiake.⁸³ Nënpërfaqësimi i grave në radhët e prokurorëve mund të ketë pasoja, sidomos për viktimat e dhunës me bazë gjinore, të cilat mund të ndihen më lirshëm kur flasin me gratë.

Në vitin 2017, prokuroria ndërmori hapa drejt përmirësimit të reagimit institucional ndaj dhunës në familje duke caktuar prokurorët për të kryer trajnime të specializuara për qasjen e tyre në lëndë të tilla. Prokurorët janë emëruar dhe Termat e Referimit janë vendosur, por procesi është ende në fazën fillestare.⁸⁴ Trajnimi për çështje gjinore ende nuk është institucionalizuar. Komunikimet dhe qasja te prokurorët serbisht-folës thuhet se mbetet problem në veri, duke minuar qasjen në drejtësi, duke përfshirë edhe rastet e dhunës në bazë gjinore.

Gjykatat

Vetëm 27% e të gjithë gjyqtarëve në Kosovë janë gra (94 nga 352 gjyqtarë gjithsej).⁸⁵ Nga 10 krerë të gjykatave në Kosovë, dy janë gra (20%): Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Themelore në Prishtinë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) gjithashtu udhëhiqet nga një burrë. Hëpërhë një kryetar gjykate është i përkatësisë etnike pakicë. Trajnimi për çështje gjinore ende nuk është institucionalizuar për gjyqtarët.

Shumica e gjykatave kanë caktuar gjyqtarë për t'u marrë me rastet e dhunës në familje, si në gjykatat penale ashtu edhe ato civile. Ndërsa puna e gjyqtarëve të gjykatave penale dhe civile është përmirësuar kur bëhet fjalë për dhënien e prioritetit për rastet e dhunës në familje si shkelje e të drejtave të njeriut, disa gjyqtarë ende nuk kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me llojet e ndryshme të dhunës.⁸⁶ Disa gjyqtarë akoma "fajësojnë viktimën", duke ia atribuuar fajin personit që ka pësuar krimin.⁸⁷ Mungesa e përkufizimit të dhunës në familje si vepër penale në Kodin Penal ka penguar punën e gjyqtarëve në gjykatat penale.⁸⁸ Ndryshimi që do të përfshinte dhunën në familje si vepër penale në Kodin Penal është propozuar, por ende nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në vitin 2018. Gjykatat nuk mbajnë të dhënat elektronike të zbërthyer sipas gjinisë, gjë që kontribuon në sfidat në monitorimin e çdo paragjykimi të mundshëm gjinor që mund të ekzistojë në procedimin dhe dënimin e rasteve.

Mbrojtësit e viktimave

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), e vendosur në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës, mbështet viktimat, përfshirë këtu viktimat lidhur me dhunën në familje dhe krimet e tjera të rënda. Ata sigurojnë se viktimat mund të informohet për shërbimet që mund t'i ofrohen nga Shteti dhe si mund t'i marrë ato, si personalisht ashtu edhe përmes linjës ndihmëse.⁸⁹ Në 2017, ZMNV-

ja ndihmoi në 1,374 raste (76% gra), kryesisht lidhur me dhunën në familje (1,081).⁹⁰ Në përgjithësi mbrojtësit e viktimave kanë marrë trajnim të mjaftueshëm dhe kanë qasje të përshtatshme kur ndihmojnë viktimat.⁹¹ Aktualisht nuk ka të dhëna të zbërthyera sipas gjinisë për rastet e dhunës në familje të ndihmuara nga ZMNV-ja.

Zyrat për ndihmë juridike

Financimi i pamjaftueshëm nga qeveria ka rezultuar me mbylljen e disa zyrave për ndihmë juridike, dhe OSHC-të kanë marrë raporte se personat nuk kanë mundur të marrin ndihmë juridike falas, gjë që sugjeron se asistenca nuk është në dispozicion për të gjithë.⁹² Gjithashtu, thuhet se fondet joadekuate shtetërore për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) kufizojnë ndihmën vetëm për lëndët civile dhe administrative.⁹³ Kjo është përkundër faktit se ligji parasheh që ndihma të sigurohet në lëndët penale, aty ku është e nevojshme. Për më tepër, alokimi i kufizuar i fondeve mund të vendosë ANJF-në në rrezik nga mbyllja.⁹⁴ Strategjia për asistencë në sektorin e sundimi të ligjit në Kosovë 2016-2019 përsërit se “infrastruktura fizike për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas [...] mbetet një nga sfidat kryesore”.⁹⁵ Nga 3,381 përfitues të ndihmës juridike në vitin 2017, 52% ishin burra dhe 48% gra.⁹⁶

Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi, si alternativë e gjykatave, është më efikas për palët e përfshira; ai ndihmon në arritjen e zgjidhjes së kontesteve me kohë, sepse gjykatat e Kosovës janë të mbingarkuara dhe kanë resurse të pamjaftueshme.⁹⁷ Nga numri i përgjithshëm i rasteve në shtatë qendra të ndërmjetësimit në vitin 2017,⁹⁸ 310 përfshinin gra (12%) dhe 2,251 përfshinin burra (88%).⁹⁹ Ndërmjetëset thuhet të kenë luajtur rol vendimtar në ndërmjetësimin e rasteve ku klientët ballafaqoheshin me çështje që kishin të bëjnë me gjininë.¹⁰⁰ Mirëpo, përdorimi i ndërmjetësimit në rastet që përfshijnë dhunën në bazë gjinore mund t'i vejë në rrezik viktimat.¹⁰¹ Ndryshimet e propozuara në Ligjin për ndërmjetësim kanë përjashtuar mundësinë e përdorimit të ndërmjetësimit në rastet e dhunës në familje.

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- **Objektivi:** Përmirësimi i përfaqësimit të barabartë në radhët e policëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve, duke përfshirë nivelet vendimmarrëse.
 - o **Treguesi:** Përqindja e grave dhe burrave në radhët e policëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve, e zbërthyer sipas nivelit të vendimmarrjes. *Pikënisja: policia: 14% gra; prokurorët: 38% gra; krerë të zyrave të prokurorisë: 0% gra; gjyqtarët: 28% gra; krerë të gjykatave: 20% gra.*
 - o **Veprimet:**
 - 1) Të mbështetet policia, prokuroria dhe gjyqësori, përkatësisht, për të institucionalizuar masa afirmative që do të kontribuojnë në përfaqësimin e barabartë, duke përfshirë nivelet vendimmarrëse.
 - 2) Në kuadër të reformave arsimore, të adresohen stereotipat e profesioneve sipas gjinisë që pengojnë përfshirjen e grave në këto institucione.
 - 3) Të mbështetet përmirësimi i disponueshmërisë së kujdesit dhe orari fleksibël i punës drejt baraspeshimit të punës dhe jetës, duke mundësuar më shumë gra të punojnë në këto institucione.
- **Objektivi:** Forcimi i qasjes së barabartë në drejtësi.¹⁰²
 - o **Treguesit:**
 - 1) “Numri i grave që përfitojnë nga programet e ndihmës juridike me mbështetjen e BE-së” (PVGJ 17.5). *Pikënisja: Specifike sipas projektit.*
 - 2) Përqindja e grave dhe burrave që i qasen ndërmjetësimit. *Pikënisja: 12% gra, 88% burra.*
 - o **Veprimet:**
 - 1) Të inkurajohet qeveria për të bërë alokimin e resurseve të mjaftueshme për të mbështetur funksionimin e zyrave të ndihmës juridike; dhe të mbështetet zhvillimi i politikave që u mundësojnë grupeve tjera të ndjeshme të kenë qasje në ndihmë juridike, duke përfshirë gratë që pësojnë dhunë në baza gjinore, të cilat nuk mund të angazhojnë ndihmë juridike me pagesë.

- 2) Të mbështeten fushatat e shtrirjes së informimit mbi qasjen në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit¹⁰³ për të informuar individët mbi të drejtat e tyre ligjore dhe për të lehtësuar kërkimin e ndihmës, veçanërisht duke vënë në shënjestër individët në zonat rurale¹⁰⁴ dhe komunitetet pakicë¹⁰⁵ në një mënyrë që merr parasysh aspektin gjinor.

Kryesit e krimeve

Gjetjet

Në përgjithësi, të dhënat e policisë sugjerojnë se shumë më tepër burra (94%) sesa gra (6%) janë të dyshuar për kryerjen e krimeve që përfshijnë dhunë në bazë gjinore.¹⁰⁶ Tendenca është gjithashtu që burrat të jenë dënuar për më shumë krime sesa gratë. Në vitin 2015, prej 16,344 personave madhorë të dënuar nga gjykatat themelore për krime të ndryshme, 95% ishin burra. Në vitin 2016, u dënuan 692 të mitur; 96% ishin djem (666 djem, 26 vajza).¹⁰⁷ Burrat përbëjnë rreth 98% të popullatës së burgjeve në Kosovë.¹⁰⁸ Në krahasim me gratë, burrat gjithashtu kanë më shumë gjasë të kryejnë vetëvrasje;¹⁰⁹ të shkaktojnë aksidente trafiku (95% në vitin 2017); dhe të vdesin në aksidente rrugore (96%).¹¹⁰

Për krimin e veçantë të korrupsionit, disa qytetarë kanë perceptimin se burrat janë më të përfshirë në praktika korruptive sesa gratë.¹¹¹ Arsytet që ata japin përfshijnë gatishmërinë e burrave për t'u përfshirë në praktika korruptive dhe se burrat mbajnë pozita vendimmarrëse, të cilat ofrojnë më shumë mundësi për t'u përfshirë në korrupsion.¹¹²

Rolet gjinore zakonisht janë konstruite të shoqërisë për të privilegjuar burrat dhe për t'u dhënë atyre më shumë vlerë sociale sesa grave. Ky privilegj kontribon që burrat të kryejnë dhunë ndaj grave dhe vajzave.¹¹³ Teoritë e ndryshme kriminologjike kanë shpjeguar në mënyrë të ngjashme hendeun gjinor te kryesit e krimit përmes normave të socializuara gjinore; veçanërisht nga burrat që aspirojnë të arrijnë “maskulinitetin hegjemonist”¹¹⁴ nëpërmjet sjelljeve që konsiderohen “mashkullore” nga kultura dhe shoqëria në kohën në të cilën ata jetojnë.¹¹⁵ Sjelljet mund të përfshijnë agresionin, fuqinë, kontrollin, autoritetin dhe kapacitetin për të qenë i dhunshëm; me kriminalitetin duke u bërë një mjet për të “bërë gjini” dhe duke demonstruar pushtet dhe autoritet të tillë kur resurset e tjera nuk janë në dispozicion.¹¹⁶ Kjo është e rëndësishme në Kosovë, ku besimet kulturore konsiderojnë se burrat duhet të jenë “të fortë”¹¹⁷ dhe normat patriarkale gjinore janë të përhapura gjerësisht.¹¹⁸ Në mënyrë të ngjashme, mundësitë e pamjaftueshme për arsimim dhe punësim mund të inkurajojnë burrat që të përdorin dhunën si mjet për të imponuar maskulinitetin e tyre.¹¹⁹ Mungesa e alternativave të shëmbëlltyrave të burrave, veçanërisht në nivel komuniteti, ripërforcon qëndrimet mbizotëruese patriarkale.¹²⁰ Për më tepër, normat e tilla shoqërore mund të kontribuojnë në homofobinë dhe mostolerancën ndaj personave LGBTQI, sidomos tek burrat.¹²¹

Entet korrektuese nuk kanë resurse për mirëmbajtjen ose përmirësimin e kushteve fizike, gjë që kontribuon në mbipopullim; dhe ka pak profesionistë të trajnuar që punojnë me të burgosurit (veçanërisht mjekë, infermierë, psikologë dhe psikiatër).¹²² Sistemi i drejtësisë gjithashtu përshkohet me vullnet të dobët politik dhe apati në ndjekjen e procedurave dhe sigurimin që të burgosurit kategorizohen, strehohen dhe u jepet kujdesi i duhur.¹²³ Thuhet se ekziston njëfarë korrupsioni institucional në entet korrektuese.¹²⁴ Këto çështje kontribuojnë në mungesën e programeve rehabilituese dhe dhunën e ndërsjellë midis të burgosurve.¹²⁵ Duke pasur parasysh se burrat janë të mbipërfaqësuar në entet korrektuese, këto mangësi kanë tendencë që të ndikojnë te burrat, por gjithashtu mund të kontribuojnë në dhunën recidiviste që prek gratë.¹²⁶

Ligji për rendin dhe qetësinë publike e sanksionon marrjen me prostitucion si kundërvajtje.¹²⁷ Mundësimi ose detyrimi i personit për t'u marrë me prostitucion paraqet vepër penale sipas Kodit Penal.¹²⁸ Ofrimi i lokaleve për prostitucion është gjithashtu vepër penale.¹²⁹ Vlerësohet se rreth 6,000 punonjës seksi janë aktivë në Kosovë.¹³⁰ Ka tendencë që gratë të jenë të mbipërfaqësuar midis punonjësve të seksit. Më shumë burra janë arrestuar për vepra penale që lidhen me prostitucionin sesa gra; në 2017, nga 75 arrestime, 45 ishin burra dhe 30 gra.¹³¹ Ekzistojnë informacione të kufizuara në lidhje me industrinë e seksit, të drejtat e punonjësve të seksit ose shkeljet e këtyre të drejtave. Gjithashtu mungon informacioni në lidhje me përfshirjen e fëmijëve, burrave, personave transgjinorë dhe interseks në industrinë e seksit. Kërkimet kanë sugjeruar se modelet e kriminalizimit si ato të vendosura në Kosovë

tjetërsojnë punonjësit e seksit nga shërbimet mbështetëse, kujdesi shëndetësor dhe zbatimi i ligjit, duke e bërë të vështirë llogaritjen e prevalencës.¹³²

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: Zvogëlimi i numrit të burrave që kryejnë krime.
 - o Treguesi: Numri i burrave që kryejnë krime. *Pikënisja: 15,527 burra të dënuar në vitin 2015.*
 - o Veprimet:
 - 1) Si pjesë e mbështetjes për reformë të kurrikulave arsimore, të përfshihet adresimi i normave të socializuara gjinore që formojnë bazën për inkurajimin e djemve për të përdorur dhunën dhe për të mbajtur pozita të pushtetit.
 - 2) Të mbështetet institucionalizimi i kurrikulave të përmirësuara brenda sistemit korrektues dhe sprovues që adresojnë normat e socializuara gjinore që kontribuojnë në dhunën mashkullore, në drejtim të parandalimit të recidivizmit.
 - 3) Të mbështetet zbatimi i kuadrit ligjor për entet korrektuese, veçanërisht për të përmirësuar qasjen ndaj shërbimeve të shëndetit mendor dhe programeve të rehabilitimit, për të ulur recidivizmin te burrat.¹³³

Dhuna në bazë gjinore

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 i Komitetit CEDAW përkufizon “dhunën në bazë gjinore” si “dhunë që drejtohet ndaj gruas sepse ajo është grua apo që prek gratë në mënyrë joproporcionale...[duke përfshirë] akte që shkaktojnë dëme ose vuajtje fizike, mendore ose seksuale, kërcënimet me këto akte, shtrëngimet dhe privimet e tjera të lirisë”. Ai specifikon se CEDAW zbatohet për dhunën e kryer nga autoritetet publike dhe sipas të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare dhe pakteve specifike të të drejtave të njeriut. Shtetet janë gjithashtu përgjegjëse për aktet private “nëse nuk veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe ndëshkuar aktet e dhunës, dhe për të siguruar kompensim”.
- Direktiva kundër trafikimit përcakton standardet minimale sa i përket veprave penale dhe sanksioneve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.¹³⁴ Kjo është transpozuar me Ligjin nr. 04/L-218 (më poshtë) dhe Kodin Penal.¹³⁵
- Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje¹³⁶ dhe udhëzimet përkatëse administrative¹³⁷ mbulojnë procedurën civile për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje. Këto përvijojnë procesin e lëshimit të urdhrave për mbrojtje dhe masave mbrojtëse të zbatueshme për viktimat, duke përfshirë mbështetjen dhe rehabilitimin e tyre, si dhe masat për rehabilitimin e kryesve. Ligji përkufizon aktet e dhunës në familje si vepra apo lëshime të qëllimshme që i bënë një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare.¹³⁸ Ligji gjithashtu ofron përkufizim unik për “marrëdhënie familjare” në bazë të formave ndër-familjare të banimit në Kosovë, duke përfshirë: janë ose ishin të fejuar; janë ose ishin të martuar; janë ose ishin në bashkësi jashtëmartesore; janë ose ishin në marrëdhënie jashtëmartesore; bashkëjetesa në një ekonomi të përbashkët familjare, etj.
- Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalojnë diskriminimin në bazë gjinore, përfshirë ngacmimin dhe ngacmimin seksual.¹³⁹
- Ligji për kompensimin e viktimave të krimit parasheh kompensimin për krimet e vrasjes, trafikimit me njerëz, dhunimit, keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe veprat penale që bien brenda përkufizimit të dhunës në familje sipas Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.¹⁴⁰
- Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit¹⁴¹ parasheh detyrat e autoriteteve kompetente në “parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz” si dhe “mbrojtjen e viktimave të trafikimit” dhe të drejtave të tyre. Ligji jep përkufizimin e trafikimit me njerëz si çdo “rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave, duke përfshirë këmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo

keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit”. Trafikimi me njerëz paraqet vepër penale sipas Kodit Penal.¹⁴²

- Ligji për të huajt¹⁴³ (dhe Udhëzimi Administrativ nr. 01/2014 për procedurën e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt dhe vërtetimit për lajmërimin e punës) transponon Direktivën 2004/81/KEE për lejen e qëndrimit që i lëshohet shtetasve të vendeve të treta që janë viktimë të trafikimit me njerëz ose që kanë qenë subjekt i veprimit për të lehtësuar migracionin e paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente.
- Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2015-2019 ka për synim forcimin e përpjekjeve institucionale për parandalimin dhe luftimin e trafikimit.¹⁴⁴ Objektivat e saj strategjike përfshijnë: avancimi i parandalimit përmes informimit, vetëdijesimit dhe edukimit; fuqizimi i sistemit të identifikimit, mbrojtjes, ndihmës dhe riintegrit të viktimave të trafikimit; ndjekje penale efektive të rasteve të trafikimit dhe fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe vendor.
- Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe plani i veprimit 2016-2020 (SKMDHF)¹⁴⁵ ka për synim trajtimin me përparësi të të gjitha rasteve të dhunës në familje; të sigurohet rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës në familje; garanton drejtësi dhe llogaridhënie për individët e dëmtuar; të ofrohet qasje në shërbime cilësore të integruara; dhe ngritje të vetëdijes për t'i dhënë fund dhunës në familje. Ndonëse nuk është palë në Konventën e Stambollit,¹⁴⁶ Kosova e ka pranuar atë brenda këtij Programi.¹⁴⁷
- Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë¹⁴⁸ përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të çdo institucioni të përfshirë në ndihmë viktimave, sipas Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, duke përfshirë: mbrojtësit e viktimave, Qendrat për Punë Sociale, policinë, prokurorinë, gjykatat, ANJF-në (dhe Zyrat Rajonale të Ndihmës Juridike), Avokatin e Popullit, strehimoret, ofruesit e kujdesit shëndetësor, institucionet arsimore, dhe OSHC-të.
- Procedurat Standarde të Veprimit për personat e trafikuar në Kosovë¹⁴⁹ japin udhëzime për hisedarët dhe profesionistët në fushën e kundër-trafikimit. Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet të veprojnë në mënyrë jodiskriminuese sa i përket gjinisë.

Gjetjet

Dhuna në familje

Dhuna në familje mbetet e përhapur gjerësisht me 62% të kosovarëve (56% e burrave dhe 68% e grave) që kanë përjetuar njëfarë forme të dhunës në familje gjatë jetës së tyre; 41% e grave dhe 20% e burrave kanë raportuar se kanë pësuar dhunë në familje në vitin 2014.¹⁵⁰ Në vitin 2017, policia regjistroi 1,125 raste të dhunës në familje; 76% e viktimave ishin gra.¹⁵¹ Numri i rasteve të raportuara në polici ose në anketa është gjithnjë më i ulët se shtrirja aktuale e dhunës. Arsytet për mos raportim përfshijnë frikën e stigmës, turpin, fajësimin e viktimës, varësinë ekonomike, mungesën e besimit institucional dhe frikën e dhunës së vazhdueshme, hakmarrjes ose humbjes së kujdestarisë së fëmijëve.¹⁵²

Shkaqet më të perceptuara të dhunës në familje janë papunësia dhe situata e rëndë ekonomike brenda familjes.¹⁵³ Të dhënat nga anketimi sugjerojnë se nuk ekziston asnjë lidhje e rëndësishme mes papunësisë dhe dhunës në familje. Megjithatë, faktorët ekonomikë kontribuojnë në pamundësinë e grave për të raportuar ose për t'u larguar nga mjediset e dhunshme shtëpiake.¹⁵⁴ Burrat e perceptojnë alkoolin si shkak madhor të dhunës në familje, si dhe mungesën e arsimit, martesat pa dëshirë dhe traumat nga lufta. Gratë kanë tendencë që t'i perceptojnë si shkak të dhunës mosmarrëveshjet që bëhen tepër të ashpra.¹⁵⁵ Jetesa në zona urbane ose rurale, ose niveli i shkollimit nuk kanë raport të rëndësishëm statistikor me dhunën në familje.¹⁵⁶ Marrëdhëniet e çekuilibruara të pushtetit midis burrave dhe grave kontribuojnë në dhunë.¹⁵⁷

Trajnimi për policinë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje është institucionalizuar, ndonëse thuhet se jo të gjithë hetuesit e dhunës në familje kanë marrë të njëjtin nivel të trajnimit.¹⁵⁸ Ekzistojnë njësitë e hetimit të dhunës në familje, por hetuesit punojnë edhe në raste të tjera. Në lidhje me çështjet penale, kohët e fundit janë caktuar prokurorët dhe gjyqtarët për t'u specializuar në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Megjithatë, ata nuk kanë ndjekur trajnim të mjaftueshëm drejt specializimit, veçanërisht

në drejtim të kuptimit të marrëdhënieve të pushtetit, duke shmangur fajësimin e viktimave dhe duke përdorur qasjen që përqendrohet te viktimat.¹⁵⁹ Prokurorët nuk kanë shkathtësi të mjaftueshme në mbledhjen e provave, duke përfshirë edhe shmangien e ndërtimit të rastit bazuar vetëm në deklaratën e viktimës. Gjithashtu, duke pasur parasysh se viktimat dhe kryesit shpesh “pajtohen”, dhe akuzat tërhiqen, prokurorët ende me sa duket nuk kanë njohuri të mjaftueshme për nevojën e ndjekjes së krimeve *sipas detyrës zyrtare*.¹⁶⁰ Prokurorët dhe gjyqtarët gjithashtu kanë luajtur rolin e “ndërmjetësit” ndërmjet viktimës dhe kryesit, ndonëse kjo nuk është përgjegjësi e tyre.¹⁶¹ Nëpërmjet një udhëzimi të detyrueshëm të lëshuar nga Kryeprokurori në qershor 2016, kjo tani është rreptësisht e ndaluar. Disa salla të gjykimit kanë mungesë të infrastrukturës për të rritur sigurinë dhe qasjen fizike për viktimat.¹⁶²

Në procedurat gjyqësore civile, gjyqtarët ende përballen me disa sfida në shqiptimin e masave të caktuara brenda urdhrave për mbrojtje, kryesisht për shkak të ekonomive familjare në formë të bashkësive familjare dhe varfërisë së programeve të rehabilitimit për kryesit.¹⁶³ Në Kosovë nuk ka programe të rehabilitimit për trajtimin e varësisë nga alkooli dhe droga, andaj është e pamundur që gjyqtarët t’i përfshijnë masat e tilla në kuadër të urdhrave për mbrojtje, si masa të mundshme të parapara me Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje.¹⁶⁴

Derisa disa punonjës socialë në Qendrat për Punë Sociale janë të kualifikuar, të tjerëve u mungojnë kompetencat dhe njohuritë, përfshirë ato rreth SKMDHF-së. Për më tepër, disa punonjës socialë vazhdojnë të këshillojnë gjykatat që t’ia japin kujdestarinë e fëmijëve kryesve, duke vlerësuar se baballarët do të ofrojnë më shumë nga aspekti financiar sesa nënat, dhe duke injoruar potencialin për dhunë ndaj fëmijëve.¹⁶⁵ Edukatorët dhe personeli shëndetësor nuk kanë njohuri të mjaftueshme për dhunën në bazë gjinore. Zyrtarët e Shërbimeve Korrektuese dhe Sprovuese nuk kanë ekspertizë në hartimin e planeve të rehabilitimit dhe riintegritit të përshtatura enkas për kryesit e veprave të dhunës. Megjithëse ekziston kurrikulum i dhe disa zyrtarë kanë marrë pjesë në trajnime, zyrtarët e QAP-ve dhe të punësimit edhe më tej nuk janë të informuar në mënyrë të mjaftueshme rreth përdorimit të qasjes që përqendrohet te viktimat gjatë punës me personat që kanë pësuar dhunën me bazë gjinore.¹⁶⁶ Shërbimet e rehabilitimit të viktimave mungojnë, përfshirë shërbimet e shëndetit mendor.

Megjithëse qeveria ka përgjegjësinë për të mbrojtur viktimat e dhunës në bazë gjinore,¹⁶⁷ strehimoret vazhdojnë të përballen me sfida të ndjeshme në sigurimin e fondeve të qëndrueshme. Kjo ka kontribuar në mbylljet periodike, duke i bërë gratë dhe fëmijët pa vendstrehim dhe duke i vendosur ata në risk të madh nga dhuna e përsëritur. Në 2018, qeveria ndryshoi procedurën e aplikimit për strehimoret, duke ulur mbështetjen vetëm në vetëm 50% të shpenzimeve të tyre operacionale.¹⁶⁸ Në fillim të vitit 2018, vetëm gjashtë strehimore ishin funksionale. Derisa strehimoret i shërbejnë të gjitha grupeve etnike, deri më sot nuk ekzistojnë strehimoret brenda komunave me shumicë serbe. Në vitin 2018, dy OGSHC serbe ishin në proces të sigurimit të licencave dhe hapjes së strehimoreve të reja. Hëpërhë nuk ekziston asnjë strehimore për djemtë më të vjetër se 12 vjeç, për burra ose për personat LGBTQI.¹⁶⁹

Ekziston koordinatori kombëtar për dhunën në familje, që njëkohësisht shërben si zëvendësministër i drejtësisë, por ndryshon shpesh pas zgjedhjeve. Kjo ka penguar koordinimin, progresin dhe monitorimin e zbatimit të SKMDHF-së, e cila kishte shënuar zbatim prej vetëm 19% në fund të vitit 2017.¹⁷⁰ Në 12 nga 38 komuna, ekzistojnë mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional.¹⁷¹

Bashkëpunimi ndërinstitucional mbetet i dobët, duke përfshirë menaxhimin e rasteve dhe të dhënave midis institucioneve. Të gjitha institucionet që kanë përgjegjësi për të trajtuar dhunën në familje, siç janë Qendrat për Mirëqenie Sociale, policia, gjykatat, prokuroritë, mbrojtësit e viktimave dhe strehimoret, kanë bazat e veta të të dhënave. Kjo e bën të vështirë për të monitoruar se cili institucion ka dështuar në detyrat e tij për të siguruar qasje në drejtësi.¹⁷²

Ngacmimi seksual dhe dhuna seksuale

“Fajësimi i viktimës” për ngacmimin seksual vazhdon të jetë shumë i përhapur; 74% e kosovarëve mendojnë se mënyra se si gratë veprojnë apo vishen mund të provokojnë ngacmim seksual.¹⁷³ Ngjashëm, një e treta e kosovarëve besojnë se ngacmimi seksual është i pranueshëm dhe u pëlqen grave të reja (41%).¹⁷⁴ Perceptimet e tilla mund të kontribuojnë në ngacmimin seksual. Më shumë se 64% e grave dhe 33% e burrave kanë përjetuar ngacmim seksual gjatë jetës së tyre, dhe 45% e kishin përjetuar në vitin 2014 (64% e grave dhe 24% e burrave).¹⁷⁵

Përfaqësuesit e institucioneve në Kosovë nuk kanë njohuri për ngacmimin seksual dhe cilat veprime përbëjnë ngacmim seksual; kuadrin ligjor të aplikueshëm; dhe procedurat për adresimin e ngacmimit seksual.¹⁷⁶ Policia ka mungesë të njohurive lidhur me ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale.¹⁷⁷ Ndonjëherë ata dështojnë t'i trajtojnë seriozisht rastet e dhunës seksuale ose t'i hetojnë ato siç duhet, gjë që mund të çojë në mos-dokumentim dhe adresim të pamjaftueshëm të këtyre rasteve.¹⁷⁸ Në mënyrë të ngjashme, disa gjyqtarë kanë pak njohuri mbi ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale, duke kontribuar në fajësimin e viktimave dhe jo në ndarjen e drejtësisë.¹⁷⁹

Hëpërhë, mungesa e përkufizimit specifik për ngacmimin seksual në Kodin Penal nënkupton se është e pamundur të përcaktohet se sa raste të ngacmimit janë të natyrës seksuale. Megjithatë, midis 2015 dhe 2017, 416 raste të ngacmimeve u raportuan në polici, dhe 71% e viktimave ishin gra.¹⁸⁰ Gjatë të njëjtës periudhë, policia dokumentoi krime tjera që kishin të bëjnë me dhunë në baza gjinore, duke përfshirë pesë raste të degradimit të integritetit seksual dhe 97 raste të dhunimit.¹⁸¹ Pothuajse të gjitha viktimat ishin gra.¹⁸² Dëshmitë sugjerojnë se kanë ndodhur më shumë raste të dhunës seksuale, por as viktimat nuk i kanë raportuar, as policia nuk i ka regjistruar rastet.¹⁸³ Mbase ajo që i parandalon viktimat nga raportimi i dhunës, është fakti që nëse flasin për dhunën seksuale kjo mund të shkaktojë turpërim publik.

Në vitin 2015, aktivistët thanë se personat LGBTQI u përballën me katër ose pesë raste të ngacmimit seksual.¹⁸⁴ Thuhet që policia në Prishtinë është përmirësuar sa i përket hetimit dhe parandalimit të dhunës në bazë gjinore dhe diskriminimit ndaj personave LGBTQI.

Instituti i Mjekësisë Ligjore punëson vetëm një mjek specialist mjeko-ligjor që është grua. Instituti nuk ofron mbështetje psikologjike para, gjatë dhe pas ekzaminimit. Janë raportuar qasje të dobëta nga punonjësit e institutit në ekzaminimin e grave që kanë pësuar dhunë seksuale, të tilla si mungesa e dhembshurisë dhe të kuptuarit e traumës.¹⁸⁵ Qytetarëve në përgjithësi u mungon vetëdija për rëndësinë e raportimit të menjëhershëm të krimeve të dhunës seksuale, për të lehtësuar në këtë mënyrë mbledhjen e provave mjeko-ligjore. Grave edhe më tej i mungon mbështetja dhe pranimi shoqëror që do t'ia mundësonte atyre të bëjnë raporte të tilla.¹⁸⁶

Trafikimi me njerëz

Trafikimi me njerëz vazhdon të jetë i pranishëm në Kosovë. Në vitin 2017, policia regjistroi 18 raste të trafikimit me njerëz, të gjitha gra, duke përfshirë 10 vajza.¹⁸⁷ Tendencia është që më shumë burra sesa gra të arrestohen për trafikim për shfrytëzim seksual. Në vitin 2017, nga 38 të arrestuarit, 34 ishin burra dhe 4 ishin gra.¹⁸⁸ Mund të ekzistojnë raste tjera që nuk janë identifikuar.

Ekziston një institucion i përkohshëm i sigurisë i drejtuar nga qeveria për strehimin e rasteve me risk të lartë gjatë procedurave gjyqësore. Një strehimore është e specializuar për të ndihmuar gratë e trafikuar, ndërsa një tjetër fokusohet te fëmijët. Strehimoret tjera po ashtu ndonjëherë ofrojnë shërbime të nevojshme. Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë është themeluar në vitin 2013. Ai përfshin disa organizata qeveritare dhe joqeveritare.¹⁸⁹ Autoriteti Kombëtar udhëhiqet nga zyra e koordinatorit kombëtar.¹⁹⁰

Ekzistojnë disa probleme për garantimin e mbrojtjes dhe qasjes në drejtësi për personat që kanë pësuar nga trafikimi me njerëz, duke përfshirë bashkë-përfshirjen e disa zyrtarëve, nivelin e dobët të ndjekjes penale, dënimet e lehta për kryesit, shkurtimet e fondeve për strehimoret, zgjidhjet e pamjaftueshme afatgjata për riintegrimin dhe fuqizimin e viktimave, dhe zbatimin e dobët të legjislacionit ekzistues.¹⁹¹

Kompensimi i viktimave

Që nga viti 2015, Ligji për kompensimin e viktimave të krimit parasheh të drejtat e viktimave të krimeve të dhunshme, si dhe të vartësve të tyre, për kompensim financiar nga shteti.¹⁹² Parashtruesit e kualifikuar përfshijnë vartësit e viktimave të vrasjes, të mbijetuarit e përdhunimit, personat e trafikuar, viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët që janë keqpërdorur seksualisht.¹⁹³ Zbatimi filloi rishtas, në vitin 2017. Megjithatë, janë identifikuar disa sfida. Ministria e Drejtësisë dhe Komisioni për Kompensimin e Viktimave kanë ndërmarrë fushata minimale të shtrirjes së informimit te qytetarët për kompensimin, gjë që mund të kontribuojë në nënshfrytëzim.¹⁹⁴ Tutje, pak gjyqtarë dhe prokurorë janë trajnuar për kompensimin e viktimave.¹⁹⁵ Ky dhe referimi i vjetruar për kompensimin e viktimave në Kodin e

Procedurës Penale¹⁹⁶ mund të çojë deri te keqinformimi i parashtruesve potencialë të kërkesave për kompensim nga gjyqtarët dhe prokurorët.

Martetat e hershme

Sipas Ligjit për familjen, vetëm personat e moshës madhore më të vjetër se 18 vjeç mund të martohen.¹⁹⁷ Përfundimisht, “për shkak të arsyeshme dhe sipas kërkesës së tij, gjykata kompetente mund t’i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet, nëse konstaton se personi i tillë ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore.¹⁹⁸ Në vitin 2014, u martuan 95 vajza nën moshën 18 vjeç, 109 në 2015 dhe 63 në 2016.¹⁹⁹ Asnjë djalë i mitur nuk ishte i martuar gjatë kësaj periudhe. Të dhënat statistikore të sakta mbi shkallën e martesave të hershme nuk janë të disponueshme; në Kosovë është e zakonshme që çiftet të martohen sipas frymës kulturore, para miqve dhe familjes, por që presin që të regjistrojnë martesën pas disa vjetësh.²⁰⁰ Kjo mund të jetë veçanërisht e vërtetë në rastet e martesës së hershme, veçanërisht nëse është e paligjshme.

Arsyet për martetat e hershme përfshijnë dashurinë, presionin e familjes, sigurinë, kushtet shoqërore-ekonomike, shtatzëninë e paplanifikuar, presionin e moshatarëve dhe traditën.²⁰¹ Martetat e hershme mund t’i vendosë gratë e reja në risk për ndërprerje të shkollimit për të hir të marrjes së përgjegjësive shtëpiake, duke dëmtuar kështu perspektivat e tyre të ardhshme të punësimit; çështjet shëndetësore që lidhen me shtatzëninë e hershme; dhe dhuna në familje ose abuzimi seksual brenda marrëdhënieve të pabarabarta.²⁰² Martetat e hershme mund të jenë më të zakonshme në mesin e personave që i takojnë grupeve të caktuara etnike, siç janë romët, ashkalitë, egjiptianët dhe goranët.²⁰³

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: Përmirësimi i qasjes në drejtësi për gratë dhe burrat.²⁰⁴
 - o Treguesit:
 - 1) Përqindja e krimeve që pretendohet se janë kryer që janë zgjidhur nga institucionet e drejtësisë në përputhje me kuadrin ligjor, të zbërthyer sipas gjinisë. *Pikënisja: hëpërhë e padisponueshme për shkak të mungesës së të dhënave të zbërthyer sipas gjinisë.*
 - 2) Përqindja e “rasteve të referuara të dhunës në bazë gjinore dhe seksuale ndaj grave dhe fëmijëve që janë hetuar dhe dënuar” (SZHQ 5.39, PVGJ 7.3). *Pikënisja: hëpërhë e padisponueshme për shkak të mungesës së të dhënave të zbërthyer sipas gjinisë.*
 - 3) Numri i “individëve që përfitojnë drejtpërsëdrejti nga programet e reformës së sektorit të drejtësisë, sundimit të ligjit dhe sigurisë të financuara nga BE-ja” (KRBE, PVGJ 7.5). *Pikënisja: relevante sipas projektit.*
 - 4) “Numri i grave që përfitojnë nga programet e ndihmës juridike me mbështetjen e BE-së” (PVGJ 17.5). *Pikënisja: relevante sipas projektit.*
 - o Veprimet:
 - 1) Të inkurajohet dhe të mbështetet fuqishëm policia, prokuroria dhe gjyqësori në krijimin dhe operacionalizimin e sistemit të sigurt të menaxhimit të të dhënave ndër-institucionale dhe sistemit për menaxhim të rasteve, duke përfshirë të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë.²⁰⁵ Të sigurohet mbrojtja e identitetit të viktimave dhe informacionit personal.
 - 2) Të mbështeten reformat e vazhdueshme në sistemin e drejtësisë drejt përmirësimit të efektivitetit të proceseve, duke përfshirë adresimin e drejtë dhe me kohë të të gjitha rasteve.
 - 3) Të mbështetet zhvillimi dhe institucionalizimi i trajnimit të detyrueshëm dhe kurseve rifreskuese për prokurorët dhe gjyqtarët për krimet në bazë gjinore, veçanërisht marrëdhëniet e pushtetit, dhunën mashkullore, dhunën seksuale, ngacmimin seksual dhe fajësimin e viktimave, veçanërisht pas ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal lidhur me dhunën në bazë gjinore.²⁰⁶
 - 4) Të mbështeten përmirësimet e infrastrukturës së gjykatave për të rritur sigurinë dhe qasjen fizike për viktimat.

- 5) Të inkurajohet fuqishëm qeveria dhe të mbështetet planifikimi financiar për disponueshmëri të zgjeruar të ndihmës juridike, veçanërisht për grupet e ndjeshme.
 - 6) Të mbështetet institucionalizimi i bashkëpunimit të përmirësuar ndërinstitucional në ofrimin e ndihmës me kohë rreth rasteve, duke përfshirë mbledhjen e dëshmive të provave mjekoligjore (p.sh., nëpërmjet ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale dhe trajnimit të institucionalizuar).
- **Objektivi:** “Vajzat dhe gratë të lira nga të gjitha format e dhunës ndaj tyre (DHNGV) si në sferën publike ashtu edhe në atë private” (PVGJ 7).
 - o **Treguesit:**
 - 1) Përqindja e njerëzve që pësuan dhunë në familje gjatë vitit të kaluar, të zbërthyer sipas gjinisë. *Pikënisja: 31% (41% e grave, 20% e burrave) në vitin 2014.*²⁰⁷
 - 2) Përqindja e njerëzve që pësuan ngacmim seksual gjatë vitit të kaluar, të zbërthyer sipas gjinisë. *Pikënisja: 45% (64% e grave, 24% e burrave) në vitin 2014.*
 - 3) Përqindja e “grave të moshës 20-24 vjeç që ishin të martuara ose në bashkësi në moshën 15 vjeç” (PVGJ 7.1). *Pikënisja: Hëpërhë e padisponueshme. Ndryshorja kontrolluese: # i martesave të hershme të regjistruara ligjërisht për vit. Pikënisja: 105 në 2015.*
 - o **Veprimet:**
 - 1) Si pjesë e reformës së kurrikulave, të përfshihet trajtimi i normave të socializuara gjinore që kontribuojnë në dhunën në bazë gjinore.²⁰⁸
 - 2) Të mbështetet krijimi i programeve të rehabilitimit për kryesit e dhunës, duke përfshirë trajtimin për droga dhe alkool.
 - 3) Të mbështetet institucionalizimi i kurrikulave të përmirësuar për shërbimin korrektues dhe sprovues, duke përfshirë trajnimin e detyrueshëm standard për zyrtarët, për të zhbërë normat e socializuara gjinore që kontribuojnë në dhunën në bazë gjinore, duke parandaluar recidivizmin.²⁰⁹
 - 4) Të përkrahet institucionalizimi dhe përmirësimi i disponueshmërisë së këshillimit psikologjik cilësor dhe të përballeshëm, që inkorporon qasje që merr parasysh pikëpamjen gjinore dhe respekton konfidencialitetin.
 - 5) Të përkrahen fushatat për shtrirje të informimit publik për të përgënjeshtuar stigmat që lidhen me marrjen e këshillimit psikologjik.
 - **Objektivi:** Përmirësimi i shërbimeve për personat që kanë pësuar dhunë në bazë gjinore.²¹⁰
 - o **Treguesit:**
 - 1) Qasja e përmirësuar e institucioneve që ndihmojnë personat që kanë pësuar dhunë në baza gjinore, siç tregohet nga raportet e monitorimit. *Pikënisja: shërbime me cilësi të ulët.*²¹¹
 - 2) Strehimoret kanë financim të përhershëm dhe të qëndrueshëm që mbulon kostot e shërbimeve cilësore për personat që kanë pësuar dhunën në familje dhe trafikimin. *Pikënisja: fondet vjetore që ndërpriten rregullisht dhe nuk mbulojnë të gjitha shpenzimet.*
 - o **Veprimet:**
 - 1) Të mbështetet institucionalizimi i trajnimit për të përmirësuar njohuritë dhe qasjen e punonjësve socialë, praktikuesve të kujdesit shëndetësor, edukatorëve, zyrtarëve të punësimit dhe QAP-ve për të ndihmuar personat që kanë pësuar dhunë në bazë gjinore.²¹²
 - 2) Të inkurajohen dhe të mbështeten fuqishëm institucionet për buxhetimin dhe shpërndarjen adekuate të resurseve për financimin e strehimoreve në mënyrë të qëndrueshme, pa ndërprerje.²¹³

Dhuna seksuale e lidhur me konfliktin

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre²¹⁴ përcakton statusin dhe të drejtat e viktimave të dhunës

seksuale të kryer gjatë luftës. Viktimat gëzojnë të drejtën për pension personal invalidor, lirim nga tatimi në pronë, përkujdesje për banim, shërbime shëndetësore jashtë vendit (nëse problemi shëndetësor është pasojë e luftës dhe Kosova nuk mund të ofrojë shërbime të tilla) dhe prioritet në punësim në sektorin publik dhe privat.

- Ligji për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit të specializuar²¹⁵ parasheh masa të veçanta të procedurës dhe provave për viktimat e dhunës seksuale dhe gjinore, të detajuara më tej në Rregulloren e procedurës dhe të provave.²¹⁶ Masat e posaçme për t'ua lehtësuar dhënien e dëshmisë dëshmitarëve të traumatizuar ose të cenueshëm, duke përfshirë viktimat e dhunës seksuale dhe dhunës mbi bazë gjinore, janë: mundësimi i pranisë së një psikologu, këshillëdhënësi, apo anëtar i afërt të familjes gjatë dhënies së dëshmisë prej dëshmitarit, transmetimi i brendshëm me një kamerë të sigurisë, të akuzuarit i pamundësohet të shohë dëshmitarin drejtpërdrejt, dhe dorëzimi paraprak i pyetjeve të cilat përcillen nëpërmjet trupit gjykues.²¹⁷
- Rregullorja për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës²¹⁸ dhe Rregullorja që e ndryshon²¹⁹ vendosin kushtet dhe kriteret për verifikimin e statusit të viktimave të tilla. Rregulloret gjithashtu organizojnë funksionimin dhe përgjegjësitë e Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës.
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për familjet e dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, për veteranët e UÇK-së, invalidët civilë të luftës, viktimat e dhunës seksuale të luftës, viktimat civile të luftës dhe familjarëve të tyre²²⁰ rregullon të drejtën për banim. Plani i veprimit: Qasja në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës²²¹ përmban veprime për të mbështetur viktimat e dhunës seksuale të kryer gjatë luftës, megjithëse korniza kohore përkatëse është e paqartë.
- Edicioni mëparshëm i Planit të veprimit në zbatim të Rezolutës 1325, "Gratë, Paqja dhe Siguria" 2013-2015²²² përfshinte qasjen në mekanizmat për mbrojtje, qasjen në drejtësi, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Ky plan skadoi në vitin 2015.

Gjetjet

Ndërsa numri i saktë mund të mos dihet kurrë, burime të ndryshme kanë vlerësuar se përafërsisht 20,000 gra kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë.²²³ Dhuna seksuale është kryer edhe ndaj burrave, megjithëse është diskutuar fare pak publikisht.²²⁴ Sipas të dhënave nga 2016, 767 të mbijetuar kanë kërkuar shërbime psiko-sociale nga OGSHC-të.²²⁵ Të mbijetuarit janë përballur me diskriminimin dhe stigmatizimin, gjë që ka kontribuar në raportimin e ulët. Ekzistojnë disa sfida me hetimet penale dhe pak raste kanë arritur në gjykata; të pandehurit janë dënuar vetëm në tri raste.²²⁶

Deri në vitin 2018, shërbimet e vetme në dispozicion për të mbijetuarit janë ofruar nga OGSHC-të. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, MPMS-ja ka themeluar Komisionin për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale në bashkëpunim të ngushtë me OGSHC-të. Komisioni do të pranojë kërkesa nga të mbijetuarit për shërbime shtetërore, do t'i intervistojë dhe do të ofrojë pensione, ndër përfitime të tjera.²²⁷ Sekretaria e MPMS-së që koordinon punën e Komisionit u bë funksionale në 2018. Ligji tani ia pamundëson disa prej viktimave të kenë qasje në përfitime, veçanërisht nëpërmjet kriterëve përjashtuese të kualifikimit dhe afateve të shkurtra për aplikim.²²⁸

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: Përmirësimi i qasjes në drejtësi për personat që kanë pësuar dhunë seksuale lidhur me konfliktin.
 - o Treguesi: Numri i personave të dënuar. *Pikënisja: 5 sipas të dhënave nga viti 2017.*²²⁹
 - o Veprimet:
 - 1) Të mbështetet mbledhja e mjaftueshme e provave, mbrojtja e dëshmitarëve dhe procesi i rregullt gjyqësor, për të siguruar që rastet e dhunës seksuale të lidhura me konfliktin hetohen dhe ndiqen penalisht menjëherë, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe efektive.²³⁰

- 2) Të mbështetet reforma e ligjit për kompensim, duke zgjeruar fushëveprimin për të përfshirë dhunën seksuale në periudhën fill pas konfliktit.
- 3) Për të mbijetuarit duhet të vihen në dispozicion shërbime efektive të kujdesit shëndetësor dhe mbështetjes psikologjike, pa diskriminim.
- 4) Lidhur me drejtësinë tranzicionale, të bëhet presion politik që qeveria e Serbisë të pranojë dhe të kërkojë falje publike për dhunën seksuale që policia, ushtria dhe trupat paraushtarake kryen ndaj grave dhe burrave në Kosovë.²³¹

Të drejtat LGBTQI

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian²³² siguron që Bashkimi Evropian do të luftojë diskriminimin për shkak të gjinisë dhe orientimit seksual gjatë përcaktimit dhe zbatimit të politikave dhe aktiviteteve të tij.
- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ndalon diskriminimin në çdo bazë, të tillë si gjinia, tiparet gjenetike ose orientimi seksual.
- Direktiva e rimodeluar vë në dukje se Gjykata e Drejtësisë ka marrë qëndrim se ndalimi i diskriminimit zbatohet për diskriminimin që rrjedh nga ricaktimi gjinor i personit.²³³ Kjo dhe Traktati dhe Karta e lartpërmendur janë transpozuar në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe në LBGJ.
- Direktiva për Trajtim të Barabartë përcakton kuadrin për luftimin e diskriminimit në bazë të orientimit seksual në punësim dhe profesion.²³⁴
- Sipas Kodit Penal, për krimet e motivuara nga orientimi seksual i personit parashihet shqiptimi i dënimeve më të ashpra.²³⁵
- Kushtetuta ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë, orientimit seksual ose ndonjë statusi tjetër personal.²³⁶
- Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi krijon një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, statusit personal, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër.²³⁷ Kjo vlen për të gjitha institucionet shtetërore dhe lokale, personat fizikë dhe juridikë, dhe në sektorin publik dhe privat, në të gjitha fushat e jetës, si: punësimi, aftësimi profesional, kushtet e punës, arsimi, banimi, mbrojtja sociale, qasja në dhe furnizimi me mallra, qasja në drejtësi, sigurimet, pjesëmarrja në jetën publike, pjesëmarrja në shkencë, sport, art, shërbime dhe aktivitete kulturore.
- Ligji për barazi gjinore zbatohet për burrat, gratë dhe personat të cilët kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor apo të përcaktimit të seksit. Ai garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në të gjitha sferat e jetës.²³⁸
- Ligji për Avokatin e Popullit i jep Avokatit të Popullit kompetencën për të hetuar ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut. Puna e institucionit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Gjetjet

Kodi Penal nuk përcakton në mënyrë specifike se cilat akte përbëjnë “krime të urrejtjes”, gjë që ka paraqitur sfida për personat LGBTQI që kërkojnë drejtësi.²³⁹ Ligji për familjen përcakton martesën si bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme,²⁴⁰ në kundërshtim me parimet e barazisë në Kushtetutë. Kushtetuta dhe Ligji për familjen as nuk e lejojnë dhe as nuk e ndalojnë adoptimin nga çiftet e seksit të njëjtë. Ndërsa Ligji për gjendjen civile nuk e ndalon ndryshimin e gjinisë/seksit në dokumentet zyrtare, procedurat për ta bërë këtë nuk ekzistojnë.²⁴¹ Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione nuk e ka monitoruar zbatimin e kuadrit ligjor përkatës. Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues Ndërmënyës për të Drejtat LGBTI në Kosovë krijoi një Plan Veprimi për periudhën nëntor 2016 deri në nëntor 2018, por nuk është ndarë asnjë buxhet. Në Kosovë nuk ofrohet intervenimi kirurgjik për ricaktim gjinor.

Lokacionet më të afërta janë në Beograd dhe Shkup.²⁴² Gjithashtu, terapia e zëvendësimit të hormoneve mund të merret në Shkup.²⁴³ Informata të kufizuara janë të disponueshme për personat interseks.

Homofobia mbetet e përhapur gjerësisht në Kosovë. Sipas një studimi të vitit 2018, 67% e burrave dhe 55% e grave në Kosovë besojnë se homoseksualiteti nuk është as “normal” as “natyral”.²⁴⁴ Për më tepër, 60% e burrave besojnë se martesat homoseksuale duhet të jenë të paligjshme në Kosovë, ashtu si edhe 46% e grave.²⁴⁵ Përveç kësaj, 74% e burrave dhe 41% e grave kanë deklaruar se personave LGBTI nuk duhet t’u lejohet të punojnë me fëmijë.²⁴⁶

Qëndrimet homofobike burojnë nga rolet dhe përgjegjësitë tradicionale gjinore, sipas të cilave nga gratë dhe burrat pritët të kenë role shumë të veçanta riprodhuese dhe prodhuese brenda familjes dhe shoqërisë; nëse individët nuk përshtaten brenda këtyre roleve, ata ballafaqohen me mospranim shoqëror. Homofobia gjithashtu është lidhur me faktorë të tillë si vetëdijesimi i pamjaftueshëm, besimet fetare që e konsiderojnë atë “mëkat”, ndjenjat anti-perëndimore dhe mbulimi minimal pozitiv në media i personave LGBTQI.²⁴⁷

Homofobia dhe vetëdijesimi i pamjaftueshëm në përgjithësi kontribuojnë në mungesën e qasjes në shërbime publike, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, arsimin (ku personat LGBTQI përballen me bullizëm) dhe punësimin cilësor.²⁴⁸ Shumë persona LGBTQI nuk ndihen të sigurt në Kosovë.²⁴⁹ Tendenca është që kryesit e abuzimit, dhunës dhe ngacmimit ndaj personave LGBTQI të jenë miqtë e tyre.²⁵⁰ Ndjeshmëria e rritur brenda mjediseve publike dhe private mund të rezultojë me tërheqje nga ndërveprimi, duke kufizuar kështu mundësitë për personat LGBTQI dhe duke përforcuar ndjenjat e izolimit.²⁵¹

Në Kosovë, familja është formë e rëndësishme e mbrojtjes shoqërore, si dhe rrjet i sigurisë ekonomike në mungesë të shërbimeve të mjaftueshme shtetërore. Shumë njerëz jetojnë me prindërit e tyre derisa të martohen dhe varen financiarisht nga familjet e tyre. Zbulimi i statusit LGBTQI në familjen e dikujt mund të nënkuptojë që personi mund të humbasë mbështetjen ekonomike, të dëbohet nga shtëpia dhe të përballë me abuzime psikologjike dhe/ose fizike.²⁵² Disa persona LGBTQI kanë frikë nga familjet e tyre.²⁵³ Strehimorja më e afërt për personat LGBTQI është në Shqipëri.

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: Përmirësimi i pranimit dhe trajtimit shoqëror të personave LGBTQI.
 - o Treguesit:
 - 1) Numri i ligjeve dhe politikave të ndryshuara dhe të adoptuara, në konsultim të ngushtë me personat LGBTQI që sigurojnë trajtim të barabartë të personave LGBTQI. *Pikënisja: 0 për një program të ri.*
 - 2) Përqindja e njerëzve që janë homofobikë. *Pikënisja: 67% e burrave dhe 55% e grave.*
 - o Veprimet:
 - 1) Të mbështeten ndryshimet në kuadrin ligjor në përputhje me *acquis*-të e BE-së, duke përfshirë: 1) përkufizime eksplicite të veprave që përbëjnë “krime të urrejtjes” në Kodin Penal; 2) dispozitë të qartë për të drejtën për martesë për personat e seksit të njëjtë dhe adoptimin nga çiftet e seksit të njëjtë në Ligjin për familjen, si pjesë e rishikimeve të Kodit Civil; dhe 3) krijimin e procedurave të qarta për ndërrimin e gjinisë/seksit në dokumentet zyrtare.
 - 2) Si pjesë e reformave të vazhdueshme të kurrikulave, të sigurohet adresimi i normave të socializuara gjinore që kontribuojnë në diskriminimin ndaj personave LGBTQI, si dhe edukimi mbi të drejtat e njeriut më gjerësisht.
 - 3) Të institucionalizohet trajnimi i mësimdhënësve, nëpunësve civilë, prokurorëve, gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë, me informacione rreth personave LGBTQI, përfshirë seksualitetin, identitetin dhe të drejtat gjinore.
 - 4) Të mbështetet Komisioni Parlamentar për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione për të përmirësuar monitorimin e ligjeve dhe politikave që lidhen me të drejtat e personave LGBTQI.
 - 5) Të inkurajohet dhe të punohet me partitë politike për të përfshirë të drejtat e personave LGBTQI në agjendat e tyre politike.

- 6) Të mbështeten përpjekjet për të ofruar ndihmë juridike falas për personat LGBTQI nëpërmjet përmirësimit të kompetencave të zyrtarëve për ndihmë juridike dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të OSHC-ve që mbështesin personat LGBTQI.

Të drejtat fetare

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbron të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë.²⁵⁴ Protokollin nr. I i Konventës ka të bëjë me të drejtën e prindërve për të siguruar edukim dhe arsim për fëmijët e tyre në përputhje me bindjet e tyre fetare.²⁵⁵ Protokollet e Konventës janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë falë Kushtetutës.²⁵⁶
- Karta e të Drejtave Themelore të BE-së mbron të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë.²⁵⁷
- Kushtetuta deklaron se Kosova është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.²⁵⁸ Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar me Kushtetutë.²⁵⁹ Sipas Kushtetutës, një nga arsyet kur liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj është në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes apo provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes fetare.²⁶⁰
- Ligji për lirinë fetare në Kosovë detajon të drejtat dhe mbrojtjen që rrjedh nga garancia kushtetuese e lirisë fetare.²⁶¹ E drejta për lirinë fetare përfshin lirinë e adhurimit ose tubimit, lirinë për të themeluar institucione bamirëse, lirinë për të shpërndarë publikime dhe lirinë e respektimit të ditëve të pushimit, ndër të tjera. Ligji nuk përmban pikëpamje gjinore.
- Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi përfshin fenë si një nga bazat e mbrojtura, ashtu siç e bën edhe Kushtetuta.²⁶² Fushëveprimi i Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi është i gjerë, duke mbuluar aspekte të ndryshme të punësimit, por edhe banimin, mallrat dhe shërbimet, pjesëmarrjen në aktivitete sportive dhe kulturore dhe trajtimin e barabartë në procedura gjyqësore, ndër të tjera.²⁶³
- Udhëzimi Administrativ “Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta”²⁶⁴ ndalon veshjet fetare duke përfshirë shaminë. Ndalimi zbatohet në shkollat fillore dhe të mesme, por jo në universitete apo në vende të punës.

Gjetjet

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë, 96% e qytetarëve identifikohen si myslimanë, më pak se 4% si të krishterë, 2% si katolikë, 1% si ortodoksë dhe më pak se 1% si “të tjerë”; 0.1% nuk identifikohen si fetarë.²⁶⁵ Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se përqindjet e grave dhe burrave që identifikohen me secilën fe janë të baraspeshuara. Megjithatë, pak më shumë burra (54%) sesa gra (48%) deklaruan se nuk identifikohen si fetarë. Vetëm rreth 24% e njerëzve marrin pjesë në shërbesa fetare të paktën një herë në muaj.²⁶⁶ Burrat tregojnë tendencë të pjesëmarrjes në shërbesa fetare më shpesh sesa gratë, me 34% të burrave dhe vetëm 8.6% të grave që marrin pjesë së paku një herë në javë në shërbesa fetare.²⁶⁷

Gratë myslimane, veçanërisht ato që mbajnë shami, thuhet se përballen me diskriminim, stigmë shoqërore dhe diskriminim institucional.²⁶⁸ Në vitin 2009, MASHT-i shpalli ndalimin e veshjeve fetare, duke përfshirë hixhabin, për nxënësit e shkollave të mesme duke thënë në arsyetimin e ndalimit se Kosova është shtet laik; Avokati i Popullit rekomandoi që kufizimi të vlente vetëm për mësimdhënësit dhe administratorët.²⁶⁹ Gjykata Kushtetuese ka mbështetur ndalimin,²⁷⁰ dhe kështu kufizimi mbetet në vend.

Lidhur me ekstremizmin fetar, në disa raste pikëpamjet ekstremiste kanë kontribuar në ngacmime dhe madje edhe në dhunë ndaj personave LGBTQI dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut.²⁷¹ Numri i shtetasve kosovarë që janë përfshirë në konflikte në Siri dhe Irak ka rënë.²⁷² Sidoqoftë, radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm vazhdojnë të paraqesin sfidë, për shkak të fondeve nga organizatat e huaja që predikojnë ideologji ekstremiste dhe propagandës nëpërmjet mediave sociale.²⁷³ Midis vitit 2012 dhe 2016, 255 burra, 49 gra dhe 55 fëmijë u larguan nga Kosova për t'u bashkuar me konflikte të dhunshme

në zona të ndryshme konflikti të Lindjes së Mesme, kryesisht si luftëtarë të huaj terroristë.²⁷⁴ Gjithsej, janë kthyer 133 kosovarë dhe 74 kanë vdekur; 59 burra dhe 41 gra mbeten në zonat e konfliktit.²⁷⁵ Shumica e grave që shkuan në zonat e konfliktit shoqëruan bashkëshortët e tyre, qoftë vullnetarisht ose me detyrim.²⁷⁶ Thuhet se tendenca ishte që gratë t'i përmbahen roleve tradicionale gjinore, të merren me veprimtari kujdesi; ato nuk morën pjesë në mënyrë aktive në luftime.²⁷⁷

Disa elemente të roleve tradicionale gjinore kontribuojnë në ndjeshmërinë e grave dhe burrave ndaj radikalizimit apo ekstremizmit të dhunshëm.²⁷⁸ Për shembull, pamundësia e burrave për të mbajtur familjen për shkak të rrethanave të vështira shoqërore dhe ekonomike, mund t'i bëjë disa burra më të ndjeshëm ndaj idesë për t'u bashkuar me konfliktet e armatosura të jashtme dhe për të përqaftuar ideologjitë radikale.²⁷⁹ Gratë mund të përqaftojnë ideologji të tilla për shkak të normave të përforcuara gjinore që i bëjnë presion grave për t'iu bindur partnerëve të tyre.²⁸⁰ Rehabilitimi, de-radikalizimi dhe riintegrimi i të kthyerve mbetet sfida, veçanërisht për fëmijët dhe gratë.²⁸¹

Veprimet potenciale

- Të mbështeten kërkimet e mëtejshme mbi dimensionet gjinore të rekrutimit dhe riintegrimin të personave të përfshirë në ekstremizëm të dhunshëm; dhe mbi diskriminimin ndaj grave dhe burrave për shkak të fesë.
- Bazuar në gjetjet e kërkimeve, të mbështeten programe për trajtimin e diskriminimit dhe/ose shkaqeve rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm dhe natyrës së tyre gjinore.

Kthimi dhe riadhesimi

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- Kushtetuta siguron kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit.²⁸²
- Ligji për azil²⁸³ rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtjes së përkohshme. Përkufizimi i “refugjatit” lidhet me frikën nga persekutimi për arsye të përkatësisë grupit të caktuar shoqëror, që përfshin marrjen parasysh të aspekteve që lidhen me gjininë, duke përfshirë identitetin gjinor.²⁸⁴ “Aktet e persekutimit” përfshijnë aktet të cilat për nga natyra në veçanti lidhen me gjininë.²⁸⁵ Gratë shtatzëna, prindërit e vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, personat të cilët i janë nënshtruar përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale, siç janë viktimat e gjymtimeve të organeve gjenitale femërore, konsiderohen “persona të cenueshëm” sipas Ligjit.²⁸⁶ Në raste specifike, aplikuesve mund t'u sigurohet përkthyesi i gjinisë së njëjtë.²⁸⁷ Intervistat ose kontrollet gjithashtu mund të kryhen nga personat e gjinisë së njëjtë.²⁸⁸ Aplikueset e gjinisë femërore kanë të drejtë të kërkojnë që procedurën e azilit për ato ta zhvillojë zyrtarja e gjinisë së njëjtë.²⁸⁹ Përmes procedurave të veçanta dhe garancive të pranimit, mbështetja e nevojshme për aplikuesit kushtëzohet bazuar në rrethanat e tyre personale; të cilat përfshijnë gjininë, orientimin seksual, identitetin gjinor ose si rezultat i përdhunimit apo formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale.²⁹⁰
- Rregullorja për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim²⁹¹ parasheh përcaktimin e numrit të zyrtarëve në zyrat komunale duke marrë parasysh nevojat e komuniteteve jo-shumicë, grave, fëmijëve dhe të moshuarve. Zyrtarët kanë përgjegjësinë për të vlerësuar nevojat specifike të grave, fëmijëve dhe të moshuarve në komunë.
- Strategjia dhe plani i veprimit për komunitete dhe kthim 2014-2018²⁹² i jep prioritet avancimit të grupeve të të kthyerve që janë në situatë të pafavorshme: të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët. Ajo pranon se ndihma e pamjaftueshme për të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara është sfida dhe rekomandon rritjen e fondeve për këto grupe dhe OSHC-të që punojnë në këtë fushë.

- Udhëzuesi për zbatimin e politikës kombëtare për riintegrim²⁹³ është mjaft i mangët sa i përket aspektit gjinor; aty vetëm përmendet se procesi i riintegrit do të përfshijë të gjithë personat e riatdhesuar pa marrë parasysh moshën, gjininë, përkatësinë etnike, fenë dhe racën.

Gjetjet

Në vitin 2016, më shumë burra (52%) sesa gra parashtruan kërkesa për të hequr dorë nga shtetësia kosovare.²⁹⁴ Mirëpo, më shumë gra kërkuan shtetësinë e Kosovës (59%). Pak më shumë burra (52%) sesa gra morën leje qëndrimi në vitin 2016. Më shumë burra kërkuan azil në Kosovë (66%) sesa gra (44%) në vitin 2016.²⁹⁵ Më shumë burra (69%) ishin në mesin e 3,072 personave të riatdhesuar në vitin 2017, në krahasim me gratë (31%).²⁹⁶ Kjo mund të shpjegohet pjesërisht nga fakti se më shumë burra sesa gra mund të kenë shkuar jashtë vendit, duke kërkuar mundësi ekonomike për të mbështetur familjet e tyre.²⁹⁷

Vajzat, djemtë, gratë dhe burrat që kthehen mund të kenë nevoja të ndryshme ekonomike dhe shoqërore, duke marrë parasysh pozitat e tyre të ndryshme në shoqëri. Për shembull, duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë së lartpërmendur të Kosovës për gratë në veçanti, gratë e kthyer mund të përballen me sfida të shtuara në sigurimin e vendit të punës. Vajzat dhe djemtë mund të përballen me pengesa të ndryshme me të përfunduar arsimimin e tyre. Fëmijët e riatdhesuar romë, ashkali dhe egjiptianë kanë shkallë më të larta të braktisjes së shkollës sesa fëmijët e tjerë.²⁹⁸

Veprimet potenciale

- Të sigurohet që programimi në lidhje me kthimin dhe komunitetet merr parasysh nevojat potencialisht të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve. Të kryhen analiza të mëtejshme gjinore për të identifikuar më mirë nevojat e tyre parësore.
- Të inkurajohet Ministria e Punëve të Brendshme që të publikojë statistikën e zbërthyer sipas gjinisë lidhur me të kthyerit, duke përfshirë masën në të cilën gratë dhe burrat përfitojnë nga subvencionet.

Kapitali njerëzor: Arsimi dhe punësimi

Sektori i kapitalit njerëzor përfshin arsimin, punësimin dhe politikën sociale. Kjo pjesë shqyrton secilën fushë nga pikëpamja gjinore. Në institucionet përgjegjëse për sektorin përfshihen MASHT-i dhe MPMS-ja.

Arsimi

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW nr. 3 nxit shtetet të miratojnë programe edukimi dhe informimi publik që do të ndihmojnë në eliminimin e paragjytimeve dhe praktikave që pengojnë barazinë sociale të grave.¹
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës² njeh të drejtën e të gjithë fëmijëve për arsimim. Kushtetuta e bën këtë Konventë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.³
- Direktiva e rimodeluar përmban dispozita për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë në aftësimin profesional dhe në sigurimin e barazisë në çështjet e profesionit dhe punësimit. Direktiva kryesisht është transpozuar në legjislacionin e Kosovës, por zbatimi mbetet i dobët.⁴
- Synimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm (SZHQ) 4 i OKB-së që ka për qëllim sigurimin e arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimin e mundësive të të nxënës gjatë të gjithë jetës për të gjithë.⁵
- Kushtetuta garanton të drejtën e shkollimit themelor falas dhe që institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tyre.⁶

- Ligji mbi edukimin parashkollor parasheh pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të djemve dhe vajzave në edukimin parashkollor.⁷
- Ligji për arsimin në komunat e Kosovës e obligon MASHT-in që të promovojë një sistem arsimor jo-diskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsim dhe mundësitë e shkollimit cilësor vihen në dispozicion për të gjithë.⁸
- Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës siguron pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në sistemin arsimor. Ai garanton qasje në arsimin parauniversitar pa diskriminim në asnjë bazë, duke përfshirë gjininë dhe statusin martesor, ndër të tjera.⁹ Ligji kërkon që arsimi parauniversitar të përfshijë përgatitjen e nxënësit për jetë të përgjegjshme në frymën e barazisë gjinore.¹⁰ Promovimi i barazisë gjinore duhet të merret parasysh në planifikimin, menaxhimin dhe ofrimin e arsimit parauniversitar.¹¹
- Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës përshkruan parimet e barazisë, mundësive të barabarta pa diskriminim dhe diversitetit si parime themelore të arsimit të lartë.¹² Ai siguron pjesëmarrjen e burrave dhe grave, duke garantuar të drejtën për të qasje në arsim pa diskriminim.¹³
- Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës¹⁴ siguron që burrat dhe gratë mund të marrin pjesë në arsimin dhe aftësimin për të rritur.
- Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional¹⁵ bazohet në parimin e gjithëpërfshirjes dhe siguron që burrat dhe gratë mund të marrin pjesë në arsimin dhe aftësimin profesional.
- Ligji për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë¹⁶ i detyron institucionet të sigurojnë që të rinjtë marrin pjesë dhe kanë ndikim në proceset e rëndësishme vendimmarrëse që prekin interesat e tyre. Ligji detajon fushat në të cilat pjesëmarrja e të rinjve është e detyrueshme, siç janë: arsimi, punësimi, çështjet sociale dhe shëndeti publik. Në ligj nuk përmendet gjinia.

Dokumentet e politikave

- Strategjia kosovare për rininë 2013-2017¹⁷ përfshin tema siç janë: edukimi, shëndetësia, siguria njerëzore, punësimi, sporti, kultura dhe rekreacioni, dhe ka inkorporuar përfshirjen sociale (p.sh., gjinia, përkatësia etnike, rinia rurale/urbane dhe grupe të tjera të marginalizuara) si qasje të përgjithshme. Strategjia e re është në hartim e sipër.
- Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021¹⁸ inkorporon pikëpamjen gjinore në lidhje me arsimin, duke përfshirë tregues dhe aktivitete specifike sipas gjinisë: stimulimi i vijimit të edukimit parashkollor dhe organizimi i aktiviteteve për vetëdijësimin e komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë te vajzat.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021¹⁹ i jep prioritet përfshirjes së fëmijëve të moshave 0-6 vjeç në programet parashkollore. Aty theksohet se kjo do të ketë efekt pozitiv në rritjen e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore.
- PKZMSA²⁰ ka për qëllim përmirësimin e standardit të arsimit, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin profesional dhe punën në zhvillim të politikave për të rinjtë dhe të rejtat, pa diskriminim në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë etnike, fesë, besimit, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual.
- Agienda për Reforma Evropiane (ARE)²¹ thekson se ajo duhet të zbatohet në përputhje me LBGJ-në, duke përfshirë zbatimin në lidhje me reformat e politikave arsimore, duke rritur pjesëmarrjen në arsimin parashkollor dhe duke përmirësuar cilësinë e AAP-së dhe kalimit nga shkolla në punë.

Vijueshmëria në arsimin parauniversitar sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar

Shkalla e vijueshmërisë së arsimit parauniversitar për vajzat dhe djemtë është e ngjashme (48% vajzat ndaj 52% djemtë), me përjashtim të arsimit parashkollor, ku vijueshmëria e djemve është pak më e madhe (54%). Vijueshmëria në arsimin parashkollor në Kosovë është e ulët në përgjithësi për shkak të institucioneve të pamjaftueshme parashkollore që janë të përbalueshme,²³ larg nga Objektivat e Barcelonës të BE-së.²⁴ Kërkesa e tepërt nënkupton

Vijueshmëria në arsimin parauniversitar në Kosovë, e zbërthyer sipas gjinisë, 2015/2016²²

Niveli	Gjithsej	Djem %	Vajza %
Parashkollor	5,892	54%	46%
Parafillor	23,094	52%	48%
Fillor / i mesëm i ultë	250,931	52%	48%
I mesëm i lartë	89,392	52%	48%
Gjithsej	369,309	52%	48%

që institucionet parashkollore nuk i përshtatin tarifat me pagat e prindërve, pavarësisht që kjo parashihet me Ligjin për arsimin parashkollor.²⁵ Mbase më pak vajza sesa djem dërgohen në institucione parashkollore për shkak të qëndrimeve stereotipike gjinore, dhe kuptimit të dobët, veçanërisht jashtë Prishtinës, se arsimi parashkollor është i rëndësishëm.²⁶

Një raport gati i barabartë i vajzave ndaj djemve që marrin asistencë sociale vijnë arsimin parauniversitar, veçanërisht arsimin parashkollor dhe atë fillor/të mesëm të ulët. Gjatë shkollës së mesme të lartë, vijueshmëria në radhët e vajzave që marrin asistencë sociale bie dukshëm, duke sugjeruar që ato largohen nga shkolla, pasi vijimi më nuk është i detyrueshëm.²⁷

Shkalla e vijueshmërisë së nxënësve në arsimin parauniversitar, e zbërthyer sipas përkatësisë etnike, është relativisht proporcionale me demografinë e Kosovës.²⁸ Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë nuk janë në dispozicion.²⁹ Shkalla e braktisjes së shkollës mund të jetë veçanërisht e lartë për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të cilët u riatdhësuan.³⁰ Megjithatë, të dhënat për vijueshmërinë arsimore të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë, të zbërthyer sipas gjinisë, nuk janë të disponueshme. Kjo paraqet vështirësi në kuptimin e dallimeve midis vajzave dhe djemve.

Kosova ka pesë Qendra Burimore dhe dy shkolla për fëmijët me nevoja të veçanta. Më shumë djem (59%) se vajza (41%) me nevoja të veçanta vijnë arsimin e detyrueshëm.³¹ Sfidat për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfshijnë thyerjen e stigmeve shoqërore rreth aftësisë së kufizuar ashtu që prindërit t'i edukojnë fëmijët e tyre.³² Pamjaftueshmëria e mësimdhënësve mbështetës, hapësirave shkollore të qasshme nga aspekti fizik, librave shkollorë dhe pajisjeve mësimore për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara pengon gjithashtu qasjen e tyre të barabartë në arsim. Edhe pse ligji parasheh dispozita të veçanta për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore,³³ nuk ka alokim të buxhetit për t'i përmbushur këto standarde. Një ndryshim i propozuar për (asokohe) Projektligjin për buxhetin për vitin 2018 për alokimin e fondeve për 50 mësimdhënës mbështetës për fëmijët me nevoja të veçanta³⁴ u hodh poshtë në Kuvendin e Kosovës.³⁵

Rezultatet arsimore parauniversitare sipas gjinisë

Nga vendet pjesëmarrëse në testin e Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), Kosova radhitet ndër tre vendet më të dobëta për performancën e përgjithshme arsimore, si dhe në lëndët e shkencës, matematikës dhe leximit.³⁶ Vajzat dolën pak më keq se djemtë në matematikë (djemtë shënuan 8 pikë më shumë) dhe djemtë dolën më keq se vajzat në shkencë (vajzat shënuan mesatarisht 9 pikë më shumë). Vajzat u notuan dukshëm më mirë se djemtë në lexim (mesatarisht 36% më lartë se djemtë). Këto dallime mund t'i atribuohen pjesërisht normave të socializuara gjinore, veçanërisht në zonat rurale, të cilat sugjerojnë se forca fizike e djemve është më e rëndësishme se sa shkrim-leximi dhe vajzat kanë më shumë prije për të lexuar.³⁷

Mësimdhënësit

Raporti midis femrave dhe meshkujve është 40% ndaj 60% për mësimdhënësit të shkollave të mesme, dhe 99.6% ndaj 0.4% për mësimdhënësit të institucioneve parashkollore, respektivisht.³⁸ Dallimi është më i vogël në shkollën fillore dhe të mesme të ulët, me raport të mësimdhënësve prej 54% femra dhe 46% meshkuj. Në pesë qendrat burimore për fëmijët me nevoja të veçanta, dy drejtorë janë gra dhe tre janë

burra. Drejtorët e të dy shkollave e arsimit me nevoja të veçanta janë gra.³⁹ Stereotipat gjinorë profesionalë dhe pagat më të ulëta duket se frenojnë gatishmërinë e burrave që të studiojnë në universitet për mësimdhënës të ciklit të arsimit parauniversitar.⁴⁰ Perceptimet kulturore të roleve zakonisht mashkullore dhe femërore (p.sh. burrat si profesorë, gratë si ofruese të kujdesit) përforcohen nga brezi në brez, duke u konfirmuar nga mungesa e shembëlltyrave mashkullore në arsimin e hershëm dhe mësimdhënëset femra në shkollat e mesme.⁴¹

Universitetet

Ndërsa pak më shumë gra sesa burra studiojnë në programet universitare të nivelit bachelor (54%) dhe master (57%) në universitetet publike, më shumë burra vijnë në studimet në universitete private në programe bachelor (58%) dhe master (67%).⁴² Pak më shumë gra u regjistruan në studimet bachelor (55%) dhe master (51%) në Universitetin e Prishtinës në vitin akademik 2015/2016 në krahasim me burrat.⁴³ Në përgjithësi, më shumë diplomojnë gra (59%) se burra (39%).⁴⁴ Segregacioni gjinor ekziston përgjatë shtigjeve akademike, ku burrat janë dukshëm të nën-përfaqësuar në arsim dhe gratë janë të nën-përfaqësuar në fushën e shkencave kompjuterike, bujqësisë, biznesit dhe gjeoshkencave. Ka bursa vjetore që ndahen për studentet universitare rome, ashkallie dhe egjiptiane.⁴⁵

Universitetet publike (34%) dhe private (26%) punësojnë më pak gra sesa burra në radhët e profesorëve.⁴⁶ Disa gra nga radhët e profesorëve ndihen të pambështetura, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë politik.⁴⁷ Programi i Studimeve Gjinore në Universitetin e Prishtinës është i vetmi i këtij lloji në Kosovë, duke plotësuar nevojat e studentëve që janë (70%) gra dhe (30%) burra. Programi ballafaqohet me telashe për të qëndruar i hapur.⁴⁸

Universitetet publike të Pejës, Gjilanit dhe Gjakovës kanë më shumë gra se burra që diplomojnë nga studimet bachelor dhe master, megjithëse gratë janë të nën-përfaqësuar në radhët e stafit akademik. Përrjashtim paraqet Universiteti i Mitrovicës, që ka më shumë burra sesa gra të regjistruar në studimet bachelor. Në përgjithësi, gratë mbeten të nënpërfaqësuar në pozitat e mësimdhënies dhe administratës akademike.

Arsimi për të rritur dhe i vazhdueshëm

Në vitin 2015, gratë përbënin vetëm 39% të studentëve të regjistruar në Qendrat e Aftësimit Profesional për të rritur (QAP) dhe 36% të vijuesve të kurseve të arsimit për të rritur ishin gra.⁴⁹ Një arsye e sugjeruar për këtë ishin perceptimet shoqërore se QAP-të plotësojnë nevojat për profesionet "mashkullore".⁵⁰ Njerëzve gjithashtu mund t'u mungojnë njohuritë rreth opsioneve të arsimit profesional dhe i konsiderojnë ato si inferiore ndaj arsimit të lartë.⁵¹ Një tjetër faktor kufizues është mungesa e transportit publik deri te QAP-të, gjë që prek veçanërisht gratë për shkak të shqetësimeve të sigurisë.⁵²

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

Objekti: "Qasja e barabartë për vajzat dhe gratë në të gjitha nivelet e arsimit dhe në arsim e aftësim profesional (AAP) cilësor pa diskriminim" (PVGJ 13)

o Treguesit:

- 1) "Numri i mësimdhënësve të trajnuar me mbështetjen e BE-së" (KRBE, PVGJ 13.9) për zhbërjen e normave, roleve dhe stereotipave të socializuar gjinorë, si dhe marrëdhënieve të pushtetit gjinor. *Pikënisja: 0.*
- 2) Përqindja e mësimdhënësve në arsimin parashkollor që janë burra. *Pikënisja: 0,4%.*
- 3) Përqindja e grave në radhët e profesorëve në institucionet publike të arsimit të lartë. *Pikënisja: 34%.*
- 4) "Raporti i femrave ndaj meshkujve që kanë përfituar nga arsimi dhe aftësimi profesional/zhvillimi i shkathtësive, dhe programet tjera të masave aktive të tregut të punës të BE-së" (PVGJ 13.10), ose përqindja e grave që vijnë në shkollat profesionale. *Pikënisja: 39%.*
- 5) Përqindja e vijuesve të arsimit për të rritur që janë gra. *Pikënisja: 36%.* (Në përputhje me PVGJ 13);
- 6) Përqindja e fëmijëve që vijnë në institucionet parashkollore, e zbërthyer sipas gjinisë.⁵³ *Pikënisja: 15.5% në 2015*

- 7) Përqindja e vajzave me nevoja të veçanta që vijnë arsimin e detyrueshëm. *Pikënisja: 41%*. (Kontribuon në PVGJ 13.1).
 - 8) “Numri i programeve që raportojnë përmirësim të cilësisë dhe disponueshmërisë së statistikave të zbërthyer sipas seksit/specifike sipas gjinisë përmes mbështetjes së BE-së” (PVGJ 6.1.2), veçanërisht lidhur me statistikën e arsimit të zbërthyer edhe sipas gjinisë edhe sipas përkatësisë etnike.
- o Veprimet:
- 1) Të mbështetet qeveria në dizajnimin dhe institucionalizimin e trajnimit të mësimeve për zhbërjen e normave, roleve dhe stereotipave të socializuar gjinorë, si dhe marrëdhënieve të pushtetit gjinor.
 - 2) “Të promovohen modele të barabarta gjinore në kalimin nga arsimi në tregun e punës përmes kurrikulave dhe paritetit gjinor midis mësimeve” (PVGJ 13).
 - 3) Të mbështetet qeveria për të instaluar masa afirmative për punësimin e burrave si mësime në arsimin parashkollor dhe grave në institucionet e arsimit të lartë.
 - 4) Të inkurajohet MASHT-i që të buxhetojë dhe të punësojë më shumë psikologë në shkollë, si dhe të rrisë kapacitetet e tyre profesionale për adresimin e dhunës në bazë gjinore dhe parandalimin e braktisjes së shkollës.
 - 5) Të mbështetet qeveria për të institucionalizuar dhe për “ofrimin e arsimit (formal dhe joformal), që adreson stereotipin gjinor dhe lejon të mësuarit gjatë gjithë jetës” (PVGJ 13) për fëmijët në të gjitha nivelet.
 - 6) Të mbështetet zhvillimi, institucionalizimi dhe promovimi i programeve më të larmishme të AAP-së që adresojnë nevojat e tregut dhe janë të përshtatura enkas për nevojat e veçanta të grave.
 - 7) Të mbështetet qeveria për të zhvilluar disponueshmërinë e kujdesit dhe masa të tjera afirmative që do të mbështesin vijueshmërinë e grave në arsimin profesional dhe për të rritur.
 - 8) Të inkurajohet dhe mbështetet qeveria për të përmirësuar qasjen në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht vajzave, duke alokuar resurse për ndihmë personale, transport të qasshëm, ndërtesa të qasshme dhe materiale adekuate didaktike.
 - 9) Të mbështetet qeveria në zgjerimin e disponueshmërisë së institucioneve parashkollore në përputhje me Objektivat e Barcelonës të BE-së, duke përfshirë marrëdhëniet gjinore në kurrikulat e edukimit të hershëm.
 - 10) Të mbështetet qeveria për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave në lidhje me vijueshmërinë dhe arritshmërinë në arsim, të zbërthyer sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë.

Punësimi

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- CEDAW kërkon që shtetet palë të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në punësim, ashtu që gratë dhe burrat të gëzojnë të drejtat e njëjta.⁵⁴
- Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian⁵⁵ vendos parimin e pagës së barabartë për gratë dhe burrat për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë. Ndonëse parimi i pagës së barabartë është i integruar në ligjin e Kosovës, nuk ka të dhëna për hendekun gjinor të pagave në mënyrë që të matet zbatimi.⁵⁶
- Direktiva e Rimodeluar synon të sigurojë zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim dhe profesion. Ajo përmban dispozita që lidhen me: qasjen në punësim, aftësim profesional, kushte të punës dhe skemat e sigurimeve sociale profesionale. Direktiva është transpozuar kryesisht saktë në legjislacionin e Kosovës, por zbatimi mbetet i dobët.⁵⁷
- Direktiva për pushimet prindërore⁵⁸ parasheh pushimin prindëror për periudhën prej së paku katër muajsh si e drejtë individuale e punonjësve gra dhe burra, për të promovuar mundësi të barabarta

dhe trajtim të barabartë.⁵⁹ Direktiva ende pritet të transpozohet saktë në legjislacionin e Kosovës, veçanërisht në lidhje me pushimin e atësisë, pushimin prindëror dhe pushimin e ofruesve të kujdesit.⁶⁰

- Direktiva për punonjëset shtatzëna⁶¹ parasheh të paktën 14 javë pushim lehonie dhe përfshin masa për të përmirësuar shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës për punonjëset shtatzëna dhe punonjëset që kanë lindur rishtazi ose janë me fëmijë në gj. Mbrojtja e shtatzënisë dhe amësisë janë transpozuar në ligjin e Kosovës.
- Direktiva për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të angazhuar në një aktivitet në cilësi të vetë-punësimit⁶² nuk është transpozuar saktë në ligjin e Kosovës. Gratë e vetë-punësuar duhet të regjistrohen zyrtarisht dhe prindërit e vetë-punësuar duhet të gëzojnë të drejta të barabarta në lidhje me amësinë dhe të drejtat prindërore me ato të prindërve që janë të punësuar.⁶³
- Ligji i punës përmban ndalimin e diskriminimit në punësim dhe bën që dispozitat e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi të zbatohen për marrëdhëniet në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit në sferat private dhe publike.⁶⁴ Ligji gjithashtu parasheh të drejtën e pushimit të lehonisë dhe mbrojtjen e grave shtatzëna dhe gjdhënëse në vendin e punës. Dispozitat për pushimin e lehonisë, sipas të cilave punëdhënësit paguajnë për gjashtë muaj pushimin e lehonisë, thuhet se kanë kontribuar në diskriminimin ndaj grave në punësim dhe shkallën krahasimisht më të lartë të papunësisë të grave.⁶⁵ Dispozita për pushimin e atësisë për burrat, vetëm tri ditë me pagesë dhe dy javë pa pagesë, është ndesh me konceptet e barazisë gjinore dhe mundësive të barabarta të përcaktuara në LBGJ. Për më tepër, dispozitat e kontratës nuk marrin parasysh në mënyrë adekuate pushimin e lehonisë, duke kontribuar në diskriminimin e tërthortë ndaj grave.⁶⁶
- Ligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri u garanton grave punonjëse të drejtën për dy orë pushim me pagesë për gjdhënie gjatë orarit të punës.⁶⁷ Mirëpo, kjo e drejtë zbatohet vetëm pasi të jenë shfrytëzuar gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, duke lënë boshllëk në mbrojtje për gratë që kthehen në punë më herët.⁶⁸ Pas vitit të parë dhe deri në dy vjet, kjo reduktohet në një orë pushim me pagesë çdo ditë. Për ta shfrytëzuar këtë të drejtë, punonjëset duhet të njoftojnë punëdhënësit e tyre me shkrim me një certifikatë të lëshuar nga mjeku.
- Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë zbatohet për sektorin publik, sektorin privat, partneritetet publike-private dhe administratën shtetërore, dhe detyron punëdhënësit që të udhëhiqen nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit.⁶⁹ Ai gjithashtu detyron punëdhënësit që të informojnë të punësuarit lidhur me masat e ndërmarra për të siguruar shëndetin dhe mbrojtjen në punë për fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna, gratë me fëmijë në gj dhe personat me aftësi të kufizuara.⁷⁰
- Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës pranon se gratë nga komunitetet pakicë janë në rrezik të diskriminimit të dyfishtë në punësim dhe mundësi ekonomike dhe shoqërore, si rrjedhojë e gjinisë apo përkatësisë në ndonjë komunitet të veçantë. Ligji thotë që qeveria miraton masa të veçanta kundër këtij diskriminimi.⁷¹
- Ligji për Inspektoratin e Punës⁷² mbështet zbatimin e Ligjit të punës përmes themelimit të Inspektoratit të Punës; organ që mbikëqyr zbatimin e legjislacionit në lidhje me marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe kontratat kolektive. Inspektorati gjithashtu këshillon punëdhënësit dhe të punësuarit për zbatueshmërinë e dispozitave ligjore. Ai i raporton Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale për mangësitë dhe pengesat në kuadrin ligjor aktual.
- Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara rregullon mbështetjen institucionale për rehabilitimin, aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara bazuar në parimet e trajtimit të barabartë dhe barazinë gjinore.⁷³ Ligji obligon organet e administratës shtetërore, sektorin privat, sektorin publik dhe organizatat jo-qeveritare (OJQ) të punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë punonjës.⁷⁴
- Kodi Penal⁷⁵ përvijon veprat penale lidhur me të drejtat e punës, ku përfshihen: cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës (p.sh., mbrojtja e grave, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara), mohimi apo kufizimi i të drejtës së personave në punësim sipas kushteve të njëjta, cenimi i të drejtës

në grevë, dhe cenimi dhe/ose keqpërdorimi i të drejtave nga sigurimi social. Dënimet shkojnë nga gjobat deri në tre vjet burgim, në varësi të veprës penale.

- Udhëzimi Administrativ për klasifikimin e formave të rënda dhe të rrezikshme të punës që mund të dëmtojnë shëndetin e grave shtatzëna dhe gjdhënës⁷⁶ përmban dispozita dhe masa për të përmirësuar shëndetin dhe sigurinë e punonjëseve shtatzëna dhe gjdhënës në punë.

Dokumentet e politikave

- ARE-ja i jep prioritet trajtimit të papunësisë së të rinjve dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.
- PKZMSA-ja parasheh masat për transpozimin e *acquis*-ve të BE-së për barazinë gjinore në lidhje me politikën sociale dhe punësimin në legjislacionin e Kosovës deri në vitin 2020.⁷⁷
- Prioritetet e SKZH-së parashohin forcimin e mekanizmave dhe koordinimin e veprimeve institucionale që synojnë uljen e punësimit joformal në mesin e burrave dhe grave.
- Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 parasheh kërkime me tregues që marrin parasysh aspektin gjinor lidhur me gjendjen e grave dhe burrave romë dhe ashkali në tregun e punës, pasuar nga një raport.

Gjetjet

Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Pjesëmarrja në tregun e punës në Kosovë është e ulët në shkallë alarmante. Siç ilustron tabelë, vetëm 43% e popullsisë në moshë pune ishin aktivë në vitin 2017, që do të thotë se ata janë qoftë të punësuar ose kërkojnë punë. Vetëm 20% e grave morën pjesë në fuqinë punëtore, krahasuar me 65% të burrave. Mirëpo, vetëm 13% e grave të moshës së punës ishin të punësuar, krahasuar me 47% të burrave. Moshë luan rol sidomos te gratë; papunësia e përgjithshme në mesin e grave ishte 37%, mirëpo 64% e të grave të reja (moshat 15-24 vjeç) ishin të papuna. Mes burrave, 29% ishin të papunë, krahasuar me 48% të burrave të rinj. Ndër të rinjtë, 24% e burrave të rinj nuk ishin në punësim, arsimim apo trajnim (NEET) krahasuar me 31% të grave të reja.

Treguesit kryesorë të fuqisë punëtore (2017) ⁷⁸			
Tregues	Gjithsej	Burra	Gra
Pjesëmarrja në tregun e punës	43%	65%	20%
Raporti punësim popullsi	30%	47%	13%
Joaktiviteti	57%	34%	80%
Papunësia	31%	29%	37%
Papunësia e të rinjve (15-24)	53%	48%	64%
Të rinj NEET	27%	24%	31%

Segregacioni gjinor i profesioneve vazhdon të jetë i pranishëm. Tendenca është që sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe tregtisë të punësojnë gra (48% të të gjitha grave të punësuar). Në sektorët e prodhimit, ndërtimtarisë dhe tregtisë, tendenca është që të punësojnë burra (46% të të gjithë burrave të punësuar).⁷⁹ Këto përqindje kanë mbetur mjaft të qëndrueshme me kalimin e kohës.

Tendenca është që gratë e punësuar të sigurojnë vendet e punës përmes shpalljeve për vende të lira dhe proceseve sistematike të punësimit.⁸⁰ Vetëm 0.2% e grave të intervistuar u punësuan për pozitën e tyre të tanishme përmes zyrave të punësimit.⁸¹ Të dhënat për të lehtësuar krahasimet me burrat nuk ekzistojnë. Mesatarisht, gratë kanë raportuar të kenë kryer pesë intervista gjatë pesë viteve të fundit.⁸² Në krahasim, burrat e anketuar raportuan se morën pjesë në 3.6 intervista. Kjo sugjeron që grave u duhet të kalojnë nëpër më shumë intervista sesa burrat kur përpiqen të sigurojnë vend pune. Mbase, kjo shpjegohet pjesërisht nga fakti se 47% e punëdhënësve besonin se puna e tyre ishte e përshtatshme për burra, kurse 9% thanë se puna ishte për gra dhe 35% thanë si për gra ashtu edhe burra.⁸³

Është alarmante që 80% e grave ishin joaktive në fuqinë punëtore, krahasuar me 34% të burrave. Burrat janë të prirë të jenë joaktivë për shkak të vijimit të shkollës, arsimit ose trajnimit (37%).⁸⁴ Kjo është arsyeja e dytë më e përhapur për joaktivitetin midis grave; arsyeja më e shpeshtë për joaktivitetin e grave duket të jenë përgjegjësitë e ofrimit të kujdesit në shtëpi, kryesisht kujdesi për fëmijët (32%). Për krahasim, vetëm 1% e burrave ia atribuonë joaktivitetin përgjegjësi të ofrimit të kujdesit për fëmijët. Kufizimet lidhur me disponueshmërinë e transportit publik gjithashtu mund të minojnë qasjen e grave në punë.

Papunësia e lartë e grave mund të kontribuojë në feminizimin e varfërisë. Në vitin 2015, 18% e grave dhe 17% e burrave jetonin në varfëri.⁸⁵ Gratë dhe vajzat përbënin 60-65% të anëtarëve të ekonomive familjare që varen nga ndihma sociale nga viti 2013 në 2016.⁸⁶ Shkalla e ulët e punësimit të grave dhe/ose puna në ekonominë joformale gjithashtu kontribuojnë në pensionet më të ulëta, pasi puna e papaguar nuk merret parasysh gjatë llogaritjes së pensioneve.⁸⁷

Pak dihet rreth ekonomisë joformale, veçanërisht nga pikëpamja gjinore. Të dhënat zyrtare janë të dobëta për shkak të nën-raportimit të punës me qëllim të shmangies tatimore, dhe faktit që ekzistojnë kuptime të shumëfishta të kësaj shprehjeje.⁸⁸ Sipas përkufizimit të Bankës Botërore dhe duke marrë parasysh çështjet e lartpërmendura, mbi një e treta e punëtorëve janë klasifikuar si joformalë.⁸⁹ Joformaliteti besohet të jetë më i lartë në mesin e të rinjve, burrave, banorëve më pak të arsimuar dhe atyre në mjedise rurale.⁹⁰ Sidoqoftë, lypset të bëhet kërkim i mëtejshëm. Gratë e punësuar në sektorin privat, shpesh i përkasin sektorit joformal. Kjo e bën këtë kategori të grave shumë të ndjeshme ndaj riskut financiar, emocional dhe fizik.⁹¹ Për më tepër, një anketë në mbarë Kosovën ka treguar se në sektorin privat, rreth 30% e grave punojnë pa kontratë.⁹²

Një studim i kohëve të fundit i shfrytëzimit të kohës ka zbuluar se burrat, mesatarisht, kalojnë 400% më shumë kohë (3.9 orë në ditë) në punë sesa gratë (0.9 orë në ditë).⁹³ Ndërkaq, gratë kalojnë 300% më shumë kohë në aktivitete shtëpiake dhe kujdes familjar (7.1 orë) sesa burrat (2.3 orë).⁹⁴ Kosovarët përmendën trajtimin e barabartë për gratë dhe burrat në vendin e punës (32%), paga të barabarta për mundësi të barabarta (25%), disponueshmërinë e vendeve të punës me orar jo të plotë/fleksibël (17%) dhe qasjen në qendrat e kujdesit të fëmijëve (14%) si shtysa për gratë që të bëhen më aktive në fuqinë punëtore.⁹⁵

Diskriminimi në procesin e punësimit dhe në punë

Ka dëshmi gjithashtu që sugjerojnë që gratë e reja janë të diskriminuara në procesin e rekrutimit.⁹⁶ Nga gratë kërkohet të ndajnë informacion në lidhje me planet e tyre familjare në intervistat për punë, dhe disa gra raportojnë se nuk marrin oferta pune nëse e kanë në plan për të mbetur shtatzënë. Të tjerave u janë anuluar kontratat e punës pasi kanë bërë të ditur se janë shtatzënë. Në një studim, në pyetjen rreth përzgjedhjes së kandidatëve për punësim, 55% e punëdhënësve thanë se nuk marrin parasysh planet familjare të kandidatit për punë gjatë procesit të punësimit, ndërkaq 45% thanë se i marrin parasysh. Kjo sugjeron që disa punëdhënës po i diskriminojnë gratë në procesin e punësimit bazuar në planet e tyre familjare.⁹⁷

Në një studim tjetër, 11% e grave të punësuar të anketuara thanë se janë diskriminuar në punë.⁹⁸ Për më tepër, deri një e treta kishin përjetuar paragjykimë gjinore në punë, edhe pse vetë ato nuk e konsideronin këtë doemos si diskriminim. Kjo sugjeron që gratë mund të mos e dinë gjithmonë se çka përbën diskriminim. Nuk ka të dhëna të ngjashme të disponueshme nga burrat e punësuar për të mundësuar krahasimin.

Pushimi prindëror

Gratë që punojnë në sektorin publik kanë treguar tendencë të shfrytëzimit të përfitimit të pushimit të lehonisë më shumë se gratë që punojnë në sektorë të tjerë.⁹⁹ Vetëm 18% e punëdhënësve të anketuar (duke përfshirë sektorin privat, publik dhe shoqërinë civile) kishin një politikë që garanton kthimin e grave në punë pas pushimit të lehonisë.¹⁰⁰ Sidoqoftë, shumica e punëdhënësve deklaruan se ata sigurojnë që gratë do të marrin të njëjtën pagë, të drejta dhe kushte pas kthimit. Megjithatë, shumë gra thanë se kishin përjetuar diskriminim dhe punëdhënësit nuk kishin mekanizma të ankesës. Ndërsa çështje kryesore ishin komentet e pakëndshme në vendin e punës, më shumë se një e pesta e grave të anketuara raportuan se nuk ishin ngritur në detyrë, duhej të punonin jashtë orarit, u ishin dhënë punë të papërshtatshme dhe/ose ishin kritikuar pa vend bazuar në performancën e tyre.¹⁰¹

Shumica e punëdhënësve (57.5%) deklarojnë se i japin punonjësve dy deri në tri ditë pushim të atësisë, që është në përputhje me Ligjin e punës. Shumë punëdhënës u japin punonjësve më shumë se tri ditë pushim të atësisë. Pothuajse një e pesta e burrave të anketuar të cilët u bënë baballarë raportuan se nuk e kishin të mundur të merrnin ditë pushimi, gjë që është ndesh me Ligjin. Përveç kësaj, shumica e punëdhënësve vazhduan t'i paguajnë burrave pagën ose rrogën e tyre të rregullt, edhe pse 26% deklaruan

se nuk kishin marrë pushim atësie dhe 5% raportuan se kishin marrë 70% të pagës së tyre të rregullt. Kështu, disa baballarë të rinj mund të duhet të zgjedhin midis marrjes së pagës së tyre të rregullt ose marrjes së pushimit të atësisë. Shumica e burrave besojnë se pushimi i atësisë prej dy deri në tri ditë është shumë i shkurtër, dhe se pushimi i atësisë duhet të zgjatet në të paktën katër ditë deri në një muaj pas lindjes së fëmijës.¹⁰² Pak më shumë se gjysma (54%) thanë se do të merrnin pushim vetëm nëse do të vazhdonin të marrin pagën e tyre të plotë. Kërkimi i kryer në vitin 2018 tregon se 31% e burrave do të merrnin pushim prindëror deri në tre muaj nëse do të ishte me pagesë deri në 70% të pagës së tyre bazë, ndërsa 18% do të merrnin të njëjtin kompensim deri në gjashtë muaj.¹⁰³ Për më tepër, 8% e burrave do të merrnin pushim prindëror deri në nëntë muaj.

Zyrat e punësimit dhe Qendrat e Aftësisimit Profesional

Më shumë burra sesa gra regjistrohen në Zyrat e Punësimit (ZP),¹⁰⁴ edhe pse të dhënat e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore tregojnë se në Kosovë ka më shumë gra të papuna sesa burra. Në vitin 2017, 45% e të gjithë personave të regjistruar në ZP ishin gra dhe 55% ishin burra. Megjithatë, kjo ilustron pjesërisht shkallën e lartë të joaktivitetit të grave.

ZP-të kanë qenë shumë joefikase në gjetjen e punësimit për të regjistruarit, veçanërisht gratë. Për shembull, në 2016, ZP-të gjetën punësim për 4% të të regjistruarve (vetëm 39% e të cilëve ishin gra); ndërsa në vitin 2017 ato gjetën punësim vetëm për 3% të të regjistruarve (vetëm 40% e tyre ishin gra). Mungon informacioni cilësor lidhur me arsyet që janë në rrënjë të këtyre dallimeve gjinore dhe lypsen kërkime të mëtejshme.

Ndonëse gratë përfaqësojnë shumicën e të papunëve dhe atyre ekonomikisht joaktive, ato përbëjnë pakicë në radhët e atyre që ndjekin kurse në Qendrat e Aftësisimit Profesional (QAP). Në vitin 2015, gratë përbënin 44% të të gjithë personave që vijuan kurse në QAP-të, 27% në vitin 2016 dhe 34% në vitin 2017. Në një anketë të kohëve të fundit, 76% e grave deklaruan se nuk kanë ndjekur asnjëherë programe të trajnimit të përshtatura enkas me qëllim të përmirësimit të shkathtësive në lidhje me vendin e punës.¹⁰⁵ Gratë që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor ose më pak, janë joaktive në fuqinë punëtore dhe fitojnë më pak se 150 euro në muaj, janë të mbi-përfaqësuar midis grave që nuk kanë ndjekur asnjëherë trajnime të tilla.¹⁰⁶

Personat e regjistruar në ZP sipas gjinisë			
Viti	2015	2016	2017
Gra	44%	44%	45%
Burra	56%	56%	55%
Gjithsej	112,179	101,773	93,866

Personat që gjetën punë përmes ZP-ve sipas gjinisë			
Viti	2015	2016	2017
Gra	34%	39%	40%
Burra	66%	61%	60%
Gjithsej	3,574	4,022	3,215

Personat që vijnë në QAP-të sipas gjinisë			
Viti	2015	2016	2017
Gra	44%	27%	34%
Burra	56%	73%	66%
Gjithsej	4,055	6,736	5,962

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- **Objektivi:** [Të përmirësohet] “qasja në punë të denjë për gratë e të gjitha moshave” (PVGJ 14).
 - o **Treguesit:**
 - 1) Përqindja e grave joaktive në fuqinë punëtore (PVGJ 14.4). *Pikënisja: 80%.*
 - 2) Përqindja e grave të reja të papuna (PVGJ 14.4). *Pikënisja: 64%.*
 - 3) Përqindja e personave të regjistruar me ZP-të që janë gra. *Pikënisja: 44%.*
 - 4) Përqindja e personave të punësuar përmes ZP-ve që janë gra. *Pikënisja: 39%.*
 - 5) Përqindja e personave që ndjekin trajnim të përshtatur enkas në QAP që janë gra. *Pikënisja: 34%.*
 - 6) “Numri mesatar i orëve të shpenzuara për punë të paguar dhe të papaguar së bashku (barra e punës gjithsej) sipas seksit (SZHQ 5.42, PVGJ 14.2) *Pikënisja: gra, 8, burra, 6.2.*
 - o **Veprimet:**
 - 1) Të mbështetet qeveria e Kosovës në krijimin e më shumë qendrave të kujdesit ditor për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, që do të përmirësojë rezultatet arsimore (dhe punësimin e gjeneratave të ardhshme), do të krijojë vende të reja pune duke përfshirë transformimin e punës së papaguar në punë të paguar dhe do të shkarkojë gratë

nga rolet e përshkruara shoqërore të ofrimit të kujdesit pa pagesë në mënyrë që të mund të kërkojnë punësim.

- 2) “Të mbështeten reformat në legjislacion dhe financa publike për nga pikëpamja gjinore, të cilat marrin parasysh rolin e grave në ekonominë e ofrimit të kujdesit, punën e papaguar, shpërndarjen e pabarabartë gjinore të përgjegjësive familjare, mbi-përfaqësimin në ekonominë joformale, gratë në bujqësi dhe hendekun gjinor të pagave”. Të inkurajohet fuqishëm qeveria që të punojë ngushtë me OGSHC-të dhe të marrë për bazë dëshmitë specifike nga Kosova për të ndryshuar Ligjin e punës dhe për të transpozuar Direktivën për pushimin e prindëror, Direktivën për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të angazhuar në një aktivitet në cilësi të vetë-punësimit dhe, potencialisht, Direktivën për baraspeshë midis jetës dhe punës (nëse adoptohet). Pastaj, “të mbështeten kapacitetet institucionale për t’i realizuar këto reforma dhe politika” (PVGJ 14).
- 3) “Të mbështeten sfidat ndaj normave dhe qëndrimeve shoqërore që pengojnë fuqizimin ekonomik të grave, duke përfshirë njohjen ekonomike dhe shoqërore të punës dhe kujdesit të papaguar” (PVGJ 14).
- 4) “Të analizohet dhe të adresohet [...] i fuqisë punëtore femërore në ekonominë joformale” (PVGJ 14, 6.1)
- 5) Të mbështetet Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në institucionalizimin e analizave të rregullta gjinore që kanë të bëjnë me hendekun gjinor të pagave, që do të kontribuojë në krijimin e Indeksit të Barazisë Gjinore (PVGJ 6.1). Gjithashtu, të mbështetet ASK-ja në institucionalizimin e studimit të rregullt të shfrytëzimit të kohës, i cili do të zbulonte informata për ekonominë joformale, si dhe për mënyrat sesi gratë dhe burrat kalojnë kohën e tyre.
- 6) Të mbështeten ZP-të në ngritjen e kapaciteteve për të regjistruar më mirë arsyet pse gratë apo burrat nuk sigurojnë punësim përmes ZP-ve, me qëllim të identifikimit të qasjeve të përmirësuara.
- 7) Të mbështeten programet novatore të përshtatura enkas për të mbështetur punësimin e grave.

Konkurrueshmëria dhe novacioni

Konkurrueshmëria dhe novacioni është prioritet financiar i BE-së për vendet kandidate potenciale të BE-së, pasi realizimi i ekonomisë funksionale të tregut me kapacitet për të përballuar konkurrencën dhe forcat e tregut është përfshirë në kriteret e Kopenhagës. Kjo pjesë ofron analizë gjinore të politikave, praktikave dhe pabarazive në fushat e konkurrueshmërisë dhe TIK-ut, respektivisht.

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- Ligji për mbrojtjen e konkurrencës¹ nuk përmban asnjë pikëpamje gjinore.
- Ligji për ndihmën shtetërore,² i cili rregullon parimet dhe procedurat lidhur me ndihmën që jepet nga shteti për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror dhe për të mbrojtur konkurrencën, nuk përmban asnjë pikëpamje gjinore.
- Ligji për masat mbrojtëse në importe³ nuk përmban asnjë pikëpamje gjinore. Prodhuesit e vegjël (ku gratë kanë tendencë të punojnë ose të jenë pronare) mund të mos kenë resurset e nevojshme për parashtrimin e ankesave ndaj konkurrentëve të huaj që vërshojnë tregun e Kosovës.⁴
- Ligji për masat antidumping dhe masat kundërbalancuese⁵ përmban kriteret të ngjashme të rrepta për ankesë.⁶ Ligji nuk përmban asnjë pikëpamje gjinore.

Dokumentet e politikave

- PKZMSA-ja fokusohet në zhvillimin dhe hartimin e akteve ligjore që do të transpozoin legjislacionin e BE-së në fushën e konkurrencës. Masat e tjera përfshijnë: aftësimin profesional, nga i cili do të përfitonin gratë dhe burrat e stafit të Autoritetit të Konkurrencës, dhe aktivitetet për ngritjen e vetëdijes me hisedarët përkatës.
- Prioritetet e ERA-s për konkurrueshmërinë dhe klimën e investimeve duhet të zbatohen në përputhje me LBGJ-në.
- SKZH-ja, si pjesë e prioritetit për industrinë konkurruese, përfshin sigurimin e mbrojtjes së të drejtave pronësore për komunitetet jo-shumicë dhe gratë.
- Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat (SZHSP) 2017-2021 merret me tregtinë, biznesin dhe joformalitetin, por nuk përmban pikëpamje gjinore ose nuk adreson sfidat specifike me të cilat ballafaqohen gratë.

Gjetjet

Në Kosovë mungon analiza gjinore lidhur me ndikimin e tregtisë në barazinë gjinore.

Në vitin 2017, ndërmarrjet në pronësi të grave përbënin vetëm 13% të të gjitha ndërmarrjeve në Kosovë.⁷ Gratë zotëronin 18% të bizneseve të reja të regjistruara midis 2014 dhe 2016.⁸ Tendencat ishin që gratë të punojnë në kooperativa bujqësore më shumë se në llojet e tjera të bizneseve. Shumica e grave që regjistruan biznese hapën biznese individuale. Gjatë kësaj periudhe, asnjë grua nuk ka hapur kompani publike, kompani shoqërore, apo kompani me ortakëri të kufizuar.⁹ Pjesërisht për shkak të nën-përfaqësimit të tyre midis pronarëve të ndërmarrjeve, gratë kanë marrë më pak subvencione shtetërore për zhvillim të biznesit sesa burrat. Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë përbënin më pak se 17% të ndërmarrjeve që morën subvencione nga KIESA; burrat ishin në krye të 83% të ndërmarrjeve përfituese.¹⁰ Ndërmarrjet në pronësi të grave morën 25 herë më pak fonde të subvencioneve, pavarësisht faktit që raporti i ndërmarrjeve të regjistruara të grave ndaj burrave është një me gjashtë, duke sugjeruar që ndarja e fondeve është shkajshmërisht jo-proporcionale. Arsyet e vërejtura përfshijnë faktin se më pak gra aplikojnë, dhe gratë mund të jenë më pak të afta të sigurojnë bashkëfinancim për shkak të situatës së tyre ekonomike.

Bizneset në pronësi të grave janë të orientuara kah sektorët e tregtisë, prodhimit dhe shërbimeve; 31% e të gjitha bizneseve në pronësi të grave ofruan shërbime, 29% u angazhuan në tregti dhe 15% në prodhim.¹¹ Shumica ofruan shërbime të tilla si floktaria dhe shërbimet e tjera estetike. Tri barrierat kryesore me të cilat ballafaqohen gratë pronare të bizneseve janë normat tatimore, barra

administrative dhe tregu përgjithësisht i vogël në Kosovë. Vlerësohet se vetëm rreth 15% e grave që janë pronare të bizneseve kanë marrë hua nga bankat komerciale.¹² Pothuajse 88% të grave ndërmarrëse kanë krijuar biznese të veta, pa mbështetjen e të tjerëve, ndërsa më shumë se gjysma kanë përdorur kapitalin e vet për këtë qëllim.¹³

Kosova ka Bankën Qendrore dhe disa banka komerciale. Asnjë nga katër bankat kryesore të intervistuar nuk deshën të shprehin gatishmëri të ndajnë të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë në lidhje me huamarrësit. Një bankë nuk mbante të dhëna të tilla. Të tjerat refuzuan t'i shpalosin këto të dhëna ose thanë se do të merrte shumë kohë për t'i zbërthyer në mënyrë manuale.¹⁴ Gjetjet e mëparshme kanë sugjeruar që gratë përballen me sfida shtesë në qasjen në kredi për të zhvilluar bizneset e tyre, sepse grave u mungon qasja e barabartë në kredi dhe ato zotërojnë më pak kapital se burrat.¹⁵ Fondet e kufizuara mund ta bëjnë të vështirë zgjerimin për ndërmarrjet në pronësi të grave.¹⁶ Fondi Kosovar për Garanci Kreditore u themelua në vitin 2017 për të rritur qasjen në kredi për grupet e marginalizuara, duke përfshirë gratë dhe pakicat.¹⁷

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- **Objektivi:** “Qasja e barabartë për gratë në shërbimet financiare, resurset prodhuese, përfshirë tokën, tregtinë dhe ndërmarrësinë” (PVGJ 15).
 - o **Treguesit:**
 - 1) Përqindja e grave dhe burrave, përkatësisht, me “dëshmi të dokumentuara ose të njohura të zotërimit” (SZHQ 1.5, PVGJ 15.1) *Pikënisja: Ndryshorja kontrolluese: gratë zotëruan 17% të pronave në 2017*¹⁸
 - 2) Numri i “grave dhe burrave që kanë [siguruar] zotërim të sigurt të tokës me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 15.7). *Pikënisja: Varet nga projekti.*
 - 3) Përqindja e subvencioneve të KIESA-s që mbështesin ndërmarrjet në pronësi të grave. *Pikënisja: 17%*
 - 4) “Numri i grave që i qasen shërbimeve (mikro-) financiare në nivel të komunitetit me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 15.8). *Pikënisja: Varet nga projekti.*
 - 5) Përqindja e ndërmarrjeve në pronësi të grave. *Pikënisja: 13%.*
 - 6) Përqindja e bizneseve të reja të regjistruara në pronësi të grave. *Pikënisja: 18%.*
 - 7) “Hendeku gjinor në paga, sipas sektorëve të aktivitetit ekonomik” (SZHQ 5.1, PVGJ 15.3). *Pikënisja: E padisponueshme*¹⁹
 - 8) Numri i “grave që i qasen shërbimeve (mikro-) financiare në nivel të komunitetit me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 15.8). *Pikënisja: Varet nga projekti.*
 - o **Veprimet:**
 - 1) “Mbështetja e legjislacionit transformues për pronësinë, trashëgiminë dhe kontrollin e tokës dhe resurseve të tjera prodhuese nga gratë, me vëmendje të veçantë për popujt indigjenë” (PVGJ 15). Shih gjithashtu rekomandimet e pjesës për Sundimin e Ligjit.
 - 2) Të mbështetet KIESA në hartimin e programeve që: a) përfshijnë masat afirmative sipas LBGJ-së, të tilla si favorizimi i propozimeve që përfshijnë baraspeshë të punonjësve gra dhe burra; b) përmirësojnë shtrirjen e informimit që vë në shënjestër gratë, në veçanti me informacion rreth mundësive; dhe c) dizajnimi i programeve të subvencionimit me kritere të ndryshme që vënë në shënjestër vetëm gratë, si masë afirmative. Të përfshihet monitorimi para, gjatë dhe pas subvencioneve për të siguruar që gratë përfitojnë drejtpërsëdrejti nga grantet.
 - 3) Të mbështeten programet për gra për edukim të vazhdueshëm, punë praktikante, mentorim, hartim të planeve të biznesit dhe aplikacioneve për grante, duke e bërë të mundur që më shumë gra të aplikojnë.
 - 4) “Të analizohen ndikimet e tregtisë ndërkombëtare në barazinë gjinore në lidhje me negociatat tregtare” (PVGJ 14).
 - 5) Të mbështetet ASK-ja në institucionalizimin e mbledhjes së rregullt të statistikave më të mira në lidhje me hendekun gjinor të pagave sipas sektorëve (duke kontribuar në PVGJ 6.1).
 - 6) Të mbështetet qasja e grave në (mikro-) shërbime financiare (PVGJ 15).

- 7) “Të eliminohen barrierat për qasje të barabartë të grave në tregje, shërbime të zhvillimit të sektorit privat, shërbime financiare, ndërmarrësi dhe Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit” (PVGJ 15).
- 8) “Të mbështetet ndërmarrësia femërore, si dhe institucionet për ofrimin e kujdesit që ndihmojnë familjet” (PVGJ 15).

Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- Ligji për komunikimet elektronike²⁰ afirmon parimin e mosdiskriminimit në ofrimin e shërbimeve të komunikimit.
- Strategjia shtetërore për sigurinë kibernetike dhe Plani i veprimit 2016-2019²¹ referon gjininë: në atë që “Siguria kibernetike garantohet duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore, si dhe duke mbrojtur liritë individuale, informatat personale, si dhe identitetin, pa marrë parasysh etninë, gjininë, moshën, fenë”.²² Megjithatë, nuk ka analizë gjinore. Asnjë objektiv, tregues apo përfitues i paraparë nuk ngërthen pikëpamjen gjinore.
- Politikat e sektorit të komunikimeve elektronike - Agjenda digjitale për Kosovën 2013-2020²³ pranon se gratë janë të nënpërfaqësura në të gjitha nivelet në sektorin e TIK-ut dhe thekson se duhet të promovohet pjesëmarrja e grave të reja dhe grave të kthyer në fuqinë punëtore të TIK-ut.
- Ligjet dhe politikat e tjera të zbatueshme për këtë sektor nuk përmbajnë asnjë pikëpamje gjinore: Ligji për shërbimet e shoqërisë informatike,²⁴ Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik²⁵ dhe Strategjia e Kosovës për TI.²⁶

Gjetjet

Vetëm 2.6% e kosovarëve të punësuar punojnë në sektorin e TIK-ut, duke përfshirë 2.6% të të gjithë burrave dhe 2.9% të grave.²⁷ Në vitin 2014, gratë përbënin 22% të të gjithë të punësuarve në kompanitë e TIK-ut. Kërkimet e bëra me vajzat nga shkollat e mesme të Kosovës në vitin 2014 kanë sugjeruar se 68% e vajzave kanë kompjuter personal dhe 84% kanë adresa të postës elektronike.²⁸ Ekzistojnë paragjykime ndaj grave në sektorin e TIK-ut, pasi disa ende e konsiderojnë atë si sektor që është më i përshtatshëm për burrat.²⁹

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: Rritja e përqindjes së personave të përfshirë në sektorin e TIK-ut që janë gra.
 - o Treguesi: Përqindja e punonjësve të TIK-ut që janë gra. *Pikënisja: 22%.*
 - o Veprimet:
 - 1) Të mbështeten programet që i kundërvihen stereotipave gjinorë në lidhje me angazhimin e grave në sektorin e TIK-ut, duke i përfshirë si pjesë të arsimit të hershëm, fillor dhe të mesëm.
 - 2) Të sigurohet që mbështetja për sektorin e TIK-ut përfshin masa afirmative për angazhimin e grave, siç janë kuotat dhe bursat.
 - 3) “Të përmirësohet përballueshmëria dhe përdorimi i teknologjisë, të zgjerohet qasja rurale, dhe t’i jepet shtytje shkathtësive digjitale për gratë” (PVGJ 15).

Bujqësia

Sipas DSI-së, sektori i bujqësisë është burimi kryesor i të ardhurave dhe fusha më e madhe e punësimit në Kosovë.¹ Kjo pjesë ofron analizë gjinore të politikave dhe praktikave bujqësore.

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural² ka për qëllim rritjen e “të ardhurave për popullsinë rurale, duke ngritur mirëqenien e saj nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe të jetesës, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për të gjitha grupet e marginalizuara”.
- Ligji për regjistrimin e bujqësisë³ detyron ASK-në të mbledhë të dhëna të zbërthyera sipas gjinisë për fuqinë punëtore të angazhuar në bujqësi.
- Prioritetet afatmesme të PKZMSA-së përfshijnë stimulimin e fermerëve përmes subvencioneve dhe granteve rurale, duke pasqyruar pikëpamjen gjinore; dhe që planifikimi rural duhet të inkorporojë BPGJ-në.
- Ligjet dhe politikat e tjera relevante nuk përmbajnë pikëpamje gjinore: Ligji për inspektionin bujqësor,⁴ Ligji për pyjet e Kosovës,⁵ Strategjia për konsolidimin e tokës 2010-2020⁶ dhe Strategjia për zhvillimin e pylltarisë 2010-2020.⁷

Gjetjet

Vlerësohet se rreth 5% e të gjithë burrave të punësuar dhe 3% e grave të punësuar janë aktivë në bujqësi, pylltari dhe peshkim.⁸ Mirëpo, këta janë punonjës të regjistruar zyrtarisht. Gratë dhe burrat mund të punojnë si punonjës të paregjistruar në këtë sektor, megjithëse mungojnë të dhënat.⁹

Bizneset e udhëhequra nga gratë marrin më pak licenca për aktivitetet në pylltari. Gjithsej, gratë morën 18% të të gjitha licencave në mes të 2014 dhe marsit 2017.¹⁰ Nga viti 2015 deri në vitin 2017, gratë në vazhdimësi kanë përbërë 1% të përdoruesve të vreshtave.¹¹ Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak se më pak gra aplikojnë për licenca të tilla, gjë që ka të ngjarë lidhet me mungesën e lartpërmendur të qasjes në pronë dhe kapital nga gratë.

MBPZHR-ja ka përdorur masa afirmative për t'u dhënë grave mundësi shtesë për marrjen e subvencioneve.¹² Mirëpo, ka pasur raportime të keqpërdorimit.¹³ Në vitin 2015 dhe 2016, vetëm 2% e të gjithë përfituesve të subvencionimit ishin gra dhe ato morën 32 herë më pak fonde sesa burrat.¹⁴ Një sfidë që kontribuon është se vetëm 5% e të gjithë fermerëve të licencuar janë gra.¹⁵ Ndër sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen gratë që punojnë në sektorin e bujqësisë përfshihen mungesa e arsimit, zotërimi i pronës, qasja në fonde dhe burrat që përdorin emrat e grave të tyre për të siguruar subvencione, ndonëse në praktikë gratë nuk kanë rol vendimmarrës në biznese.¹⁶ Këto çështje gjithashtu parandalojnë gratë që të mund të aplikojnë ose të marrin subvencione.

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: “Qasja e barabartë për gratë në shërbimet financiare, resurset prodhuese, përfshirë tokën, tregtinë dhe ndërmarrësinë” (PVGJ 15).
 - o Treguesit:
 - 1) Numri i “grave që marrin shërbime këshillimore rurale me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 15.6). *Pikënisja: Specifike sipas projektit.*
 - 2) Numri i “grave dhe burrave që kanë siguruar zotërim të tokës me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 15.7). *Pikënisja: Specifike sipas projektit.*
 - 3) Numri i “grave që i qasen shërbimeve (mikro-) financiare në nivel të komunitetit me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 15.8). *Pikënisja: Specifike sipas projektit.*
 - 4) Përqindja e personave që marrin grante bujqësore nga MBPZHR-ja sipas gjinisë. *Pikënisja: 2% gra që marrin grante, 98% burra që marrin grante.*
 - 5) Përqindja e fermerëve të licencuar që janë gra. *Pikënisja: 5%.*

o Veprimet:

- 1) Të mbështetet MBPZHR-ja në hartimin e programeve që: a) përfshijnë pikëpamje gjinore, të tilla si favorizimi i propozimeve që përfshijnë baraspeshë të punonjësve gra dhe burra; b) përmirësojnë shtrirjen e informimit që vë në shënjestër gratë me informacion rreth mundësive; dhe c) ofrojnë subvencione enkas për gratë fermere, si masë afirmative në pajtim me LBGJ-në. Të mbështetet MBPZHR-ja për të përmirësuar sistemet e monitorimit para, gjatë dhe pas subvencioneve për të siguruar që gratë përfitojnë drejtpërsëdrejti nga subvencionet.¹⁷
- 2) Të mbështeten programet për gra për edukim të vazhdueshëm, hartim të planeve të biznesit, mentorim dhe përpilim të aplikacioneve për grante, të cilat mund të mbështesin më shumë gra në përmbushjen e kriterëve bazë për të aplikuar për subvencione bujqësore.
- 3) “Të mbështetet ndërmarrësia femërore si dhe institucionet për ofrimin e kujdesit që ndihmojnë familjet” (PVGJ 15), duke përfshirë qasje unike ndaj kujdesit kolektiv të përballueshëm, të përshtatura enkas për punonjësit bujqësorë.
- 4) Të mbështetet analiza gjinore në bujqësi dhe në ekonominë joformale, në drejtim të identifikimit të ndërhyrjeve praktike për të adresuar ekonominë joformale, duke rritur punën e regjistruar dhe mbrojtjen e punës për gratë dhe burrat që aktualisht punojnë në ekonominë joformale (duke kontribuar në PVGJ 6.1 dhe 14).
- 5) Të mbështetet rritja e zotërimit të pronës midis grave, sipas veprimeve të rekomanduara në pjesën për sundimin e ligjit.

Energjia

Sektori i energjisë është prioritet i financimit të BE-së, pasi qasja në furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të energjisë është veçanërisht e rëndësishme për vendet në zhvillim dhe vendet që kërkojnë të anëtarësohen në BE. Kjo pjesë përfshin analizën gjinore të politikave dhe praktikave të energjisë në Kosovë.

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- Ligji për energjinë¹ përcakton aktivitetet në sektorin e energjisë, duke përfshirë energjinë elektrike, energjinë termike, gazin natyror dhe energjinë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Ky ligj nuk përmban asnjë pikëpamje gjinore.
- PKZMSA-ja parasheh që të gjitha fondet për sektorin e energjisë do të ndahen në atë mënyrë që të “përfitojnë gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në mënyrë të barabartë, duke iu shërbyer nevojave dhe interesave të tyre, dhe buxheti i përgjegjshëm gjinor duhet të zbatohet në të gjitha fazat e dizajnit, planifikimit, [dhe] monitorimit të zbatimit” të projekteve. Tutje, kur përcaktohen kriteret për investime në burimet e ripërtëritshme të energjisë, duhet të merret parasysh përballueshmëria për konsumatorët gra dhe burra.
- ARE-ja thekson se prioritetet për energjinë duhet të zbatohen në përputhje me LBGJ-në.
- Ndër politikat e tjera të zbatueshme përfshihen: Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026,² Strategjia e ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011-2018,³ Plani kombëtar i veprimit për burimet e ripërtëritshme të energjisë 2011-2020,⁴ Plani i veprimit i Kosovës për efikasitet të energjisë në Kosovë 2010-2018⁵ dhe Strategjia minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025,⁶ ku asnjëra nuk përmban as analizë as pikëpamje gjinore.

Gjetjet

Kosova ende nuk ka furnizim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë dhe përballat me disa probleme që lidhen me energjinë e ripërtëritshme.⁷ Dëshmitë nga vendet e tjera sugjerojnë se sfidat e tilla mund të ndikojnë në mënyrë të ndryshme tek gratë dhe burrat. Megjithatë, nuk ekzistojnë mjaft analiza gjinore

dhe të dhëna të besueshme të zbërthyer sipas gjinisë në lidhje me këtë sektor në Kosovë. Kjo përfshin analiza gjinore të pamjaftueshme në lidhje me shfrytëzimin e energjisë. As ndërmarrja publike e ngrohjes, Termokos, as Kompania Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) nuk mban të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë mbi faturat e paguara ose ankesat e pranuar.⁸ Ka tendencë që gratë të jenë të nënpërfaqësuar brenda këtij sektori. Për më tepër, pak gra të reja kanë shfaqur interesim për të ndjekur mundësi arsimimi që do të çonte në vende pune në sektorin e energjisë. Vetëm 18% e studentëve që studionin gjeoshkencat në Universitetin e Mitrovicës në vitin akademik 2015/2016 ishin gra.⁹ Megjithatë, përqindja e grave që ndjekin studimet për Inxhinieri Kompjuterike dhe Elektrike është përmirësuar nga 35% në 2013/2014 në 41% në 2015/2016.¹⁰ Në korrik të vitit 2017 u themelua Shoqata e Grave në Sektorin Energjetik të Kosovës për të fuqizuar gratë në sektorin e energjisë përmes rrjetëzimit, avancimit të karrierës dhe zhvillimit të shkathtësive profesionale.¹¹

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- **Objektivi:** “Vajzat dhe gratë gëzojnë qasje dhe kontroll të barabartë ndaj [...] energjisë [...], dhe angazhim të drejtë në menaxhimin [e saj]” (PVGJ 16).
 - o **Treguesi:**
 - 1) “Pjesa e popullsisë që përdor energji elektrike të besueshme, sipas vendbanimit urban/rural” (SZHQ 7.51, PVGJ 16.6). *Pikënisja: 100% e popullsisë urbane; e padisponueshme për popullsinë rurale.*¹²
 - 2) Numri i “grave të të gjitha moshave që kanë qasje në shërbime të qëndrueshme të energjisë me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 16.8). *Pikënisja: Specifike sipas projektit.*
 - o **Veprimet:**
 - 1) “Të mbështeten politikat publike dhe sistemet e menaxhimit të resurseve natyrore me bazë komunitare që krijojnë mbulim më të madh, qasje më të sigurt dhe vendimmarrje gjithëpërfshirëse për energjinë e qëndrueshme [...] nga gratë e të gjitha moshave” (PVGJ 16).
 - 2) Të sigurohet që përpjekjet për të kompletuar kuadrin legjislativ në fushën e energjisë dhe ndryshimeve klimatike përfshijnë analizat e ndikimit gjinor, shqyrtimin gjinor dhe konsultimet me gra dhe burra të ndryshëm. Të sigurohet që qeveria zbaton politika të konsultimeve publike lidhur me energjinë dhe bashkëpunon me MKBZH-të dhe OGSHC-së për të siguruar pjesëmarrjen e grave dhe vajzave.
 - 3) Të sigurohet se përpjekjet për të përmirësuar kapacitetet institucionale dhe njerëzore në institucionet relevante dhe për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit privat në sektorin e burimeve të ripërtëritshme dhe efikasitetin e energjisë përfshijnë krijimin e vendeve të punës si për gratë ashtu edhe për burrat.
 - 4) Të sigurohet që nga investimet në sektorin e energjisë “përfitojnë gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në mënyrë të barabartë, duke iu shërbyer nevojave dhe interesave të tyre, dhe buxheti i përgjegjshëm gjinor duhet të zbatohet në të gjitha fazat e dizajnit, planifikimit, monitorimit të zbatimit të projektit”, në pajtim PKZMSA-në.
 - 5) Kur përcaktohen kriteret për investime në burimet e ripërtëritshme të energjisë, të merret parasysh përballueshmëria për konsumatorët gra dhe burra, siç parashihet në PKZMSA-në.
 - 6) Të përkrahet institucionalizimi i “sistemeve të monitorimit të vendit për të raportuar me të dhëna të zbërthyer sipas seksit dhe analizë cilësore të gjendjes së [...] energjisë [...] në vend” (PVGJ 16 dhe 6.1). Të mbështeten analizat gjinore të sektorit të energjisë, duke shqyrtuar mënyrat potencialisht të ndryshme në të cilat format e ndryshme të prodhimit të energjisë mund të ndikojnë gratë dhe burrat dhe shëndetin e tyre.

Mjedisi

Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parasheh që “kërkesat për mbrojtjen e mjedisit duhet të integrohen në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit, sidomos me synim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm”.¹ Traktati për Bashkimin Evropian rendit mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit si synim të Bashkimit.² Për t'u bashkuar me BE-në, Kosova duhet të bëjë përparim substancial drejt përmirësimit të mbrojtjes së mjedisit dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike. Kjo pjesë ofron analizë gjinore të sektorit të mjedisit në Kosovë.

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- Direktiva për vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private në mjedis nuk përmban referencë për barazi gjinore.³ Direktiva është transpozuar pjesërisht në ligjin kosovar.
- Direktiva që parasheh pjesëmarrjen e publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara që kanë të bëjnë me mjedisin⁴ synon të kontribuojë “në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Aarhus-it, në veçanti duke paraparë: (a) pjesëmarrjen e publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara lidhur me mjedisin; (b) përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut”. Në të nuk përmenden shprehimisht gratë dhe burrat. Direktiva është transpozuar pjesërisht në ligjin kosovar.⁵
- Ligji për mbeturina⁶ përmend gjininë një herë, duke thënë se shprehjet e përdorura në Ligj lidhur me një gjini përfshijnë edhe gjinitë e tjera.
- Strategjia për ndryshimet klimatike për Kosovën përfshin pikëpamje gjinore vetëm në kuadër të Strategjisë kombëtare të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, me të cilën synohet “sjellja e mekanizmave të ri dhe përmirësimi i atyre aktualë për zvogëlim të riskut nga fatkeqësitë, veçanërisht për sektorët me rëndësi ekonomike që janë posaçërisht të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike, dhe zgjerimi i kapacitetit të përshtatjes të komuniteteve të ndjeshme, siç janë veçanërisht fermerët e varfër, grupet e marginalizuara dhe gratë, për trajtimin e ndikimeve klimatike dhe riskut përkatës për jetën dhe mjetet e jetesës së tyre”.⁷
- Dokumenti i Strategjisë shtetërore të ujërave në Kosovë 2017-2036 përfshin të dhëna demografike të cilat janë të zërthyera për nga gjinia dhe përkatësia etnike.⁸ Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim është e obliguar të sigurojë se tarifat e shërbimit që u ngarkohen konsumatorëve janë të drejta dhe nuk imponohet ndonjë diskriminim, dhe se çështjet gjinore dhe ato të minoriteteve trajtohen në pajtim me ligjin.
- Politikat e tjera të zbatueshme si Strategjia mjedisore e Kosovës 2011-2015⁹ dhe Strategjia mjedisore e Kosovës 2013-2022¹⁰ nuk përmbajnë pikëpamje gjinore. Nuk ka analizë të ndikimit gjinor për asnjë prej sektorëve të adresuar brenda tyre.¹¹
- Ndër ligjet e tjera relevant që janë të zbatueshme dhe nuk kanë pikëpamje gjinore përfshihen: Ligji për mbrojtjen e mjedisit,¹² Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis,¹³ Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor,¹⁴ Ligji për Inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit,¹⁵ Ligji për mbrojtjen e natyrës,¹⁶ Ligji për kimikate¹⁷ dhe Ligji për ujërat e Kosovës.¹⁸

Gjetjet

Gratë janë të nënpërfaqësura në radhët e punonjësve në MMPH, ku përbëjnë më pak se 38% të të gjithë të punësuarve; ato gjithashtu janë të nënpërfaqësura në nivelin e vendimmarrjes (22%).¹⁹ MMPH-ja nuk ka analizë të duhur gjinore të programeve, projekteve, aktiviteteve dhe politikave të brendshme.²⁰ Megjithatë, është ndërmarrë një analizë e ndryshimeve klimatike dhe riskut të fatkeqësive sipas gjinisë.²¹ Nuk ka pasur ngritje të mjaftueshme të kapaciteteve lidhur me aspektet gjinore të ndikimit në mjedis.²² MMPH-ja nuk organizon konsultime të mjaftueshme publike; kur ato organizohen, tendenca është që gratë të jenë të nënpërfaqësura.²³

Uji dhe shërbimet sanitare

Shumica e kosovarëve kanë qasje në ujë të pijshëm, edhe pse të dhënat nuk janë të zbërthyer sipas vendndodhjes rurale dhe urbane.²⁴ Analiza gjinore lidhur me sektorin e ujit në Kosovë është shumë e kufizuar, dhe të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë janë kryesisht të padisponueshme. Për shembull, kompania e ujësjellësit “Ujësjellësi Rajonal Prishtina” nuk mban të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë për konsumatorët që paguajnë faturat apo për ankesat e pranuar.²⁵ Në të njëjtën kompani, vetëm 13% e 530 punonjësve janë gra.²⁶ Strategjia shtetërore e ujërave në Kosovë 2015-2034 nuk përmban pikëpamje gjinore, tregues konkretë gjinorë për të matur zbatimin e saj ose masën e ndikimit të saj në mirëqenien e burrave dhe grave.²⁷ Tutje, Raporti i gjendjes së ujërave, i publikuar nga MMPH-ja dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) në vitin 2010, nuk përmban analizë gjinore dhe nuk ka të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë.²⁸ Kosova ka fare pak impiante për trajtimin e ujërave të zeza, dhe menaxhimi i gabuar i ujërave të zeza ka shkaktuar shqetësime shëndetësore, si për shembull gratë dhe fëmijët e tyre rrugës për në shkollë duhet të ecin nëpër ujërat e zeza.²⁹

Menaxhimi i mbeturinave

“Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022” nuk ka pikëpamje gjinore. Aty mungon kuadri logjik që merr parasysh aspektin gjinor dhe planet për analizë të ndikimit gjinor. Gratë përbëjnë vetëm 8 nga 43 ekspertë të cilët kontribuuan në strategji.³⁰ Nuk ishte përfshirë asnjë ekspert gjinor. Tutje, raporti shtetëror për mbeturinat dhe kimikatet, i botuar nga AMMK-ja dhe MMPH-ja në 2014, nuk ka statistika dhe tregues të zbërthyer sipas gjinisë dhe nuk përmban analizë të ndikimit gjinor.³¹

Gratë janë të nënpërfaqësuar në sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Për shembull, në ndërmarrjen publike regjionale të mbeturinave “Pastrimi”, vetëm 7% e 558 punonjësve janë gra.³² Ka segregacion gjinor të profesioneve pasi tendenca është që burrat të punojnë në pozita operative/teknike dhe gratë në administratë.³³ Kompania përcjell ankesat e konsumatorëve dhe i mban këto të dhëna në një regjistër fizik të zbërthyer sipas gjinisë.³⁴

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- **Objektivi:** “Vajzat dhe gratë gëzojnë qasje dhe kontroll të barabartë ndaj ujit të pastër, energjisë, infrastrukturës së transportit, dhe angazhim të drejtë në menaxhimin e tyre” (PVGJ 16).
 - o **Treguesit:**
 - 1) “Përpjesa e popullsisë që përdor burim të përmirësuar të ujit të pijshëm” (KRBE, PVGJ 16.1). *Pikënisja: Rreth 67% e popullatës furnizohet me ujë të pijshëm përmes sistemeve publike, të menaxhuara nga kompanitë rajonale të ujit, dhe rreth 29% furnizohen nga sistemet vetjake që nuk menaxhohen nga kompanitë rajonale të ujit; 0.7% e popullatës nuk ka qasje në sistemin e ujësjellësit.*³⁵
 - 2) “% e popullsisë që përdor shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt, sipas vendbanimit urban/rural” (SZHQ 6.46, PVGJ 16.4). *Pikënisja: E padisponueshme*
 - o **Veprimet:**
 - 1) “Të mbështeten politikat publike dhe sistemet e menaxhimit të resurseve natyrore me bazë komunitare që krijojnë mbulim më të madh, qasje më të sigurt dhe vendimmarrje gjithëpërfshirëse për [...] ujin [dhe mjedisin] nga gratë e të gjitha moshave” (PVGJ 16).
 - 2) Të përkrahet institucionalizimi i “sistemeve të monitorimit të vendit për të raportuar me të dhëna të zbërthyer sipas seksit dhe analizë cilësore të gjendjes së ujit dhe shërbimeve sanitare [...] në vend” (PVGJ 16, 6.1). Në pajtim me LBGJ-në, të bashkëpunohet ngushtë me ABGJ-në, ASK-në, MMPH-në dhe Sida-n për të mbështetur përmirësimin e disponueshmërisë së statistikave gjinore përkthazi me sektorin e mjedisit, duke përfshirë ndikimin e degradimit mjedisor dhe ndryshimeve klimatike te burrat dhe gratë në Kosovë.³⁶
- **Objektivi:** “Gratë gëzojnë të drejta të barabarta për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në proceset vendimmarrëse për çështjet klimatike dhe mjedisore (PVGJ 20).
 - o **Treguesit:**
 - 1) Përqindja e punonjësve të MMPH-së që janë gra. *Pikënisja: 38%*
 - 2) Përqindja e punonjësve të MMPH-së në nivelet vendimmarrëse që janë gra. *Pikënisja: 22%*

- 3) Personat pjesëmarrës në konsultimet publike lidhur me politikat dhe prioritetet e investimeve mjedisore, sipas gjinisë (duke mbështetur PVGJ 17.7 lidhur me BPGJ-në).
Pikënisja: 13%.³⁷
- o Veprimet:
 - 1) Të inkurajohet fuqishëm MMPH-ja që të zbatojë masa afirmative, siç parashihet me LBGJ, për rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe emërimin e grave për të punuar brenda Ministrisë në pozita politike dhe të shërbimit civil.
 - 2) Të sigurohet që qeveria të zbatojë politika të konsultimeve publike lidhur me mjedisin dhe të bashkëpunon me MKBZH-të dhe OGSHC-së për të siguruar pjesëmarrjen e grave dhe vajzave.
 - 3) “Të rritet rimbëkëmbshmëria e vajzave dhe grave në ballafaqim me ndryshimet klimatike dhe mjedisore dhe të mbështeten ato si faktorë të mbrojtjes mjedisore” (PVGJ 20).
 - 4) “Të studiohet ndikimi i diferencuar i ndryshimeve klimatike mbi popullsinë mashkullore dhe femërore të të gjitha moshave, për të qenë në gjendje për të dizajnuar politika publike që i përgjigjen nevojave reale të burrave dhe grave” (PVGJ 20, 6.1).

Transporti

Sipas DSI-së, IPA II do të mbështesë vetëm “ndërrhyrjet që kanë për qëllim lidhjen e Kosovës me fqinjët e saj. Asistenca do të kanalizohet përmes ndërhyrjeve rajonale, në veçanti në sektorin hekurudhor, përmes koordinimit të KIBP-së [Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor]”. Prandaj, analiza gjinore në këtë pjesë fokusohet te hekurudhat, ndonëse gratë në veçanti përballen me disa sfida të tjera që lidhen me qasjen në transport.¹

Ligji përkatës dhe i zbatueshëm dhe politika nga pikëpamja gjinore

- Strategjia sektoriale dhe e transportit multimodal 2015-2025 dhe Plan i veprimit 5 vjeçar² synon të krijojë një sistem transporti të sigurt dhe funksional. Ka vetëm një referencë për gratë: “Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së transportit dhe i shërbimeve e, me këtë, edhe ngritja e zhvillimit ekonomik, siguria e lëvizjes së lirë për të gjitha komunitetet, qasja në siguri dhe sistemet e sigurisë dhe të sigurohet që shërbimet e transportit publik të janë në dispozicion për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke adresuar në veçanti nevojat e grave dhe pakicave”. Asnjë nga synimet, treguesit apo përfituesit në Strategji nuk i referohen gjinisë. Në të nuk specifikohen nevojat e grave dhe burrave.
- Transporti është i rregulluar kryesisht nga Ligji për hekurudhat e Kosovës,³ Ligji për aviacionin civil,⁴ Ligji për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror,⁵ Ligji për transportin rrugor,⁶ Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor,⁷ Ligji për rregullat e trafikut rrugor,⁸ dhe Strategjia e sigurisë rrugore dhe Plani i veprimit në Kosovë.⁹ Asnjë nga këto ligje nuk përmban pikëpamje gjinore.

Gjetjet

Gratë janë të nënpërfaqësuar në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës dhe në Infrakos dhe Trainkos, dy kompanitë kryesore hekurudhore, veçanërisht në nivelet vendimmarrëse dhe profesionale. Vetëm 19 nga 325 punonjës në Infrakos aktualisht janë gra (0.04%). Në përgjithësi, pakicat janë të nënpërfaqësuar në Infrakos, veçanërisht gratë. Gratë punojnë kryesisht në administratë.¹⁰ Nënpërfaqësimi i grave mbase mund t’i atribuohet segregacionit të profesioneve, ku disa profesione ende perceptohen si më të përshtatshme për burrat dhe të tjerat më të përshtatshme për gratë. Faktorë të tjerë kontribues mund të jenë pjesëmarrja e ulët e grave në fushat universitare dhe aftësimin profesional relevant për këtë sektor; qendrat e pamjaftueshme të kujdesit të përballueshëm; dhe njohuritë e dobëta të punëdhënësve të sektorit hekurudhor për masat afirmative të parapara me LBGJ.¹¹ Sidoqoftë, është e nevojshme analiza gjinore e mëtejshme sasiore dhe cilësore e sektorit të transportit dhe hekurudhave

për të kuptuar më mirë pabarazitë gjinore. Infrakos po përpqet të përfshijë aspektet gjinore në operacionet e veta.¹²

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- Objektivi: “Vajzat dhe gratë gëzojnë qasje dhe kontroll të barabartë ndaj [...] infrastrukturës së transportit, dhe angazhim të drejtë në menaxhimin [e saj]” (PVGJ 16).
 - o Treguesit:
 - 1) Përqindja e grave dhe burrave të përfshirë në diskutimet publike që kanë të bëjnë me sistemet e transportit. *Pikënisja: Nuk ka informacion*
 - 2) Masa në të cilën transporti publik i plotëson nevojat specifike të grave, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. *Pikënisja: e kufizuar*³
 - o Veprimet:
 - 1) “Të mbështeten politikat publike [...] që krijojnë mbulim më të madh, qasje më të sigurt dhe vendimmarrje gjithëpërfshirëse për infrastrukturën [e transportit] nga gratë e të gjitha moshave” (PVGJ 16).
 - 2) Të sigurohet që qeveria të zbatojë politika të konsultimeve publike lidhur me transportin, në bashkëpunim me MKBZH-të dhe OGSHC-së për të siguruar pjesëmarrjen e grave.
 - 3) “Të mbështetet zhvillimi i infrastrukturës me mjete të sigurta, të përballueshme dhe të qasshme të transportit publik për gratë e të gjitha moshave”, duke përfshirë konsiderata të veçanta për personat me aftësi të kufizuara (PVGJ 16).
 - 4) Të përkrahet institucionalizimi i “sistemeve të monitorimit të vendit për të raportuar me të dhëna të zbërthyer sipas seksit dhe analizë cilësore të gjendjes së infrastrukturës së [transportit] në vend” (PVGJ 16 dhe 6.1).
 - 5) Të mbështeten analiza të mëtejshme gjinore të sektorit të transportit në lidhje me programimin e ardhshëm.

Shëndetësia

Legjislacioni përkatës dhe i zbatueshëm nga pikëpamja gjinore

- CEDAW dhe Rekomandimi i Përgjithshëm 24 i Komitetit CEDAW¹ parasheh që shtetet nënshkruese “marrin masa të duhura për të mënjeluar diskriminimin ndaj grave në lëmin e kujdesit shëndetësor mbi baza të barazisë së burrave dhe grave, sigurojnë qasjen në shërbime mjekësore, duke përfshirë qasjet që kanë të bëjnë me planifikimin e familjes”.
- Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian obligon që të sigurohet nivel i lartë i mbrojtjes së shëndetit publik gjatë përcaktimit dhe zbatimit të të gjitha politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit.²
- Kushtetuta thotë se kujdesi shëndetësor rregullohet me ligj.³
- Ligji mbi shëndetësi⁴ përfshin barazinë, gjithëpërfshirjen dhe jodiskriminimin midis parimeve të tij. Ai parasheh “standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përmbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurim të kujdesit shëndetësor pa diskriminim”, në bazë të gjinisë apo orientimit seksual, ndër të tjera.
- Ligji për Shëndetin Mendor⁵ parasheh trajtim të barabartë dhe trajtim pa diskriminim të personave me çrregullime mendore në parimet e tij udhëheqëse.
- Ligji për sigurimin shëndetësor⁶ parasheh që shërbimet shëndetësore të ofrohen në baza të barabarta për të gjithë personat e siguruar. Pavarësisht nga statusi i sigurimit, fëmijët mund të kenë qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor nga lista e shërbimeve themelore, dhe gratë shtatzëna ose lehonat gëzojnë të drejtën për shërbimet e kujdesit shëndetësor esencial.
- Ligji për shëndetin riprodhues⁷ rregullon të gjitha aktivitetet në fushën e shëndetit riprodhues dhe mbron të drejtat riprodhuese të individëve duke mbuluar një spektër të gjerë çështjesh, duke

përfshirë infeksionet seksualisht të transmetueshme, planifikimin e familjes, qasjen në informata, riprodhimin e asistuar dhe amësinë e sigurt.

- Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë⁸ vendos bazën ligjore për rregullimin e ndërprerjes së shtatzënisë në rastet e parapara me Ligj. Kur jeta ose shëndeti i gruas është në rrezik për shkak të shtatzënisë, ose në rastet e anomalisë fatale të fetusit, aborti është në dispozicion në çdo fazë të shtatzënisë. Aborti mund të bëhet deri në 22 javë nëse shtatzënia është rezultat i përdhunimit, për viktimat e trafikimit dhe shfrytëzimit të detyruar seksual, dhe në rastet e marrëdhënieve seksuale me të mitur ose incestit. Ndërprerja elektive është e lejuar për gratë mbi moshën 18 vjeç (dhe adoleshentet 16-18 vjeç me pëlqimin e prindërve) deri në 10 javë nga dita e parë e ciklit të tyre të fundit menstrual. Abortet selektive me motiv të përzgjedhjes se gjinisë së frytit janë të ndaluara si me ligjin për abortin ashtu edhe me Ligjin për shëndetin Riprodhues.
- Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2017-2021 është zhvilluar për të siguruar reformat në këtë sektor.⁹ Ndonëse strategjia mbulon brez të gjerë çështjesh, pikëpamja gjinore është përfshirë vetëm te shqyrtimi i disa sëmundjeve dhe në lidhje me lindjen e fëmijëve. Strategjia nuk ka përfshirë të mjaftueshme të aspektit gjinor.
- Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 përmban aktivitete specifike për nga gjinia për përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës të grave dhe vajzave romë dhe ashkalie.¹⁰ Këto përfshijnë depistimin për kancer gjiri, realizimin e vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë dhe shpërndarjen e materialit informues për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues.

Gjetjet

Në përgjithësi, më shumë gra janë të punësuar në institucionet shëndetësore në krahasim me burrat, me diferencë prej 18%.¹¹ Pesë prej nëntë institucioneve shëndetësore kanë më shumë gra në radhët e punonjësve. Disa institucione si Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës dhe Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut kanë pothuajse dy gra, në çdo burrë që punon atje.¹² Dallimi më i madh midis punonjësve burra dhe gra është në Departamentin shëndetësor të burgjeve, ku burrat janë të punësuar me një shkallë 44% më të lartë sesa gratë. Nuk ka të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë për profesionet brenda institucioneve shëndetësore. Prandaj, çdo dallim në pozita apo paga midis grave dhe burrave është i panjohur.

Qasja në kujdesin shëndetësor mund të dallojë për gratë dhe burrat, duke përfshirë edhe ndryshimet në bazë të përkatësisë etnike dhe vendndodhjes gjeografike.¹³ Dallimet në qasje mund t'i atribuohen pjesërisht barrierave gjinore dhe socio-kulturore, siç janë përgjegjësitë e grave për ofrim të kujdesit. Për shembull, në mesin e grave që nuk kishin konsultuar mjekun kur ato kishin nevojë në vitin e kaluar, 12% thanë se arsyeja kryesore ishte se nuk kishin kohë "për shkak të punës, kujdesit për fëmijët apo për të tjerët".¹⁴ Barrierat socio-kulturore mund të ndërlidhen me barrierat financiare. Shkallët e larta të lartpërmendura të papunësisë në mesin e grave mund të nënkuptojnë se ato nuk kanë të ardhura vetanake për të paguar për kujdesin shëndetësor. Në përafërsisht një të tretën e familjeve në Kosovë, burrat janë vendimmarrësit kryesorë për financat familjare, gjë që gjithashtu mund të pengojë qasjen e grave në kujdes shëndetësor.¹⁵ Për më tepër, gratë kanë më shumë gjasa sesa burrat ta konsiderojnë problem ofruesin e kujdesit shëndetësor të gjinisë tjetër; 24% e grave e konsiderojnë këtë si problem që kufizon qasjen e tyre në kujdesin shëndetësor, krahasuar me 18% të burrave. Këto pikëpamje janë më të përhapura në zonat rurale sesa në ato urbane,¹⁶ dhe mund të parandalojnë gratë për të kërkuar kujdes shëndetësor nëse ofruesit e kujdesit shëndetësor që janë gra nuk janë në dispozicion në viset e tyre.

Ekzistojnë dallime në shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore në bazë të përkatësisë etnike dhe gjinisë. Serbët dhe goranët kanë tendencë të shfrytëzojnë shumicën e shërbimeve, ndërsa shqiptarët dhe boshnjakët i shfrytëzojnë më së paku. Burrat goranë shfrytëzojnë më shumë shërbime sesa gratë gorane. Gratë shqiptare dhe turke shfrytëzojnë më shumë shërbime sesa burrat e të njëjtës përkatësi etnike. Në këtë drejtim nuk ekzistojnë dallime të konsiderueshme në mes të grave dhe burrave romë, ashkali dhe egjiptianë.¹⁷ Disa nga nënat romë, ashkalie dhe egjiptiane lindin në shtëpi, shpesh në kushte josanitare.¹⁸ Si rezultat, shumë fëmijë nuk janë të regjistruar nga shteti. Kjo ndikon në qasjen në kujdesin shëndetësor

më vonë në jetë, pasi personat e paregjistruar nuk mund të marrin asistencë sociale ose të kenë qasje në shërbimet shëndetësore publike.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë për shfrytëzimin e shërbimeve specifike të kujdesit shëndetësor tregojnë se shumë shërbime janë të nënshfrytëzuara, siç janë shërbimet e depistimit për kancer dhe sëmundje kronike. Shërbimet dentare dhe analizat laboratorike janë shërbimet më të shfrytëzuara nga burrat dhe gratë. Mospërputhja mes shkallës së lartë të shfrytëzimit të shërbimeve gjinekologjike dhe shkallës së ulët të depistimit për kancer të qafës së mitrës sugjeron që vizitat gjinekologjike mund të mos jenë efikase apo të plota, ose që gratë nuk dijnë se Pap testi nënkupton depistim për kancer të qafës së mitrës.¹⁹

Përkundër faktit se 18% e kosovarëve kanë raportuar se vuajnë nga një sëmundje kronike, vetëm 16% e grave dhe 12% e të gjithë burrave kishin kërkuar trajtim, dhe një numër konsiderueshëm më i vogël i tyre kishin marrë trajtim më shumë se një herë në vit. Së këndejmi, njerëzit mbase nuk janë duke marrë trajtimin e nevojshëm.²⁰ Gratë shfrytëzojnë shërbime të caktuara më shumë se burrat, siç janë shërbimet dentare dhe shërbimet për sëmundjet kronike. Burrat kryejnë ekzaminime të përgjithshme shëndetësore pak më shpesh sesa gratë, dhe bëjnë analiza laboratorike shumë më shpesh sesa gratë.

Është e vështirë të mblidhet informacion rreth aborteve, sepse gratë mund të mos duan të ndajnë përvojat e tyre për shkak të stigmës sociale, frikës dhe turpit. Ndër gratë që raportuan se kishin pasur një ose më shumë aborte, shumica kishin përdorur klinikë publike. Abortet e vetë-indukuara fizikisht gjithashtu ndodhin; kjo mund të jetë për shkak të kufizimit 10-javor të aborteve ose ngurrimit të grave të reja për të siguruar pëlqimin e prindërve, megjithëse nuk ekziston korrelacion i qartë.²¹ Ndërsa 4% e grave që kishin abortuar thanë se përdorën pilulë, mjekët dhe farmacistët besojnë se pilulat e tilla përdoren më gjerësisht në Kosovë. Ndonëse janë të paligjshme dhe rrallë shpalosen, statistikatat e popullsisë sugjerojnë se abortet selektive sipas seksit ende ndodhin; raporti sipas seksit në lindje është 110 djem me 100 vajza, që është një dallim më i madh sesa mesatarja botërore.²²

Të dhënat mbi shpenzimet e kujdesit shëndetësor tregojnë se gratë dhe burrat në përgjithësi shpenzojnë pothuajse shumë të njëjtë për shërbime shëndetësore.²³ Gratë shpenzojnë më shumë në kujdesin e përgjithshëm shëndetësor sesa burrat, ndërsa burrat shpenzojnë më shumë në prodhime farmaceutike. Shumë njerëz përcaktohen të presin për të parë nëse gjendja e tyre përmirësohet në vend se të paguajnë për shërbime shëndetësore.²⁴ Sigurimi shëndetësor publik hëpërhë nuk është i disponueshëm në Kosovë, dhe vetëm 6% e kosovarëve kanë sigurim privat.²⁵ Kjo sugjeron që shpenzimet e kujdesit shëndetësor dalin nga xhepi i pacientëve, dhe njerëzit më të pasur mund të kenë mundësinë për të paguar për më shumë shërbime. Dy të tretat e personave me sigurim shëndetësor privat ishin burra dhe një e treta ishin gra. Ndërsa gjysma e të siguruarve privatisht jetonin në zonat urbane dhe gjysma në zonat rurale, burrat përbënin 80% të të siguruarve në zonat rurale.

Megjithëse paksa më shumë burra (66%) sesa gra (62%) deklaruan se ka gjasa që do të merrnin barna pa përshkrim nga mjeku, në të vërtetë, gratë (17%) përdorin rregullisht medikamente pa përshkrim nga mjeku më shumë sesa burrat (12%).²⁶ Medikamentet që me sa duket keqpërdoren pa përshkrim nga mjeku janë kontraktivët, Misoprostoli (për aborte), antibiotikët, antidepresantët, Trodoni (një lloj opiat) dhe qetësuesit. Me sa duket, gratë kanë në mënyrë të konsiderueshme më shumë gjasa për të pranuar përdorimin e qetësuesve për të lehtësuar ankthin dhe stresin sesa burrat. Megjithatë, gratë mund të jenë më të gatshme të flasin në krahasim me burrat për shkak të roleve gjinore të përcaktuara dhe maskulinitetit të rrënjësor, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin mendor të burrave dhe të kontribuojnë në shkallën më të lartë të lartpërmendur të vetëvrasjes midis burrave. Si burrat ashtu edhe gratë, përdorin medikamente pa përshkrim nga mjeku për shkak të stigmës rreth shëndetit mendor dhe çështjeve të konfidencialitetit. Ndonëse numri i institucioneve të kujdesit shëndetësor mendor është rritur gjatë viteve të fundit, fakti që ka pak klinika të specializuara mund të kontribuojë që njerëzit të vetë-trajtohen në vend se të kërkojnë ndihmë. Pjesa më e madhe e grave dhe burrave në Kosovë e perceptojnë gjendjen e tyre shëndetësore si të mirë apo shumë të mirë, por gratë mesatarisht vlerësojnë gjendjen e tyre shëndetësore si pak më të keqe se burrat.²⁷

Sa i përket informacionit lidhur me kontraktivët, shumica e njerëzve përdorin internetin, ndërsa gratë mbështeten në spitalet publike, qendrat e maternitetit dhe partnerët e tyre.²⁸ Me sa duket pak njerëz mësojnë rreth përdorimit të kontraktivëve në shkollë, dhe thuhet se mësimdhënësit rregullisht

e anashkalojnë edukatën e shëndetit riprodhues pa e ligjëruar fare.²⁹ Kjo mund të kontribuojë në informacione të pasakta. Njohuritë e kufizuara rreth kontraceptivëve mund të ndikojnë në shkallën e abortit ose në rritjen e riskut nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme. Disa ofrues profesionistë të kujdesit shëndetësor nga spitalet, qendrat shëndetësore dhe klinikat japin informacion të pasaktë mbi kontraceptivët.³⁰

Pjesa më e madhe e kosovarëve seksualisht aktivë (64%) nuk përdorin metodat kontraceptive.³¹ Ndër ata që e bëjnë këtë, metoda më e popullarizuar si për gratë ashtu edhe për burrat janë kondomët, të cilët në krahasim me metodat tjera janë më të lirë dhe më të qasshëm. Pilula, kondomi femëror dhe spiralja intrauterine (IUD) përdoren gjerësisht në radhët e grave, ndonëse mund të jetë më e vështirë që të sigurohen.

Objektivat, treguesit dhe veprimet e mundshme

- **Objektivi:** “Qasja e barabartë në shërbime të kujdesit shëndetësor cilësor fizik dhe mendor, parandalues, shërues dhe rehabilitues për vajzat dhe gratë” (PVGJ 10).
 - o **Treguesit:**
 - 1) Qasja e përmirësuar në kujdes shëndetësor për gratë dhe burrat e të gjitha përkatësive etnike, siç tregohet nga indeksi i qasshmërisë, zbërthyer sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe vendndodhjes rurale/urbane. *Pikënisja: Shih RrGK, Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë.*
 - 2) “Përpjesa e personave me çrregullim të rëndë mendor (psikozë, çrregullim afektiv bipolar ose depresion mesatar-i rëndë) që shfrytëzojnë shërbimet” (SZHQ 3.28, PVGJ 10.2). *Pikënisja: E panjohur*
 - o **Veprimet:**
 - 1) Të mbështeten fushatat për ngritje të vetëdijes midis grave dhe burrave lidhur me rëndësinë e kujdesit parandalues, kontraceptivëve të ndryshëm dhe për të përgënjeshtuar mitet lidhur me trajtimin e çështjeve të shëndetit mendor.
 - 2) Të mbështetet përmirësimi i disponueshmërisë së shërbimeve të përballueshme dhe cilësore të kujdesit shëndetësor që sigurojnë konfidencialitet për pacientët.
 - 3) Të mbështeten institucionet shëndetësore në institucionalizimin e trajnimit adekuat për punëtorët e kujdesit shëndetësor dhe ofruesit e shërbimeve të inspektimit të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë barnatoret.
 - 4) Të ofrohen shtysa politike, mbështetje teknike dhe inkurajim për qeverinë për të krijuar dhe zbatuar planet për sigurimin shëndetësor.
 - 5) “Të mbështetet zgjerimi i mbulimit kombëtar dhe qasjes nga gratë e të gjitha moshave në të gjitha llojet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, duke i kushtuar vëmendje diskriminimit të shumëfishtë, p.sh. për nga moshën, përkatësia etnike, feja, vendbanimi rural/urban, etj.” (PVGJ 10).
 - 6) “Të mbështetet heqja e të gjitha barrierave që kufizojnë qasjen në shërbime cilësore dhe të përballueshme të kujdesit shëndetësor për të gjithë” (PVGJ 10).
- **Objektivi:** “Promovimi, mbrojtja dhe përmbushja e të drejtës së çdo individi për të pasur kontroll të plotë, dhe për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi, mbi çështjet që kanë të bëjnë me seksualitetin dhe shëndetin seksual dhe riprodhues, pa diskriminim, shtrëngim dhe dhunë” (PVGJ 11).
 - o **Treguesit:**
 - 1) Përqindja “e grave me depistim të kancerit të qafës së mitrës” (SZHQ 3.17, PVGJ 11.3). *Pikënisja: vlerësohet 23% ndonjëherë gjatë jetës së tyre.*³²
 - 2) “Është përmbushur kërkesa për planifikimin e familjes” (SZHQ 5.44, PVGJ 11.4). *Pikënisja: Nuk është përmbushur kërkesa, duke pasur parasysh se 64% e kosovarëve seksualisht aktivë nuk përdorin kontraceptivë.*
 - 3) Përqindja “e të rinjve që marrin edukim gjithëpërfshirës seksual” (SZHQ 5.5, PVGJ 11.5). *Pikënisja: e panjohur*
 - 4) Numri “i grave që përdorin ndonjë metodë kontracepcioni me mbështetjen e BE-së” (KRBE, PVGJ 11.7). *Pikënisja: Relevante sipas projektit*

- 5) Raporti i seksit në lindje. *Pikënisja: 110 djem ndaj 100 vajza*
- o Veprimet:
- 1) Të mbështeten fushatat për ngritje të vetëdijes, duke vënë në shënjestër veçanërisht gratë në zonat rurale, për t'u shpjeguar sistemin e kujdesit shëndetësor dhe ku mund të qasen në llojet e ndryshme të kujdesit; për të përmirësuar njohuritë për depistimin e kancerit të qafës së mitrës dhe format tjera të kujdesit parandalues; dhe për të ofruar edukim për kontraceptivët.
 - 2) “Të mbështetet qasja universale në shërbime cilësore, të përballueshme dhe gjithëpërfshirëse të kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues” (PVGJ 11) duke mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë në institucionalizimin e trajnimit më të mirë, të detyrueshëm për punonjësit shëndetësorë për shëndetin seksual dhe riprodhues, duke përfshirë konfidencialitetin dhe abortin selektiv sipas seksit.
 - 3) Të mbështetet MASHT-i për të trajnuar më tej mësimdhënësit në metodat e mësimdhënies të edukimit për shëndetin riprodhues (duke përfshirë kontraceptivët) dhe për t'u angazhuar me administratorët dhe inspektorët për të siguruar që mësimdhënësit e ligjërojnë këtë pjesë të kurrikulës.
 - 4) Të mbështetet Ministria e Shëndetësisë në përmirësimin e inspektimeve të të gjitha institucioneve dhe punëtorëve shëndetësorë, privatë dhe publikë, duke përfshirë barnatoret dhe klinikat që ofrojnë aborte, duke siguruar konfidencialitet dhe kujdes për klientët.

Punimet e cituara

Ligji

Marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e OKB-së, në:

<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>

Këshilli i Sigurimit i OKB-së, Rezoluta 1325, 2000, në: <http://awenetwork.org/wp-content/uploads/2017/02/REZOLUTA-1325-GRUAJA-PAQJA-DHE-SIGURIA.pdf>

Konventa e KE-së për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf

Konventa e KE-së për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), në: <https://rm.coe.int/168046246b>

Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Poshtëruese, 1984, në:

<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConAgainstTortureOtherCruellhuman.pdf>

Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës, 1990, në:

https://www.unicef.org/magic/media/documents/CRC_albanian_language_version.pdf

Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW), 1981, në:

<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConEliminationAllFormsDiscriminationAgainstWomen.pdf>

Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 1965, në:

<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConEliminationRacialDiscrimination.pdf>

Konventa Kuadër e KE-së për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995, në:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016800c131a>

Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në njëren anë, dhe Kosovës*, në anën tjetër, 2 tetor 2015 (OR. ang) 10728/1/15 REV I LIMITE COWEB 69, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo-EU_SAA_Final_L.pdf

Synimet e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm, 17 Synime për ta Transformuar Botën tonë, në:

www.un.org/sustainabledevelopment/education/

Traktatet dhe Direktivat e Bashkimit Evropian (sipas vitit)

Direktiva 2000/43/KE që zbaton parimin e trajtimit të barabartë midis personave pavarësisht nga origjina racore ose etnike, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32000L0043&from=en>

Direktiva 2000/78/KE datë 27 nëntor 2000 për krijimin e kuadrit të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion

Direktiva 2003/35/KE që parasheh pjesëmarrjen e publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara që kanë të bëjnë me mjedisin, dhe që bën ndryshime sa i përket pjesëmarrjes së publikut dhe qasjes në drejtësi në Direktivat e Këshillit 85/337/KEE dhe 96/61/KE, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32003L0035>

Direktiva 2004/113/KE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime, në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004L0113&from=EN>

Direktiva 2004/81/KEE për lejen e qëndrimit që i lëshohet shtetasve të vendeve të treta që janë viktimë të trafikimit me njerëz ose që kanë qenë subjekt i veprimit për të lehtësuar migracionin e paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004L0081&from=EN>

Direktiva 2006/54/KE për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (e rimodeluar), 2006, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32006L0054&from=EN>

Direktiva 2010/18/BE që zbaton Marrëveshjen Kuadër për pushimin prindëror, e rishikuar, që shfuqizon Direktivën 96/34/KE

Direktiva 2010/41/BE për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të angazhuar në një aktivitet në cilësi të vetë-punësimit, dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 86/613/KEE, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32010L0041>

Direktiva 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/DPB, në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2011:L01:0001:0011:EN:PDF>

Direktiva 2011/92/BE për vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private në mjedis, në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2012:026:0001:0021:En:PDF>

Direktiva 2011/92/BE që ndryshon Direktivën 2011/92/BE për vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private në mjedis (Tekst relevant për ZEE-në), në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0052&from=EN>

Direktiva 2012/29/BE që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/DPB, në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32012L0029&from=en>

Direktiva 92/85/KEE për futjen e masave për inkurajimin e përmirësimeve lidhur me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës për punonjëset shtatzëna dhe punonjëset që kanë lindur rishtazi ose janë me fëmijë në gj, në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A31992L0085>

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, në: [https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati i Lisbones - Verzioni i Konsoliduar.pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati%20i%20Lisbonit%20-%20Verzioni%20i%20Konsoliduar.pdf)

Versioni i konsoliduar i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, në: [http://mei-ks.net/repository/docs/Traktati i Lisbones - Verzioni i Konsoliduar.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/Traktati%20i%20Lisbonit%20-%20Verzioni%20i%20Konsoliduar.pdf)

Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian, në: [https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati i Lisbones - Verzioni i Konsoliduar.pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati%20i%20Lisbonit%20-%20Verzioni%20i%20Konsoliduar.pdf)

Ligji vendor (sipas emrit)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008

Ligji nr. 02/L-30 për mbeturina (Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina - shtojca), 2012, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2829>

Ligji nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë, 2006, në: http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L31_al.pdf

Ligji nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor, 2006, në: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/7-lep-ligji-mbi-eukimin-parashkollor.pdf>

Ligji nr. 02/L-70 për sigurinë në komunikacionin rrugor, 2008, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2574>

Ligji nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues, 2007, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2506>

Ligji Nr. 03. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2668>

Ligji nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore, 2009, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2608>

Ligji nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, 2008, në: http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L017_al.pdf

Ligji nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, 2008, në: http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L-019_al.pdf

Ligji nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, 2009, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>

Ligji nr. 03/L-029 për inspektionin bujqësor, 2009, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2609>

Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 2008, në: http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Kosovë, në: http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_al.pdf

Ligji nr. 03/L-051 për aviacionin civil, 2008, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2532>

Ligji nr. 03/L-057 për ndërmjetësim, 2008, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2592>

Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Kosovës, 2008, në: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/9ligji-i-arsimit-ne-komuna2008-03-l068-al-ar-se-kom.pdf>

Ligji nr. 03/L-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, 2008, në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L072_al.pdf

Ligji nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, 2008, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

Ligji nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë, 2009, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2624>

Ligji nr. 03/L-125 për shërbimin konsullor të misionëve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, 2008, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2618>

Ligji nr. 03/L-142 për rendin dhe qetësinë publike, 2009, në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009-142-sh.pdf>

Ligji nr. 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, 2009, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2654>

Ligji nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, 2009, në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-154_al.pdf

Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, 2017, në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-164-alb.pdf>

Ligji nr. 03/L-166 për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2682>

Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691>

Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2700>

Ligji nr. 03/L-207 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Kosovës, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2692>

Ligji nr. 03/L-212 i punës, 2010, në: <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-212-alb.pdf>

Ligji nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, 2010, në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-225-alb.pdf>

Ligji nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, 2010, në: <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-229-alb.pdf>

Ligji nr. 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2711>

Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2720>

Ligji nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716>

Ligji nr. 03/L-256 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2722>

Ligji nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas, 2012, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803>

Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

Ligji nr. 04/L-047 për masat mbrojtëse në importe, 2011, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2771>

Ligji nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, 2011, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2790>

Ligji nr. 04/L-076 për policinë, 2012, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

Ligji nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, 2012, në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20marredheniet%20e%20detyrimeve.pdf>

Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare, 2012, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2808>

Ligji nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural, 2012, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2848>

Ligji nr. 04/L-094 për shërbimet e shoqërisë informatike, 2012, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2811>

Osmani	Ruzhdi	Udhëheqës i Divizionit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave	Ministria e Drejtësisë
Poder	Sirje		ZBE
Rexha	Violeta	Eksperte për Çështje Gjinore dhe për Gjithpërfshirje	Fondacioni Mileniumi i Kosovës, Zyra e Kyreministrit
Saliu	Florentina	Zyrtare për Barazi Gjinore	MEI
Sekiraqa	Sherife		MBPZHR
Sokoli	Adelina	Zyrtare për Barazi Gjinore	MEI
Sutaj	Mirlinda		MMPH
Tahiri	Aferdita	Menaxhere e Projekteve	ZBE
Uka	Sanije	Zyrtare për Statistika Gjinore	ASK
Zaimi	Albulena	Menaxhere e Projekteve / Zyrtare e Programit / Zyrtare për Barazi Gjinore	ADA

Shtojca 3. Personat e kosnultuar në verifikimin e palëve të interesit

Mbiemri	Emri	Pozita	Organizata/Institucioni
Banjska	Iliriana	Analiste Gjinore	RrGK
Bejtullahu Turjaka	Valentina	Zyrtare Lokale për Anti-trafikim	Misoni OSBE në Kosove
Bivolaku	Visar	Zyrtari i Politikave / Të Drejtat e Njeriut	ZBE
Canolli	Florim	Drejtore, Departamenti i Ndihmës për Zhvillim/Udhëheqësi i Zyrës së Koordinatorit Kombëtar (NIPAC)	MEI
Cekic Dincsoy	Selma	Zyrtare për Barazi Gjinore	ZBE
Charle Cuellar	Reyes	Këshilltare Ligjor	EUSR
Domaniku	Luljeta	Këshilltare Ligjore për Barazi Gjinore	Institucioni i Avokatit të Popullit
Fath-Lihic	Annette	EUSR Shefe Politike/ Koordinatorë Ekzekutive	ZBE / Përfaqësuesi Special i BE-së
Farnsworth	Nicole	Drejtore e Programit dhe Udhëheqëse e Hulmtimeve	RrGK
Gashi	Berenika	Këshilltare për Çështje Gjinore	USAID
Grajçevci	Sebahate		
Jasiqi	Fatime	Zyrtare për Barazi Gjinore	MASHT
Kajtazi	Adelina	Udhëheqës i Divizionit për Raportim dhe Monitorim	ABGJ
Kërqeli	Ajete	Zyrtare për Ngritje të Fondeve / Eksperte Gjinore	Demokracia për Zhvillim
Morina	Donjeta	Hulmtuese	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Ramaxhiku	Merita	Menaxhere e Projektit "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshillimore" / Zyrtare e Lartë për Barazi Gjinore	MBPZhR
Roka	Adea	Praktikante	RrGK
Rudi	Nita	Praktikante	RrGK
Sokoli	Adelina	Zyrtare për Barazi Gjinore	Ministria e Infrastrukturës
Stolarczyk	Agnieszka	Këshilltare e Lartë – Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Komuniteteve	Misioni i OSBE-së në Kosovë
Syla	Merita	Departamenti për Mbrojtje nga Diskriminimi	Zyra e Avokatit të Popullit
Sheremeti Smakij	Shpresa	Koordinatorë e Njësisë për të Drejtat e Njeriut	MMPH
Soba	Yllka	Zyrtare e Programit në Kosovë	Fondacioni Kvinna till Kvinna
Zaimi	Albulena	Menaxhere e Programit për Arsim	Agjencioni Austriak për Zhvillim
Zariqi	Shpresa	Shefe e Departamentit për Bashkëpunimin	ABGJ
Zogiani	Nita	Menaxhere e Projektit	Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Shtojca 4. Harta e aktorëve kryesorë

Sipas Termave të Referimit, Analiza Gjimore duhet të përfshijë hartën e aktorëve që punojnë në çështjet e barazisë gjimore. Kjo Shtojcë përshkruan shkurtimisht aktorët kryesorë sipas sektorëve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, veprimet e ndërmarra në të kaluarën dhe çdo aktivitet të njohur të planifikuar për të ardhmen lidhur me avancimin e barazisë gjimore. Të gjitha informatat rrjedhin nga uebsajtët zyrtarë ose informatat që janë ndarë me RrGK-në gjatë takimeve të mëhershme, përveç rasteve kur është shënuar ndryshe. Duke pasur parasysh numrin e madh të aktorëve, autorët mund të kenë bërë ndonjë lëshim, për të cilën gjë kërkojnë falje.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjimore
Demokracia dhe qeverisja		
ABGJ	Agjenci ekzekutive në Zyrën e Kryeministrit, përgjegjëse për avancimin e barazisë gjimore. Përgjegjëse për promovimin, mbështetjen dhe bashkërendimin e zbatimit të LBGJ-së. Përgjegjëse për përgatitjen e PKBGJ-së dhe monitorimin e zbatimit të tij. ABGJ-ja merr pjesë në përgatitjen e ligjeve, akteve nënligjore, strategjive dhe programeve, duke siguruar integritetin gjinor dhe BPGJ-në.	Ka botuar kërkime mbi pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje (2015). Në proces e sipër të institucionalizimit të analizës së ndikimit gjinor si pjesë e procesit të hartimit të ligjeve dhe të politikave, si dhe BPGJ-së, respektivisht.
Ministria e Financave	Përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të buxhetit dhe ofrimin e qarkoreve udhëzuese buxhetore, duke përfshirë pikëpamjen gjimore sipas LBGJ-së.	Ka inkorporuar BPGJ-në në qarkoret buxhetore për organizatat buxhetore në nivel lokal dhe qendror dhe mund të vazhdojë ta bëjë këtë. Disa punonjës kanë marrë pjesë në trajnim për BPGJ.
ZBGJ-të	Të krijuara në ministri dhe komuna, në mesin e organeve tjera qeveritare. Përgjegjëse për bashkërendimin e zbatimit të LBGJ-së dhe PKBGJ-së; duke përfshirë integrimin gjinor dhe buxhetimin në hartimin dhe zbatimin e politikave; bashkëpunimin me ABGJ-në dhe aktorë të tjerë; dhe përgatitjen e raporteve vjetore mbi zbatimin e PKBGJ-së dhe raporteve të tjera.	Të përfshira në zbatimin e veprimeve drejt avancimit të barazisë gjimore në komunat dhe ministritë përkatëse.
Partitë politike	Shumica e partive politike kanë forume të grave.	Përpilojnë listat zgjedhore dhe duhet të sigurojnë përfaqësimin e grave dhe burrave sipas kuotës.
Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjimore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	Përgjegjëse për mbikëqyrjen parlamentare të punës së qeverisë në lidhje me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjimore.	Ka organizuar dëgjime publike për të monitoruar zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Ka mbajtur takime për procesin e verifikimit të statusit të personave që kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës dhe ndarjen e pensioneve për këta persona.
Grupi Joformal i Deputeteve në Kuvendin e Kosovës	Gratë deputete në Kuvendin e Kosovës që kanë për qëllim bashkimin e përpjekjeve për çështjet me interes të përbashkët.	Ka qenë i përfshirë në aktivitete të ndryshme me synim të përmirësimit të pjesëmarrjes së grave në politikë, duke përfshirë lehtësimin e dialogut midis grave në politikë dhe qytetarëve, organizimin e dëgjimeve publike, organizimin e diskutimeve, paraqitjen në media, pjesëmarrjen në konferenca rajonale me gratë parlamentare nga vendet fqinje dhe

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
		takime me gra të reja, shoqërinë civile, udhëheqësit komunalë dhe agjencitë qeveritare.
USAID	Demokracia dhe qeverisja e mirë janë pjesë e strategjisë së saj. Çështjet gjinore janë integruar në programim.	Ka për synim të bëjë ngritjen e shkathtësive të grave për të rritur pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe vendimmarrje. Kjo përfshin mbështetjen e grupeve joformale të grave në kuvende, rritjen e numrit të grave në parti politike dhe OSHC, duke inkurajuar përfshirje më të madhe politike. Fokusohet te grupet e marginalizuara si gratë rurale, të reja dhe ato të pakicave.
Sida	Barazia gjinore është prioritet në bashkëpunimin për zhvillim mes Sida-s dhe Kosovës.	Fokusi është në rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në sektorët ku punon. Ofron mbështetje të drejtpërdrejtë për forcimin e ABGJ-së. Ka kontribuar në një analizë gjinore në nivel kombëtar që nxjerr në pah disa sfida të rëndësishme përpara integritit në BE.
NDI	OJQ ndërkombëtare me fonde nga USAID-i që mbështet partitë politike, duke përfshirë mbështetjen specifike për gratë që ato të hyjnë në politikë.	Ka mbështetur Javën e Grave që mbahet çdo vit, Grupin Joformal të Deputeteve dhe aktivitete të tjera për të mbështetur gratë në politikë. Planifikon të vazhdojë me mbështetje të ngjashme në të ardhmen.
UNDP	Përfshin aspektin gjinor në punën e vet lidhur me qeverisjen demokratike dhe ndërtimin e paqes.	Ka një strategji të integritit gjinor të adoptuar rishtazi për programin e vet të qeverisjes demokratike. Ka për synim fuqizimin e grave në vendimmarrje. Punon për të forcuar përgjegjshmërinë gjinore të qeverisë qendrore dhe lokale përmes zhvillimit të kapaciteteve. Punon me partnerët nga Kosova për të zbatuar Strategjinë Globale të Barazisë Gjinore dhe për të promovuar pjesëmarrjen e grave në institucionet demokratike dhe vendimmarrje. Punon në drejtim të forcimit të kapaciteteve të institucioneve të Kosovës dhe mbështetjes së vendimeve të bazuara në dëshmi duke përdorur të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë.
Fondacioni Kvinna till Kvinna	Punon në rajonet e luftës dhe konflikteve të armatosura për të promovuar vetë-mbështetjen dhe vetë-vlerësimin e grave; shëndetin psiko-social dhe/ose fizik të grave; dhe pjesëmarrjen e grave në ndërtimin e shoqërisë civile demokratike. Gjithashtu, mbështet studimet dhe tërheq vëmendjen e publikut rreth efekteve të luftës dhe konfliktit të armatosur te gratë; dhe synon të nxisë mbështetje publike për zgjidhjen paqësore të konflikteve.	Mbështet OGSHC-të, veçanërisht në avokimin për të integruar pikëpamjen gjinore në proceset e aderimit në BE dhe për të siguruar përfshirjen e grave në këto procese.
Helvetas	Promovon veprime dhe politika që favorizojnë grupet e pafavorizuara shoqërore dhe gratë që vuajnë nga diskriminimi. Përpiqet për të trajtuar marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit dhe për të zvogëluar paragjykimet dhe dhunën.	Mbështet avancimin e barazisë gjinore në nivelin komunal si pjesë e programimit për decentralizim. Kjo ka përfshirë trajnimin dhe mbështetjen rreth integritit gjinor, duke përfshirë BPGJ-në, dhe forcimin e grupeve joformale të grave anëtare në kuvendet komunale.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
Misioni i OSBE-së në Kosovë	Demokratizimi dhe qeverisja e mirë janë ndër fushat e fokusit, duke përfshirë pikëpamjen gjinore.	Mbështet promovimin e barazisë gjinore dhe integrimin gjinor në nivel komunal, duke përfshirë BPGJ-në. Ka punuar në rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve dhe mekanizmave vendorë, drejt integritit gjinor në punën e tyre, duke përfshirë trajnimin për BPGJ.
Lobi për Barazi Gjinore	Rrjet joformal i cili bën bashkë gratë në kuvendet komunale, ish-anëtarët e kuvendeve komunale, ZBGJ-të, OGSHC-të dhe burrat në 27 komuna për të avokuar për avancimin e barazisë gjinore në nivelin komunal.	Do të vazhdojë të takohet së paku çdo gjashtë muaj në nivel të Kosovës dhe më shpesh brenda komunave, duke identifikuar çështjet me interes të përbashkët dhe pastaj duke ndërmarrë avokim të përbashkët për barazi gjinore në nivelin komunal. Gjithashtu planifikon të bashkojë forcat me gratë deputete në Kuvendin e Kosovës për të avokuar në nivel qendror rreth çështjeve të shqetësimit të përbashkët.
Koalicioni për Barazi	Rrjet joformal i grave në politikë në nivel lokal dhe qendror dhe OGSHC-ve, që synojnë të mbështesin dhe fuqizojnë njëra-tjetrën në përmirësimin e pozitës së grave në politikë, vendimmarrje dhe avancim të barazisë gjinore, përmes mentorimit, avokimit, solidaritetit dhe mbështetjes për njëra-tjetrën.	Themeluar në korrik 2018 me mbështetjen e Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së, ato kanë identifikuar sfidat kryesore për pjesëmarrjen politike të grave në Kosovë dhe veprimet për t'i adresuar këto, që planifikojnë t'i ndërmarrin së bashku në të ardhmen.
RrGK	Rrjet që ka si fokus programor fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në politikë. Disa nga anëtarët e saj nga radhët e OGSHC-ve gjithashtu punojnë në avancimin e pjesëmarrjes së grave në politikë.	Shqyrton projektligjet dhe politikat e vëna në shënjestër, duke avokuar për integrimin e një pikëpamjeje të përmirësuar gjinore. Ka vlerësuar harmonizimin e ligjeve të Kosovës me acquis-të e BE-së për barazinë gjinore. Mobilizon gratë për pjesëmarrje të shtuar në politikë dhe në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Inkurajon qytetarët që të votojnë për gratë. Strategjia për 2019-2022 do të vazhdojë në këtë drejtim, duke përfshirë fuqizimin e grave për pjesëmarrje në politikë dhe vendimmarrje në të gjitha nivelet; mbështetjen e Lobit të Kosovës për Barazi Gjinore; dhe mbështetjen e Koalicionit për Barazi.
QKSGJ	OGSHC që punon drejt barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave me mision për të integruar programet dhe politikat që marrin parasysh aspektin gjinor në të gjithë sektorët.	Ka kryer kërkime mbi atë sesi gratë votojnë dhe si portretizohen në media gratë që merren me politikë. Ka program të vazhdueshëm për të mbështetur pjesëmarrjen e grave të reja në politikë.
D4D	Ka disa programe për qeverisjen dhe demokracinë.	Përfshin aspektin gjinor në të gjitha programet e veta. Strategjia e re do të hartohet deri në fund të gushtit 2018.
GLZ	Zbaton projektin "Shërbimet sociale për grupet e pafavorizuara të popullsisë".	Ndër grupet e tjera të pafavorizuara, projekti vë në shënjestër gratë me prejardhje të ndryshme etnike dhe fetare. Projekti do të zgjasë deri në 2021.
Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore		
Ministria e Drejtësisë	Punon për të siguruar sistemin gjyqësor efikas dhe të paanshëm. Përgjegjëse për ndryshimet ligjore përkatëse. Koordinator kombëtar kundër dhunës në familje (shih më poshtë), kompensimi i viktimave të krimit, Shërbimi Sprovues, Shërbimi	Personat që kërkojnë të realizojnë të drejtat nga Fondi për Kompensim të Viktimave të Krimit paraqesin kërkesat e tyre pranë Ministrisë së Drejtësisë. Aktualisht është përgjegjëse për bashkërendimin e propozimeve për ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, duke synuar zbatimin e Konventës së Stambollit dhe duke përfshirë një përkufizim specifik për ngacmimin seksual.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
	Korrektues, dhe forenzika janë në kuadër të kësaj ministrie.	
ABGJ	Shiko më lart. Gjithashtu, bashkë-koordinon zbatimin e SKMDHF-së.	Ka për synim të ndjekë dhe të koordinojë programet e hisedarëve që lidhen me dhunën në bazë gjinore. Ka përgatitur disa botime lidhur me dhunën në bazë gjinore. Ka të ngjarë që PKBGJ (2018-2023) do të përfshijë vëmendje ndaj çështjeve që lidhen me sigurinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore. Ka mbështetur disa nisma për të përmirësuar qasjen e grave në pronë, duke përfshirë Udhëzimin Administrativ për regjistrimin e përbashkët të pronës. Subjekt bashkëpunëtor në nismën rajonale për të adresuar diskriminimin gjinor (2018-2022), nisma është e prirë nga RrGK-ja dhe mbështetet nga BE-ja.
Koordinatori kombëtar kundër dhunës në familje	Zëvendësministri i Drejtësisë, me mandat për të mbikëqyrur zbatimin e SKMDHF 2016-2020, bashkërendon punën e Grupit Koordinues Ndërmintor të Punës kundër Dhunës në Familje dhe monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare.	Do të vazhdojë me mbështetjen dhe monitorimin e zbatimit të SKMDHF-së. Është duke krijuar një bazë të dhënash ndër-institucionale për të regjistruar rastet e dhunës në familje, me mbështetje nga UN Women.
Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore	Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përgjegjës për përgatitjen, zhvillimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, si dhe ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat. Përgjegjës për zhvillimin e kërkimeve, përgatitjen e raporteve dhe shkëmbimin e informacionit me publikun.	Do të vazhdojë me zbatimin e roleve dhe përgjegjësi të tij sipas kuadrit ligjor përkatës.
Koordinatori kombëtar kundër trafikimit	Kryesues i Autoritetit Kombëtar kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore. Vepron si raportues kombëtar në vlerësimin e trendeve të trafikimit dhe matjen e rezultateve të veprimeve kundër trafikimit.	Bashkëpunon vazhdimisht me autoritetet relevante, duke përfshirë organet e zbatimit të ligjit, për të parandaluar dhe luftuar trafikimin me qenie njerëzore dhe për të mbrojtur viktimat. Monitoron zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit për të siguruar identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e duhur të viktimave.
Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit	Ndër kompetencat e zyrës përfshihet ofrimi i ndihmës për qeverinë për të promovuar barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.	Nën mandatin e Zyrës vepron Grupi Këshillues dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT në nivel kombëtar, që përfshin ministrinë, gjykatat, prokurorinë, policinë dhe OSHC-të, në mesin e hisedarëve.
Institucioni i Avokatit të Popullit	Trajton rastet e diskriminimit në emër të shtetit. Këtu përfshihet: hetimi i pretendimeve; dhënia e mendimeve dhe rekomandimeve në rastet e diskriminimit; ofrimi i asistencës viktimave në bërjen e ankesave; dhe ofrimi i informacionit	Strategjia për 2017-2019 përfshin: ndërtimin e besimit të qytetarëve ndaj Institucionit; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore; rritjen e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit; dhe fuqizimin e kapaciteteve të saj. Institucioni gjithashtu merret me rastet që përfshijnë dhunën në bazë gjinore dhe diskriminimin, kur kjo vlen për

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
	në lidhje me të drejtat, detyrimet dhe mjetet mbrojtëse.	mandatin e saj. Subjekt bashkëpunëtor në nismën rajonale për të adresuar diskriminimin gjinor, nisma është e prirë nga RrGK-ja dhe mbështetet nga BE-ja.
Komisioni për njohjen dhe verifikimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale	Administrohet nga MPMS-ja, përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve dhe intervistimin e të mbijetuarve që gëzojnë të drejtën për shërbime shtetërore, duke përfshirë pensionet.	Do të vazhdojë me shqyrtimin e aplikimeve dhe me identifikimin e përfituesve që kualifikohen për pensione.
Policia e Kosovës	Heton krimet, ofron mbrojtje dhe i referon viktimat për shërbime mbështetëse, duke përfshirë ato për krimet me bazë gjinore. Njësitë e Hetimit të Dhunës në Familje dhe Drejtoria kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, përkatësisht, janë të specializuara për raste të tilla.	Do të vazhdojë me zbatimin e detyrave zyrtare duke hetuar krimet, duke i referuar viktimat për shërbime mbështetëse dhe duke ofruar mbrojtje. Policia i nënshtrohet trajnimit dhe Njësitë e Hetimit të Dhunës në Familje do të vazhdojnë të ndjekin trajnime të specializuara për policinë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Disa kanë marrë trajnim rreth qasjes që përqendrohet te viktima, si dhe mbi rastet e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin. Në kuadër të policisë ekziston Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës.
Instituti i Mjekësisë Ligjore	Përgjegjës për ekzaminimin e rasteve dhe mbledhjen e provave, duke përfshirë ato lidhur me dhunën në bazë gjinore.	Ka pasur disa raste që kishin të bëjnë me dhunën seksuale. Ka plane për të hapur Qendrën e Krizave të Përdhunimit, e cila në të ardhmen do të përfshijë trajnime që lidhen me dhunën në baza gjinore.
Prokuroria	Trajton lëndët penale, duke përfshirë këtu edhe ato lidhur me çështjet gjinore, për secilën gjykatë themelore në shtatë komunat më të mëdha. Prokuroria e Apelit trajton ankesat; ka juridiksion në të gjithë Kosovën. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit trajton rastet e Gjykatës Supreme.	Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale kërkon që prokurorët të përmbahen nga diskriminimi mbi çfarëdo baze duke shmangur qëndrimin paragjykses ndaj çdo personi mbi çfarëdo baze, duke përfshirë gjininë dhe orientimin seksual. Disa prokurorë kanë ndjekur trajnime në lidhje me dhunën në familje, duke përfshirë qasjen e përqendruar te viktima, si dhe për rastet e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin. Po bëhet emërimi i prokurorëve të specializuar që do të përqendrohen në rastet e tilla. Ekziston Forumi i Gjyqtareve dhe Prokuroreve të Kosovës.
ZMNV	Ofron mbështetje për viktimat, duke përfshirë ato lidhur me dhunën në familje dhe krimet e tjera të rënda, dhe siguron që viktimat janë në dijeni të shërbimeve që ofron shteti dhe si t'i qasen këtyre shërbimeve.	Do të vazhdojë me zbatimin e roleve dhe përgjegjësi të veta sipas kërkesave përkatëse ligjore. Staf i ka ndjekur trajnim të specializuar.
Gjykatat	Përgjegjëse për sigurimin e sundimit të ligjit, duke përfshirë rastet e lidhura me çështjet gjinore.	Disa gjyqtarë, ndonëse fare pak, kanë ndjekur trajnime në lidhje me dhunën në bazë gjinore dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë konfliktit. Po bëhet emërimi i disa gjyqtarëve që do të merren posaçërisht me rastet e dhunës në baza gjinore. Ekziston Forumi i Gjyqtareve dhe Prokuroreve të Kosovës.
Zyrat për Ndihmë Juridike	Ofrojnë ndihmë juridike për grupet e ndjeshme që marrin ndihmë sociale dhe për viktimat e dhunës në familje; përgatit/shpërndan broshura që informojnë qytetarët për ndihmën juridike.	Do të vazhdojnë me zbatimin e roleve dhe përgjegjësi të tyre. Zyrtarët kanë ndjekur trajnim për kornizën ligjore për dhunën në familje.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
Qendrat për Punë Sociale	Institucionet publike komunale përgjegjëse për mbrojtjen e qytetarëve që kanë nevojë për shërbime sociale dhe familjare, duke përfshirë personat që kanë pësuar dhunë në familje. Kanë përgjegjësi specifike për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.	Do të vazhdojnë me zbatimin e roleve dhe përgjegjësi të tyre, duke përfshirë angazhimin në Mekanizmat Koordinues kundër Dhunës në Familje në nivel komunal. Disa punonjës socialë, ndonëse jo të gjithë, kanë ndjekur më parë trajnime në lidhje me dhunën në familje.
Shërbimi Korrektues i Kosovës	Përgjegjës për ri-socializimin e të burgosurve, duke përfshirë përgatitjen e planeve individuale të rehabilitimit të personave të mbajtur në ndalim. Duhet të krijojë kushte që personat e mbajtur në ndalim të marrin trajtim për varësinë nga droga ose alkooli.	Do të vazhdojë me zbatimin e roleve dhe përgjegjësi të veta. Disa zyrtarë kanë ndjekur ca trajnime mbi dhunën në bazë gjinore, duke u fokusuar në ngacmimin seksual dhe dhunën në familje. EULEX-i po mbështet integrimin gjinor, duke përfshirë ndërmarrjen e analizave gjinore dhe do të mbështesë ngritjen në detyrë të grave në radhët e zyrtarëve korrektues.
Shërbimi Sprovues	Përgjegjës për organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe riintegrimin social të personave të dënuar.	Do të vazhdojë me zbatimin e roleve dhe përgjegjësi të veta sipas kërkesave ekzistuese ligjore. Disa zyrtarë kanë ndjekur ca trajnime mbi dhunën në bazë gjinore, duke u fokusuar në ngacmimin seksual dhe dhunën në familje.
Mekanizmat Koordinues Komunalë	Organe ndërinstitucionale komunale përgjegjëse për menaxhimin e rasteve individuale të dhunës në familje.	Do të vazhdojnë të sigurojnë menaxhim cilësor të rasteve të dhunës në familje. Shumica e anëtarëve janë trajnuar. Deri më tash, 13 komuna kanë mekanizma funksionalë; ka nisma për krijimin e mekanizmave të tillë në komunat tjera.
Strehimorja e Përkohshme e Sigurt	Strehimore e drejtuar nga shteti që ofron strehim për rastet e trafikimit me risk të lartë.	Do të vazhdojë të ofrojë strehim në përputhje me rolin dhe përgjegjësitë e veta.
Noterët dhe Dhoma e Noterëve	Noterët janë zyrtarë publikë që ofrojnë shërbime juridike dhe publike, me qëllim të mbrojtjes së interesave të ligjshme në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Dhoma e Noterëve është organi qendror i profesionit.	Ka bashkëpunuar me Programin e USAID-it për të Drejtat Pronësore në adresimin e sfidave që kanë të bëjnë me gratë që kërkojnë të realizojnë të drejtat e trashëgimisë dhe zhvillimin e praktikës së qëndrueshme për rastet e tilla. Disa noterë kanë marrë trajnim në lidhje me proceset e trashëgimisë, dhe udhëzime me shkrim për trajtimin e rasteve të trashëgimisë.
Grupi për Koordinim të Sigurisë dhe Çështjeve Gjinore	Trup joformal i përbërë nga institucionet, OGSHC-të, agjencitë e OKB-së dhe donatorët që mbledhen rregullisht për të shkëmbyer informacion dhe për të koordinuar veprimet e përbashkëta.	Ka ndërmarrë disa aktivitete, duke përfshirë shkrimin e letrave të përbashkëta avokuese lidhur me dhunën në familje dhe qasjen në drejtësi; dhe organizimin e aktiviteteve të përvitshme në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave.
EULEX	Mandati aktual përfshin monitorimin e rasteve dhe gjykimeve të caktuara në sistemin e drejtësisë; dhe kapacitet të kufizuar si reagues i dytë në fushën e sigurisë, dhe ofron mbështetje për policinë për kontrollin e turmave dhe të trazirave. Vazhdon ta menaxhojë programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe i ndihmon Dhomat e Specializuara	Ka monitoruar, mentoruar dhe këshilluar institucionet e sundimit të ligjit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: trajtimin policor të rasteve të dhunës në familje; bashkëpunimin mes policisë dhe prokurorëve në rastet e dhunës në familje; përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi lidhur me dhunën në bazë gjinore; dhe mbështetjen në hartimin e SKMDHF-së. Gjithashtu, Misioni ka ofruar disa trajnime për policinë dhe prokurorët mbi qasjen e përqendruar te viktimat gjatë hetimeve; për gjyqtarët lidhur me dhunën në bazë gjinore; dhe për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
	dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar me mbështetje logjistike dhe operacionale.	lidhur me trajtimin e dhunës seksuale gjatë konfliktit. Në vitin 2018, ka dhënë mbështetje për koordinimin midis policisë, prokurorëve, Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Agjencisë së Kosovës për Forenzikë për rastet e dhunës seksuale. Do të mbështesë formimin e një shoqate të grave në shërbimin korrektues, dhe do të ofrojë trajnime për avancimin e kapaciteteve dhe pozitës së grave në Shërbimin Korrektues të Kosovës.
Misioni i OSBE-së në Kosovë	Si pjesë e punës lidhur me barazinë gjinore, OSBE-ja punon për të përmirësuar reagimin institucional ndaj dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe për të mbrojtur të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi.	Ka punuar me përfaqësuesit e sektorit të drejtësisë dhe Institucionin e Avokatit të Popullit, si dhe ka koordinuar ngritjen e vetëdijes në lidhje me të drejtat pronësore të grave. Ka plane për të vazhduar nismat për ngritjen e vetëdijes. Gjithashtu fokusohet në administrimin efektiv të drejtësisë në rastet ndëretnike dhe ato që kanë ndikim joproporcional te gratë ose komunitetet specifike. Ka mbështetur krijimin e mekanizmave koordinues kundër dhunës në familje në 10 komuna. Ka bërë prezantimin e SKMDHF-së në nivel lokal. Do të vazhdojë me organizimin e debateve televizive dhe konferencave mbi dhunën në familje. Ka kryer studimin për Këndvështrimin e burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë.
UNDP	Programi për Qeverisje Demokratike dhe Ndërtim të Paqes përfshin vëmendjen ndaj drejtësisë gjinore dhe sundimit të ligjit.	Në të kaluarën, përmes Iniciativës për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas, mbështeti zbatimin e kuadrit ligjor që trajton dhunën në familje, strategjinë kundër dhunës në familje dhe strategjinë kundër trafikimit me qenie njerëzore. Ka qenë në krye të nismave të mëparshme ndërinstitutionale të agjencive të OKB-së për të trajtuar dhunën në bazë gjinore, veçanërisht dhunën në familje. Iniciativa për Drejtësi Gjinore ofron mbështetje për sekretarë juridikë për t'i ofruar ndihmë grave që kanë pësuar dhunë në familje. Gjithashtu, punon në fushën e sigurisë në komunitet me fokus në çështjet gjinore.
UN Women	Kontribuon në legjislacionin lidhur me barazinë gjinore, dhunën në familje dhe fuqizimin e grave, si dhe krijimin e mekanizmave gjinorë në nivel lokal dhe qendror.	Është e përfshirë në disa nisma për të trajtuar dhunën në bazë gjinore. Pjesë e programit trevjeçar të mbështetur nga BE-ja, "Zbatimi i normave, ndryshimi i mendjes", për të adresuar dhunën ndaj grave dhe për të mbështetur zbatimin e Konventës së Stambollit. Me agjencitë e tjera të OKB-së, mbështeti ngritjen e mekanizmave koordinues komunalë të lartpërmendur. Angazhohet në mbështetje të strehimoreve dhe për ngritje të vetëdijes. Në bashkëpunim me OGSHC-të, gjithashtu ka mbështetur mundësitë ekonomike për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës.
UNICEF	Synon të sigurojë që të gjithë fëmijët kanë qasje mundësi dhe shërbime cilësore për t'i ndihmuar ata të mbijetojnë, të zhvillohen dhe të bëhen qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm.	Është i përfshirë në nisma për të trajtuar dhunën në bazë gjinore. Gjithashtu, lidhur me vajzat, djemtë dhe ndikimin e migrimit.
UNFPA	Synon të sigurojë shtatzëninë e planifikuar, lindjen e sigurt për nënat dhe jetë të shëndetshme për të gjithë. Përkrah shëndetin	Është e përfshirë në nisma për të trajtuar dhunën në bazë gjinore. Punon me prijësit fetarë dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor në parandalimin dhe trajtimin më

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
	riprodhues dhe të drejtat për çdo grua, burrë dhe fëmijë, si individë dhe familje.	të mirë të dhunës. Ka shqyrtuar abortin selektiv sipas seksit dhe martesat e fëmijëve, ndër të tjera.
ADA	Synimet përfshijnë paqen dhe sigurinë njerëzore nëpërmjet forcimit të sundimit të ligjit.	Mbështet adresimin e dhunës në bazë gjinore nëpërmjet mbështetjes së OGSHC-ve.
USAID	Programet e sundimit të ligjit janë të fokusuara në sigurimin e ekzekutimit dhe zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve për barazinë gjinore. Të drejtat LGBTI kanë qenë temë e ndërthurur. Gjithashtu ka mbështetur të drejtat pronësore dhe të drejtat e trashëgimisë për gratë duke adresuar faktorët ligjorë dhe shoqërorë që pengojnë qasjen në pronë.	Programet kanë mbështetur OGSHC-të në monitorimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme për gratë në gjykata. Programi për të Drejta Pronësore ka mbështetur trajnimin për ZBGJ-të, noterët dhe zyrtarët e gjykatave lidhur me proceset e trashëgimisë; ndryshimet në kornizën ligjore për të lehtësuar zotësinë e grave për të realizuar të drejtat e trashëgimisë dhe të drejtat pronësore; udhëzime për noterët për rastet e trashëgimisë; kërkimet mbi qasjen e grave në pronë; dhe ndryshimet shoqërore dhe të sjelljes për gratë që kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre pronësore.
Departament i Drejtësisë i SHBA-së, Zyra për Trajnim dhe Asistencë Zhvillimore Prokuroriale përtej Oqeanit	Mbështet politikë-bërësit, duke i ndihmuar ata në forcimin e sundimit të ligjit; ofron trajnime dhe asistencë për gjyqtarët, prokurorët, mbrojtësit e viktimave dhe institucionet e tjera; dhe këshillon prokurorinë dhe gjyqësorin rreth teknikave të menaxhimit që përmirësojnë efikasitetin. Ka programin për mbrojtje të viktimave që përqendrohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për viktimat e krimit dhe trajton çështjet e ndërlidhura gjinore.	Ka mbështetur zhvillimet për përfshirjen e mbrojtësve të viktimave në procedurën penale, duke përfshirë përmes trajnimit për përfaqësim në gjykatë dhe përmbushje të kërkesave të BE-së; ka mbështetur funksionalizimin e programit për kompensim të viktimave; ka informuar profesionistët nga fusha e drejtësisë lidhur me dëmshpërblimin dhe kompensimin e viktimave; dhe ka ndihmuar Komisionin për Kompensim të Viktimave të Krimit. Ka plane për të vazhduar me trajnimin e gjyqtarëve e prokurorëve të caktuar, mbrojtësve të viktimave dhe policisë mbi dhunën në familje; organizim të tryezave të rrumbullakëta me prokurorë, gjyqtarë dhe mbrojtës të viktimave për të diskutuar dispozitat e reja në Kodin Penal për dhunën në familje; dhe për të përmirësuar nivelin e vetëdijes rreth të drejtave dhe kompensimit të viktimave.
GIZ	Zbaton projektin “Shërbime këshillimore për reformë gjyqësore dhe administrative - forcimi i institucioneve për trajnim”. Projekti do të marrë fund në 2018.	Projekti përfshin përpjekjet për forcimin e “kapacitetit dhe performancës së sistemit gjyqësor dhe administrativ sa i përket çështjeve gjinore, vendimeve administrative dhe aktvendimeve të gjykatave administrative”.
CARE	OJQ ndërkombëtare e cila përqendrohet në përfshirjen politike dhe shoqërore-ekonomike të grupeve të ndjeshme dhe barazi gjinore. Gjithashtu ndihmon refugjatët.	Përmes Iniciativës së Burrave të Rinj, promovon barazinë gjinore dhe synon të parandalojë dhunën, duke përdorur arsimin, shtrirjen e kontakteve me komunitetin dhe mediat. “Fushata globale e atësisë - MenCare” promovon përfshirjen e barabartë të burrave si ofrues të kujdesit, drejt mirëqenies familjare dhe barazisë gjinore.
RrGK	Ka programin për trajtimin e dhunës në bazë gjinore. Disa OGSHC anëtare të rrjetit, duke përfshirë strehimoret, punojnë në trajtimin e dhunës në bazë gjinore, mes fushave tjera lidhur me sundimin e ligjit, si kundër-trafikimi, kundër-diskriminimi, të drejtat e	Ka ndërmarrë aktivitete avokimi për ngritje të vetëdijes dhe politikë-bërje për të drejtat pronësore, dhunën seksuale të kryer gjatë luftës, dhunën në familje dhe ngacmimin seksual. Strategjia e re do të vazhdojë me përqendrimin te dhuna në bazë gjinore, duke përfshirë përmirësimin e mëtejshëm të kornizës ligjore; monitorimin/avokimin për zbatimin e saj; dhe ngritjen e vetëdijes, duke përfshirë parandalimin e

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
	pakicave, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtat pronësore.	dhunës. Do të vazhdojë të mbështesë anëtarët e RrGK-së përmes Fondit të Grave të Kosovës për të mbështetur sundimin e ligjit.
QKSGJ	Shiko më lart.	Ka publikuar raporte të mëparshme lidhur me sigurinë e grave, ngacmimet seksuale, dhunën në mesin e çifteve adoleshente, dhunën ndaj grave dhe të drejtat pronësore të grave. Planifikon të vazhdojë punën me Koalicionin për të Drejta të Barabarta për të Gjithë; për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave nëpërmjet programit të mbështetur nga UN Women "Zbatimi i normave, ndryshimi i mendjes", dhe për të mbështetur mediat dhe gazetarinë e pavarur nga pikëpamja e të drejtave të njeriut.
Koalicioni për të Drejta të Barabarta për të Gjithë	Koalicioni i OSHC-ve të fokusuar në të drejtat e njeriut që synojnë të forcojnë kapacitetet e tyre për të avokuar për të drejtat themelore të personave LGBT, grave, të rinjve dhe personave nga grupet e pakicave etnike.	Zbaton projektin e mbështetur nga BE-ja që përfshin bashkëpunimin midis OSHC-ve; mundësitë për të mësuar, shkëmbimin e njohurive dhe përvojave; forcimin e kapaciteteve për avokim që vë në shënjestër institucionet relevante qendrore dhe komunale; dhe rritjen e dukshmërisë për të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut. Nisma përfshin vëmendjen për disa çështje që lidhen me barazinë gjinore dhe sundimin e ligjit.
Strehimoret	OGSHC, të financuara pjesërisht nga MPMS-ja, përgjegjëse për strehimin e personave që kanë pësuar dhunë në familje dhe/ose janë viktimat e trafikimit. Këtu përfshihen strehimoret në secilin rajon dhe dy strehimore enkas për fëmijë.	Do të vazhdojnë të marrin pjesë në Mekanizmat Koordinues Komunalë për të menaxhuar rastet dhe do të vazhdojnë me mbrojtjen e personave që kanë pësuar dhunë, në pritje të financimit. Shumica e stafit të strehimoreve kanë ndjekur disa trajnime.
<i>Terre des Hommes</i>	Ka një projekt për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, moskujdesi, dhuna, delikuenca, shfrytëzimi dhe trafikimi.	Ka mbështetur zhvillimin e mekanizmave ndërinstitucionalë për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, të cilat kanë trajtuar rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Për më tepër, organizata po zhvillon një rrjet të mbrojtjes së fëmijëve në gjashtë komuna për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e abuzimit dhe moskujdesit, duke përfshirë fëmijët migrantë.
Medica Kosova, Medica Gjakova, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve	OGSHC të certifikuar për të mbështetur gratë dhe burrat në kërkimin e reparacionit për dhunën seksuale të kryer gjatë luftës. Ato gjithashtu ofrojnë shërbime psikologjike dhe shërbime të tjera mbështetëse.	Do të vazhdojnë të mbështesin gratë dhe burrat në realizimin e të drejtave të tyre për reparacion. Do të vazhdojnë të ofrojnë shërbime mbështetëse.
Shoqata e Juristëve NORMA	OGSHC që është shoqatë e juristeve. Ofron ndihmë juridike të drejtpërdrejtë; ofron trajnime dhe seminare; monitoron zbatimin e ligjeve ekzistuese në lidhje me barazinë gjinore; dhe ofron edukim për gratë mbi ligjet në fuqi.	Do të vazhdojë të përqendrohet në të drejtat pronësore dhe trashëgimore, marrëdhëniet e punës dhe dhunën në familje. Aktualisht (2017-2019) është e angazhuar në projektin "Veprime avokimi nga Organizatat e Shoqërisë Civile për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në përputhje me Konventën CEDAW dhe

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
		Konventën e Stambollit në kuadër të Programit “Eliminimi i dhunës ndaj grave: Zbatimi i normave, ndryshimi i mendjes”, me fonde nga UN Women.
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave	OSHC që promovon demokracinë dhe vlerat demokratike.	Ka bërë kërkime rreth qasjes ndaj kompensimit për krime, duke përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit (2017); dhe rreth sektorit të sigurisë në Kosovë nga pikëpamja gjinore (2016). Aktualisht po kryen kërkime rreth qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në bazë gjinore dhe viktimat e krimit nga komuniteti LGBT.
Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore	Punon drejt përmirësimit të pozitës së komunitetit LGBT në Kosovë për të dalë nga margjinat e shoqërisë dhe për të pasur ndikim në vendimet që ndikojnë në mirëqenien e tyre.	Puna e mëparshme dhe e ardhshme përqendrohet në: fuqizimin e komunitetit LGBTI në Kosovë; ngritjen e vetëdijes për të drejtat LGBTI; avokimin për të drejtat LGBTI; dhe parandalimin e HIV-it në mesin e personave LGBTI.
Qendra për Barazi dhe Liri	Punon për fuqizimin e komunitetit LGBTI në Kosovë duke promovuar dhe mbrojtur të drejtat e komunitetit LGBTI dhe duke punuar në drejtim të krijimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse që avokon për barazi dhe njeh dhe respekton diversitetin.	Punon drejt parandalimit të diskriminimit të bazuar në orientimin seksual; ngritjes së vetëdijes rreth të drejtave LGBT; dhe avokimit për të drejtat e komunitetit LGBT.
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut	OSHC që përqendron aktivitetet e veta në ballafaqimin me të kaluarën, mbrojtjen e viktimave të abuzimit të të drejtave të njeriut, promovimin e sundimit të ligjit dhe forcimin e rolit të të rinjve.	Ka kryer kërkime lidhur me të drejtat LGBT në Kosovë, në të kaluarën. Rregullisht organizon ngjarje publike për të ngritur vetëdijen për barazinë gjinore dhe të drejtat e barabarta.
Fondacioni Jahjaga	Fondacioni i ri i themeluar nga presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, do të përqendrohet te gratë dhe fëmijët.	Ka ofruar mbështetje për gratë që kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës. Ka plane që në të ardhmen të sigurojë fonde që do t'i dedikohen grave. Angazhohet për ngritje të vetëdijes për çështje të ndryshme që lidhen me të drejtat e grave.
Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim	Fondacion kosovar që ndan grante në fusha të ndryshme, aktualisht lidhur me të drejtat pronësore.	Ka mbështetur disa nisma të OSHC-ve lidhur me avancimin e qasjes së grave në pronë, në qeverisje dhe në ekonomi.
Kapitali njerëzor: Arsimi		
MASHT	Ofron arsimim nga niveli parashkollor deri te ai terciar për burrat, gratë, djemtë dhe vajzat, si dhe arsimim profesional dhe për të rritur. Përgjegjëse për temat e mësimdhënies në lidhje me barazinë gjinore.	Ka ndërmarrë hapa drejt BPGJ-së. ¹ Ka themeluar grupin punues për ndryshimin e kurrikulave të shkollave fillore në mënyrë që ato të pasqyrojnë më mirë çështjet gjinore. ZBGJ në MASHT përfshihet në shtrirjen e kontakteve me shkollat mbi çështje të ndryshme lidhur me barazinë gjinore, siç është dhuna në familje.
ABGJ	Shih më lart.	Finalizimi i të Programit të Barazisë Gjinore për periudhën 2018-2023, që përfshin arsimin si komponent kryesor. Mbështetja e rregullt e fushatave edukative.
ASK	Çdo vit përgatit statistika për të gjitha nivelet e arsimit, të zbërthyer sipas gjinisë.	Do të vazhdojë me mbledhjen e statistikave të zbërthyer sipas gjinisë në bashkëpunim me MASHT-in. Me ABGJ-në, planifikon të krijojë Indeksin e Barazisë Gjinore të BE-së lidhur me arsimin.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
Universitetet	Gjashtë universitete publike dhe 31 universitete private ofrojnë arsim për gratë dhe burrat. Në mënyrë hipotetike, arsimi në fusha të ndryshme mund të përfshijë pikëpamje gjinore.	Në kuadër të Universitetit të Prishtinës ekziston programi për studime dhe kërkime gjinore; ai organizon shkollat verore feministe, ndër aktivitetet e tjera. Ka një nismë në zhvillim e sipër për vendosjen e politikës kundër ngacmimit seksual në Universitetin e Prishtinës.
Komunat, duke përfshirë Departamentet për Arsim	Përgjegjëse për buxhetimin dhe administrimin e programeve arsimore.	Në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, ata duhet të kenë buxhet për hapjen e institucioneve të reja parashkollore.
UNICEF	Avokon për të drejtat e fëmijëve. Synon të sigurojë që të gjithë fëmijët kanë qasje në mundësi dhe shërbime cilësore.	Mbështet sigurimin e mundësive të barabarta dhe arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët e ndjeshëm në nivel qendror dhe lokal. Përqendrohet në trajtimin e pabarazive gjinore, si dhe pabarazitë në lidhje me përkatësinë etnike, vendbanimin urban/rural dhe aftësitë e kufizuara.
ADA	Mbështet MASHT-in, në mesin e programeve të tjera.	Strategjia e vendit 2013-2020 përfshin fokusin në arsimin e lartë. Integron çështjet gjinore në të gjitha programet.
GIZ	Mbështet përmirësimin e arsimit, në mesin e programeve të tjera.	Ka zbatuar programin për zhvillimin e kapaciteteve në arsimin bazë në Kosovë (2010-2018). Integron çështjet gjinore në të gjitha programet.
USAID	Përmirësimi i arsimit është pjesë e Strategjisë për Bashkëpunim për Zhvillimin e Vëndit 2014-2018. Të gjitha programet përfshijnë masa drejt barazisë gjinore.	Angazhimi në nivel qendror dhe lokal për të trajtuar pabarazitë gjinore në profilin e mësimdhënësve dhe administratorëve të shkollave. Gjithashtu, Programi për Leadership Transformues siguroi baraspeshën gjinore dhe mbështeti arsimin e lartë në fushën e studimeve gjinore.
OSBE	Puna e mëparshme përfshiu vëmendjen ndaj barazisë gjinore brenda sistemit arsimor.	Ka punuar për të ngritur nivelin e vetëdijes dhe për të promovuar barazinë gjinore midis mësimdhënësve në 2016-2017. Ka mbështetur integrimin e analizës gjinore në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2016-2020.
Qendra për Arsim e Kosovës	OSHC e fokusuar në përmirësimin e cilësisë së arsimit, duke përfshirë trajnimin e mësimdhënësve; të drejtat e njeriut; rrjetëzim dhe pjesëmarrje në politikë-bërje; dhe kërkime rreth arsimit.	Disa projekte në vazhdim e sipër fokusohen në përmirësimin e sistemeve arsimore; dhe "Mbështetje për adoleshentët pas mësimit të rregullt", ndër të tjera. Ka punuar për të luftuar paragjykimet gjinore në librat e leximit në gjuhën shqipe. ²
RrGK	Në radhët e OGSHC-ve anëtare, 34 punojnë në sektorin e arsimit, veçanërisht në nivel lokal.	Strategjia e re për periudhën 2019-2022, përfshin plane për të vazhduar me mbështetjen e anëtarëve dhe për të mbështetur aktivitetet e ngritjes së vetëdijes në lidhje me barazinë gjinore. Ka bërë kërkime dhe ka avokuar për BPGJ në MASHT dhe për hapje të institucioneve të edukimit parashkollor sipas Objektivave të Barcelonës.
Artpolis	OGCHC që përdor artin dhe kulturën për ndryshime shoqërore.	Organizon Forum Teatrit, shkollën e përvitshme verore feministe, dhe artin si përmes festivalit të përvitshëm feminist FemArt dhe duke shtrirë kontaktet në terren për të angazhuar gratë dhe burrat e rinj, vajzat dhe djemtë në trajtimin e pabarazive gjinore.
QKSGJ	OGSHC misioni i së cilës përfshin "rritjen e fokusit në çështjet gjinore në sistemin arsimor të Kosovës".	Më parë ka kryer një "Auditim të çështjeve gjinore në sistemin arsimor" (2007) dhe ka për synim të përmirësojë studimet gjinore.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë	OSHC që mbështet edukimin mbi rolet dhe normat gjinore. Punon për të ndërtuar kapacitetet institucionale për integrimin gjinor.	Projektet që janë në zhvillim e sipër përfshijnë: Pro Wo+Man, i cili ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve, sindikatave dhe institucioneve të tjera në integrimin e pikëpamjes gjinore; Veprojmë për Barazi fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të grave të reja për udhëheqje dhe qeverisje lokale, duke ftuar burrat si aleatë në avancimin e përfaqësimit të barabartë gjinor në strukturat lokale të vendimmarrjes, duke ofruar aktivitete edukative për vajzat dhe djemtë në lidhje me barazinë gjinore, dhunën seksuale dhe dhunën në bazë gjinore, dhe duke bashkëpunuar me grupet e burrave dhe grave për të ngritur vetëdijen rreth pabarazive gjinore.
Care International	OJQ ndërkombëtare që punon me burrat, në drejtim të trajtimit të roleve dhe normave tradicionale gjinore.	Iniciativa e Burrave të Rinj në nivel rajonal ka për qëllim të ndërtojë qëndrime dhe sjellje më të barabarta mes të rinjve dhe të ulë shkallën e dhunës gjinore dhe bashkëshortore.
Balkan Sunflowers	OSHC e është angazhuar në aktivitete lidhur me ndryshimet shoqërore, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin. Arsimi është prioritet.	Është fokusuar në arsimin për vajzat dhe djemtë romë, ashkali dhe egjiptianë, duke përfshirë kërkimin dhe programimin për adresimin e ndërprerjes së shkollimit.
The Ideas Partnership	OSHC që punon në disa fusha duke përfshirë arsimin.	Ka punuar në qasjen në arsim për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, duke trajtuar faktorët që pengojnë vijueshmërinë e shkollës nga vajzat dhe djemtë, si kujdesi shëndetësor, varfëria dhe tëhuajtja. Gjithashtu ofron arsimim për të rritur.
Këshilli Rinor Kosovar	OJQ që përfaqëson të rinjtë; që promovon arsimin, zhvillimin dhe argëtimin e vetorganizuar për të rinjtë; dhe përfshirjen aktive të të rinjve në krijimin dhe zhvillimin e politikave domethënëse për rininë.	Siguron që këshillat e shkollave kanë raport 50/50 të përfaqësimit të vajzave dhe djemve që janë aktivë në krijimin e politikave të shkollave të mesme. Plani i punës i Këshillit Drejtues përfshin organizimin e diskutimeve, punëtorive dhe nismave të ndryshme nëpër shkolla në mbarë Kosovën në lidhje me barazinë gjinore.
Kapitali njerëzor: Punësimi		
ABGJ	Shih më lart.	Më parë ka mbështetur hartimin e Strategjisë për Fuqizim Ekonomik të Gruas. PKBGJ-ja e re do të përfshijë një pjesë lidhur me fuqizimin ekonomik të grave.
ASK	Përgjegjëse për mbledhjen e rregullt të të dhënave lidhur me fuqinë punëtore të zëbërthyer sipas gjinisë.	Do të vazhdojë me publikimin e rregullt të të dhënave lidhur me fuqinë punëtore të zëbërthyer sipas gjinisë.
MPMS	Punon për të siguruar mirëqenien sociale të qytetarëve duke ofruar shërbime punësimi, trajnime profesionale dhe inspektime të punës. Ka përgjegjësi ligjore për të siguruar barazinë gjinore.	Ka nisur përpjekjet për BPGJ. ³ Përgjegjëse për propozimin e ndryshimeve në Ligjin e punës dhe ka krijuar disa grupe punuese drejt harmonizimit të këtij Ligji me Direktivat e BE-së, duke përfshirë ato lidhur me barazinë gjinore.
QAP	QAP-të në Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren ofrojnë aftësim profesional.	Do të vazhdojnë me ofrimin e kurseve të aftësimit profesional, sipas përgjegjësisë. Disa zyrtarë kanë ndjekur trajnime mbi mbështetjen e duhur për gratë që kanë pësuar trauma, siç janë ato nga dhuna në bazë gjinore, gjatë ofrimit të trajnimeve profesionale.
Zyrat e Punësimit	Përgjegjësitë përfshijnë hulumtimin e tregut, regjistrimin e burrave dhe grave të papunë, kryerjen e	Do të vazhdohet me zbatimin e përgjegjësisë, duke përfshirë regjistrimin e qytetarëve të papunë, hulumtimin e tregut dhe ofrimin e informacionit dhe

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
	hulumtimit të fuqisë punëtore dhe sigurimin e informacionit dhe udhëzimeve të karrierës për punëkërkuar.	udhëzimeve, duke ruajtur të dhënat të zbërthyer sipas gjinisë. Disa zyrtarë kanë ndjekur trajnime mbi mbështetjen e duhur gjatë procesit të sigurimit të punësimit për gratë që kanë pësuar trauma.
UNDP	Përfshin aspektin gjinor në të gjithë sektorët, duke përfshirë sektorin e rritjes gjithëpërfshirëse, që merret me punësimin.	Ka mbështetur zyrat e punësimit dhe QAP-të, duke përfshirë mbështetjen lidhur me integrimin gjinor. Ofron mundësi të barabarta për zhvillimin e shkathhtësive dhe punësimit për gratë dhe burrat në programe të ndryshme të masave aktive të tregut të punës: trajnimet në vendin e punës, masat e subvencioneve të pagave, vetëpunësimi, përkrahja e krijimit të vendeve të punës dhe gjenerimit të të ardhurave për të mbijetuarit e dhunës në familje dhe gratë dhe burrat e riatdhesuar që kthehen në Kosovë.
Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSP)	Punon për të rritur punësimin e qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj përmes ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që veprojnë në sektorë të ndryshëm.	Më parë, ka mbështetur mjedisin e favorshëm për gratë, duke përfshirë të drejtat pronësore dhe disponueshmërinë e kujdesit për fëmijë. Aktualisht, fokusohet në zhvillimin e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës, veçanërisht për të rinjtë, gratë dhe pakicat.
Sida	Programet e Zhvillimit Ekonomik, me vëmendje të punësimit. Të gjitha programet përfshijnë integrimin gjinor.	Mbështet Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë, që ka për qëllim t'i ofrojë studentëve shkathhtësi praktike, përvojë pune në mjediset shumetnike dhe njohuri mbi tregtinë dhe integrimin në BE, për të rritur punësueshmërinë. Studentët përgatiten vetëpunësim dhe punë në sektorin publik.
Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit	Ka Programin e Pragut që ka për synim të adresojë kufizimet ekonomike në Kosovë. Ka "Politikë Gjinore" standarde që përfshin kryerjen e analizave gjinore për të gjitha programet.	Ka publikuar raporte mbi anketën e fuqinë punëtore dhe të shfrytëzimit të kohës me të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë. Mbështet Qeverinë e Kosovës në mbledhjen e të dhënave të zbërthyer sipas gjinisë në këto fusha.
RrGK	Disa OGSHC anëtare të rritjes fokusohen te punësimi për gratë. Ka program për Fuqizimin Ekonomik të Grave, i cili adreson mjedisin e favorshëm, si të drejtat pronësore dhe disponueshmëria e kujdesit.	Ka bërë kërkime dhe avokon për ndryshime të Ligjit të punës, në drejtim të avancimit të barazisë gjinore. Avokon për vëmendjen ndaj kujdesit të papaguar në drejtim të rritjes së punësimit në radhët e grave në veçanti. Ka plane për të vazhduar avokimin për përmirësimin e mjedisit të favorshëm, ndryshimplotësimin e Ligjit të punës, masat afirmative në subvencionet shtetërore për gratë dhe trajtimin e diskriminimit në bazë gjinore në fuqinë punëtore nëpërmjet kërkimit, vetëdijesimit, dhe ndërgjyqësimit strategjik (2018-2022).
Demokracia për Zhvillim (D4D)	OSHC që punon në politikat publike dhe çështjet socio-ekonomike, ndër të tjera.	Ka botuar dy raporte në 2017 mbi joaktivitetin e grave në fuqinë punëtore dhe një anketë mbarëkombëtare mbi gatishmërinë e burrave për të marrë pushim prindëror. Do të vazhdojë të avokojë për ndryshime të Ligjit të punës.
Instituti Riinvest	Një organizatë think tank që përgatit raporte mbi çështjet socio-ekonomike.	Më parë, ka publikuar të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë për sektorin e turizmit. Ka botuar dy raporte në vitin 2017 mbi pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore. Do të vazhdojë kërkimet në këtë fushë, duke u fokusuar në aktivitetin e grave në fuqinë punëtore, duke përfshirë diskriminimin.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
QKSGJ	Kryen kërkime, duke përfshirë ato që lidhen me punësimin.	Ndër të tjera, ka kryer kërkime si <i>Politikat gjinore në shoqërinë civile dhe sektorin privat</i> (2017) dhe <i>Ndikimi i Ligjit të punës te gratë në Kosovë</i> (2011). Përfshihet në avokim lidhur me ndryshimet e Ligjit të punës.
Women 4 Women në Kosovë	OGSHC që mbështet gratë e marginalizuara.	Ka program që fokusohet në punësimin dhe fuqizimin ekonomik të grave.
Konkurrueshmëria dhe novacioni		
MTI	Siguron kushtet për industri dhe veprimtari tregtare dhe komerciale; krijon politika të punësimit në këta sektorë.	Ka nisur ca përpjekje fillestare për të institucionalizuar BPGJ-në. ⁴
USAID	Ndan fonde për disa programe lidhur me konkurrueshmërinë në Kosovë, duke përfshirë gjithmonë pikëpamjen gjinore.	Ka mbështetur MTI-në dhe programet e zhvillimit të sektorit privat që përfshijnë pikëpamje gjinore. Strategjia e ardhshme ende nuk është finalizuar.
ADA	Programi përfshin uljen e varfërisë përmes zhvillimit ekologjikisht të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.	Sipas Strategjisë së Vendi 2013-2020, ADA do të vazhdojë të mbështesë programet e zhvillimit ekonomik. Integron çështjet gjinore në të gjitha programet.
UNDP	Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm përfshin pikëpamje gjinore.	Shih pjesët për punësimin dhe bujqësinë, pasi ato lidhen me konkurrueshmërinë dhe novacionin.
GIZ	Shih më lart.	Projekti 2018-2020 për krijimin e punësimit përmes promovimit të eksportit përfshin pikëpamje gjinore.
Sida	Një nga prioritetet strategjike për vitet 2014-2020 është zhvillimi ekonomik.	Në kuadër të prioritetit të zhvillimit ekonomik, Sida mbështet zhvillimin e sektorit privat, si dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Të gjitha programet përfshijnë integrimin gjinor.
Banka Botërore	Projektet që fokusohen në forcimin e klimës së biznesit dhe në përmirësimin e konkurrueshmërisë kanë për synim të trajtojnë shkallën e lartë të papunësisë dhe të joaktivitetit të grave.	Nisma rajonale me fokus në përpilimin e hartës së pabarazive gjinore në lidhje me fuqizimin ekonomik të grave. Mbështetja e MPMS-së dhe Agjencisë Publike të Punësimit në hartimin dhe zbatimin e politikave të punësimit që synojnë rritjen e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore.
Misioni i OSBE-së në Kosovë	Ka një program që fokusohet në fuqizimin e grave që zotërojnë biznese.	Në vitin 2017, organizoi një panair në Prishtinë për gratë ndërmarrëse, ku ato shitën prodhimet e tyre. Gratë ndoqën trajnime për përpilimin e planeve të biznesit dhe propozimeve për projekte. OSBE-ja do të vazhdojë me këtë program.
Shoqata e Grave Afariste She-Era	OGSHC që punon për fuqizimin ekonomik të grave.	Më parë, është angazhuar në kërkime rreth ndërmarrësisë dhe bizneseve të grave; mbështet institucionet qeveritare në hartimin dhe zbatimin e politikave lidhur me barazinë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave.
Oda Ekonomike e Grave e Kosovës G7	Shoqatë e grave afariste në Kosovë.	Do të vazhdojë me mbështetje për anëtarët dhe interesimet e tyre.
STIKK	OSHC që ndihmon në krijimin e mjedisit më të mirë për biznesin e TIK-ut në Kosovë. Mbështet përmirësimin e standardeve dhe mundësive arsimore.	Do të përqendrohet në përmirësimin e standardeve dhe mundësive arsimore për gratë dhe burrat e interesuar për TIK. Në bazë periodike, mbledh të dhëna për sektorin e TIK-ut, të cilat zbërthehen sipas gjinisë.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
UNDP	Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm përfshin pikëpamje gjinore.	Ofron mbështetje financiare për Girls Coding Kosova (shih më poshtë)
Girls Coding Kosova	OGSHC që inkurajon gratë e reja që të kyçen në TIK dhe kodim. Punon për sendërtimin e sektorit të TIK-ut pa diskriminim.	Në të ardhmen, programet do të përqendrohen në fuqizimin dhe inkurajimin e grave për t'u përfshirë në sektorin e TIK-ut.
Bujqësia		
MBPZHR	Mandati përfshin zhvillimin e politikave dhe ligjeve për bujqësi dhe zhvillim rural. Lehtëson zhvillimin e skemave të kreditimit dhe granteve për mbështetje të veprimtarive në bujqësi dhe pylltari, të cilat kanë përfshirë masa afirmative për gjininë e nën-përfaqësuar.	Do të vazhdojë me zbatimin e përgjegjësi të veta. Ka ndërmarrë ca përpjekje për të institucionalizuar BPGJ-në. ⁵
PPSP	Përfshin aspektin gjinor në programin e vet në zhvillim e sipër.	Mbështet mundësitë në sektorin e frutave dhe perimeve të freskëta dhe të përpunuara; bimëve mjekësore dhe aromatike; dhe ëmbëlsirave.
Organizata për Ushqim dhe Bujqësi	Agjenci e OKB-së që ka për synim t'i japë fund urisë.	Ka ndarë kontratë për kryerjen e analizës së aspektit gjinor, mjeteve për jetesë dhe pylltarisë (2017). ⁶ Mbështetja për MBPZHR-në për të integruar pikëpamjen gjinore bazuar në këtë analizë.
ADA	Si pjesë e mbështetjes së saj për zhvillimin ekonomik, mbështet sektorin bujqësor.	Përfshin vëmendjen ndaj aspektit gjinor në të gjitha programet e saj, duke përfshirë bujqësinë.
USAID	Përmes programit Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale, fokusohet në rritjen e prodhimtarisë bujqësore, pranisë në treg dhe përgjegjshmërisë ndaj tregjeve.	Fokusohet në fuqizimin e grave dhe të rinjve brenda këtij programi, i cili do të vazhdojë deri në vitin 2020.
UNDP	Ka programe në sektorin e bujqësisë që përfshijnë promovimin e përfshirjes së grave.	Ofron qasje të barabartë për gratë dhe burrat në grante për nxitjen e zhvillimit rural dhe avancimin e mikro-ndërmarrjeve dhe fermat rurale. Ofron nisma për zhvillimin e kapaciteteve në bujqësi, tregti, zhvillim ekonomik lokal, marketing, brendim dhe prodhim bio dhe të gjelbër. Racionalizimi i themelimit të ndërmarrjeve sociale në prodhimin bujqësor dhe ofrimin e shërbimeve, duke u fokusuar në integrimin e grave të ndjeshme në tregun e punës.
GIZ	Zbaton projektin "Zhvillimi rural përmes resurseve të integruara pyjore dhe ujore".	Projekti do të përfshijë aktivitete specifike lidhur me fuqizimin ekonomik të grave.
RrGK	Disa OGSHC anëtare të rritit mbështesin gratë në sektorin e bujqësisë, veçanërisht në nivel lokal.	Ka mbështetur institucionalizimin e BPGJ-së në MBPZHR dhe ka avokuar për ndryshime. Do të vazhdojë me mbështetjen për gratë në zgjerimin e bizneseve të tyre të vogla dhe të mesme, duke përfshirë aplikimin për subvencione shtetërore, grante dhe hua.
IADK	OJQ që me aktivitetet e saj angazhohet për zhvillimin rural, për kushte më të mira socio-ekonomike në viset rurale, uljen e	Ka zbatuar projektin "Përkrahja dhe fuqizimi ekonomik i grave në komunat veriore të regjionit të Mitrovicës dhe regjionit ekonomik të jugut". Ndërhyrjet vejnë në shënjestrë gratë kryefamiljare që jetojnë në kushte të

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
	papunësisë dhe importeve, prodhimin e ushqimeve të shëndosha, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit.	rënda ekonomike. Ka përkrahur gratë në aplikimin për subvencione shtetërore për të mbështetur bizneset e tyre.
Energjia		
MCC	Programi i Pragut përfshin vëmendjen ndaj grave në sektorin e energjisë.	Ka kryer analizë gjinore për të informuar programin. Ka plane për të përdorur gjetjet për informimin e programimit sektorial në të ardhmen.
USAID	Mbështetja për sektorin e energjisë ka përfshirë pikëpamjen gjinore.	Ka mbështetur masa mbështetëse afirmative për gratë për qasje në trajnime dhe vende pune. Ka mbështetur Shoqatën e Grave në Sektorin Energjetik.
Mjedi		
MMPH	Përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin hapësinor. Duhet të integrojë pikëpamjen gjinore siç parashihet me LBGJ.	Ka ndërmarrë ca përpjekje për të institucionalizuar BPGJ-në. ⁷ Ka kryer analiza institucionale gjinore dhe ka hartuar planin e veprimit për avancimin e barazisë gjinore.
Sida	Mjedi dhe ndryshimet klimatike janë prioritet strategjik për 2014-2020. Integron çështjet gjinore në të gjitha programet.	Mbështetja për MMPH-në përfshin komponentin gjinor, që kohët e fundit ka kryer një analizë institucionale gjinore. ⁸ Ka plane për të kryer analizat të tjera gjinore në lidhje me mjedinë në periudhën 2018-2020 dhe për të avancuar integrimin gjinor brenda Ministrisë.
UNDP	Ka program për mjedinë, ndryshimet klimatike dhe rimëkëmbshmërinë pas fatkeqësive; përfshin aspektin gjinor në të gjitha programet.	Ka ndërmarrë analizën e ndryshimeve klimatike dhe riskut nga fatkeqësitë sipas gjinisë. ⁹
RrGK	Ka ca konsiderata mjedisore në programin e saj për shëndetësinë.	Raporti kërkimor <i>Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë</i> përmban informata lidhur me perceptimet mjedisore, kushtet dhe ndikimet e tyre të mundshme në shëndetësi, të zërthyer sipas gjinisë.
Shëndetësia		
Ministria e Shëndetësisë	Zhvillon dhe zbaton politikat që lidhen me shëndetin, kujdesin shëndetësor dhe qasjen në kujdesin shëndetësor për burrat dhe gratë.	Do të vazhdojë me zbatimin e roleve dhe përgjegjësi të veta sipas ligjit në fuqi.
Organizata Botërore e Shëndetësisë	Mbështet disa programe shëndetësore, duke përfshirë zhvillimin e politikave shëndetësore në lidhje me shëndetin e nënës dhe fëmijës.	Ka mbështetur kërkimin e RrGK-së <i>Qasja në kujdesin shëndetësor</i> dhe ka mbështetur mbledhjen e të dhënave të tjera lidhur me shëndetin të zërthyer sipas gjinisë.
UNFPA	Ka për synim mbrojtjen e të drejtave riprodhuese duke ndikuar në politika dhe legjislacion. Mbështet strategjitë që mund të forcojnë kapacitetet e ofruesve të shëndetit në lidhje me aspekte të ndryshme të shëndetit seksual dhe riprodhues.	Mbështet Koalicionin K10 dhe vepron në partneritet me OSHC-të që punojnë në çështjet shëndetësore. Mbështet institucionet shëndetësore me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, duke përfshirë pikëpamjen gjinore. Mbështet përpjekjet për ngritje të vetëdijes lidhur me shëndetin riprodhues.
Koalicioni K10	Koalicioni i dhjetë OSHC-ve që ka për qëllim përmirësimin e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe avancimin e të drejtave riprodhuese.	Si pjesë e strategjisë së tij, do të vazhdojë me ngritje të vetëdijes dhe avokim drejt përmirësimit të politikave publike dhe qasjes në kujdesin e shëndetit riprodhues, dhe angazhim për të drejtat riprodhuese.

Institucioni / Organizata	Rolet dhe përgjegjësitë	Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara për të adresuar pabarazitë gjinore
Aksioni për Nënë dhe Fëmijë	Mbështet nënat që të kenë shtatzëni të sigurt, duke synuar shpëtimin e jetëve të fëmijëve. Aktualisht bashkërendon veprimtarinë e Koalicionit K10.	Mbështet spitalet me pajisje; qendrat e mjekësisë familjare në disa komuna; dhe angazhohet për ngritje të vetëdijes, duke përfshirë orët edukative për nënat për vetëdijesim rreth planifikimit familjar dhe shtatzënisë së shëndetshme.
RrGK	Strategjia përfshin programin për përmirësimin e shëndetit të gruas. Disa OGSHC anëtare të rrjetit përqendrohen në ngritjen e vetëdijes dhe mbështetjen e qasjes së grave në kujdesin shëndetësor, veçanërisht në zonat rurale. Anëtare e K10.	Ka kryer kërkimin <i>Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë</i> Avokon për rekomandimet e dala nga kërkimi, ndër çështje të tjera, në nivel lokal dhe kombëtar, së bashku me anëtarët dhe Lobin për Barazi Gjinore. Ka avokuar për qasje ndaj depistimit për kancer dhe reparteve të lindjes. Strategjia e re do të përfshijë vazhdimin e punës drejt qëllimeve të ngjashme.
Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit JETA/VITA	Synon ngritjen e vetëdijes rreth kancerit të gjirit. Anëtare e K10.	Mbështet gratë që vuajnë nga kanceri dhe ngre vetëdijen rreth kancerit të gjirit përmes mediave, punëtorive, debateve publike dhe marsheve vjetore në Ditën Ndërkombëtare të Luftës kundër Kancerit të Gjirit.
Shoqata e Mamive të Kosovës	Promovon, avancojnë dhe mbron të drejtat e mamive dhe fuqizojnë rolin e tyre në Kosovë.	Ka bashkëpunuar me të tjerët për të avokuar për qasje në reparte të lindjes në zonat rurale. Do të vazhdojë të punojë për forcimin e rolit të mamive dhe mbrojtjen e tyre nga padrejtësitë e mundshme në punë.
Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë	Synon të fuqizojë të rinjtë pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, feja, seksualiteti ose kategoria tjetër shoqërore përmes programeve që rrisin shkathhtësitë e tyre për lidhshmëri duke promovuar të drejtat e njeriut dhe qytetarinë aktive. Anëtar i K10.	Programet trajtojnë fuqizimin dhe punësimin e të rinjve, vullnetarizmin, barazinë gjinore, novacionin social dhe ndërmarrësinë, mbrojtjen e mjedisit, kundërvënien ndaj dhunës dhe stilin e jetës së shëndetshme. Ngre vetëdijen e të rinjve rreth shëndetit riprodhues. Në kuadër të Iniciativës së Burrave të Rinj, punon drejt "Angazhimit të burrave në atësi" dhe ofron trajnim për punonjësit socialë dhe stafin mjekësor për atësinë.
Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore	Ndihmon personat LGBTQI.	Do të vazhdojë me sigurim të depistimit të sëmundjeve dhe lehtësim të qasjes në kujdesin shëndetësor. Do të vazhdojë me programin e saj për parandalimin e HIV-it.

Shtojca 5. Kërkesat e Analizës Gjinore dhe Termat e Referimit

Në përputhje me Shënimin Udhëzues të ofruar nga Komisioni Evropian,¹⁰ Analiza Gjinore duhet të marrë parasysh kërkesat e përfshira më poshtë, fjalë për fjalë.

Komisioni Evropian përkufizon analizën gjinore si studim të dallimeve në kushte, nevoja, shkallë të pjesëmarrjes, qasje në resurse dhe zhvillim, kontroll të pasurisë, kompetenca vendimmarrëse, etj. midis vajzave/grave dhe djemve/burrave në rolet e tyre të caktuara gjinore.

E RËNDËSISHME: Në kontekstin e objektivave të PVGJ II, analiza gjinore pritet të identifikojë se në cilat objektiva tematike të PVGJ II (minimum tre, nga një për çdo prioritet tematik) do të kontribuojë delegacioni ose njësia në fjalë për periudhën 2016-20. Kjo është e detyrueshme.

Analiza mund të jetë në formën e:

- a) Profilit të vendit, ndonëse ky ka të ngjarë të jetë i dobishëm vetëm në një kontekst ku parashikohet mbështetja e përgjithshme buxhetore ose programimi i përbashkët. Ai sjell riskun e të qenit tejet i përgjithshëm për të informuar programimin në mënyrë adekuate.
- b) Studimit të dedikuar që shqyrton secilin sektor të përqendrimit në mënyrë që të identifikojë objektivat tematike të PVGJ II që mund të ndiqen, dhe që ofron analizë të mjaftueshme për programet e ardhshme të përveçme në atë fushë të përqendrimit.
- c) Analizës gjinore të dedikuar dhe të përveçme për secilin program të ri.
- d) Identifikimit se si të përfshihet aspekti gjinor në të gjitha analizat e kontekstit në fazën e formulimit dhe si të përfshihet ekspertiza gjinore në misionet e formulimit.

Nëse është e nevojshme, analiza mund të mbetet për përdorim të brendshëm (për shkak të natyrës së ndjeshme të disa prej çështjeve).

Analiza duhet të ofrojë:

- Të paktën një objektiv për fushë tematike
- Statistikat kyçe mbi situatën e grave dhe vajzave, burrave dhe djemve, të cilat gjithashtu do të sigurojnë pikënisjen për matjet e ardhshme (statistikat përkatëse që pasqyrojnë fushat tematike apo të përqendrimit).
- Barrierat kyçe për arritjen e barazisë gjinore (duke përfshirë normat shoqërore, aspektin legjislativ, kapacitetin institucional, vullnetin politik, etj.)
- Analizë të niveleve tjera të diskriminimit (p.sh. ndjeshmëria e veçantë e grave me aftësi të kufizuara ndaj dhunës)
- Hartën e aktorëve aktivë (OJQ-të, donatorët, institucionet financiare ndërkombëtare, ministrinë e linjës, etj.)
- Hartën e boshllëqeve në njohuri/informacion (p.sh. informatat statistikore të zbërthyera sipas moshës-seksit)
- Vlerësim të qartë se ku mund të japë vlerë të shtuar DBE-ja
- Objektiva/mundësi reale për dialog politik dhe të politikave

Objektivi i analizës gjinore:

Analiza gjinore do të ofrojë kuptim nëse pabarazitë gjinore vazhdojnë [në Kosovë] dhe shkaktohet për këtë, si ato gërshetohen me pabarazitë e tjera, si këto ndikojnë në gëzimin e të drejtave të njeriut dhe/ose përfitimeve të krijuara nga përpjekjet për zhvillim dhe nga qasja në përpjekjet për zhvillim, si dhe kuptim rreth zotimit dhe kapacitetit të qeverive partnere për të punuar në çështjet e BGJFG-së [barazia gjinore dhe fuqizimi i grave].

Analiza duhet të përmbajë pjesët si vijon:

1) Shënim metodologjik

2) Gjendja aktuale

- a. Kuadri ligjor dhe i të drejtave të njeriut (në nivel rajonal, kombëtar ose lokal): Mbrojtja dhe gëzimi i plotë i të gjitha të drejtave të njeriut nga gratë, vajzat, burrat dhe djemtë në vend (pra, në çështje si trashëgimia, zotërimi i tokës, statusi, martesë, ligjet e punës, dhuna - veçanërisht dhuna në bazë gjinore, e drejta tradicionale kundrejt të drejtës civile, etj.).
- b. Kuadri i politikave: Formulimi dhe dizajnimi i politikave kombëtare të barazisë gjinore dhe niveli efektiv i zbatimit të tyre, si dhe mënyra sesi përfshirja e aspektit gjinor është inkorporuar në politikat e sektorëve tjerë.
- c. Mjedisi politik: Procesi i transformimit, pjesëmarrja dhe qasja në pushtet, përfaqësimi dhe pjesëmarrja në kuvende në nivel komunal dhe kombëtar, pushteti lokal, mbrojtja dhe siguria, etj.
- d. Gjendja e përgjithshme ekonomike: Politikat dhe reformat ekonomike, shpenzimet publike (d.m.th. rezultatet e buxhetit gjinor), shpenzimet e sektorit shoqëror, investimet publike, subvencionet e mirëqenies sociale, punësimi dhe puna në sektorin formal dhe joformal, etj.
- e. Gjendja socio-ekonomike: Gjendja e varfërisë, shpërndarja e të ardhurave, gjendja demografike, ofrimi dhe qasja në shërbime dhe resurse përgjatë gjithë ciklit jetësor (d.m.th. shëndetësia - përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues, arsimin, sistemet e jetesës, aftësinë e kufizuar) etj.
- f. Konteksti socio-ekonomik: Grupet etnike dhe fisnore, struktura familjare (në veçanti familjet ku gruaja është kryefamiljare), fëmijët (veçanërisht vajzat), të rinjtë, puna e migrantëve, siguria ushqimore, banimi dhe zhvillimi urban, sistemet e jetesës, ligjet tradicionale etj. Duhet të merren parasysh mospërputhjet etnike/fisnore me rëndësi të veçantë.
- g. Qeveria, shoqëria civile (në veçanti organizatat e grave), komuniteti ndërkombëtar dhe reagimi i sektorit privat: Veprimet përkatëse të ndërmarra dhe të planifikuara nga aktorët kryesorë për të adresuar çështjet e identifikuara më parë.

3) Çështjet specifike dhe strategjitë e reagimit

- a. Përzgjedhja e objektivave nga PVGJ II ku duhet të kontribuohet përmes programeve ekzistuese
- b. Përshtatja e programeve për t'i mësyre këto objektiva dhe për t'i matur ato në mënyrë adekuate
- c. Dizajnimi/formulimi i veprimeve të reja aty ku është relevante dhe e mundur.
- d. Identifikimi i rezultateve për barazi gjinore që do të arrihen përmes programeve ekzistuese
- e. Sigurimi i monitorimit adekuat dhe evidentimit të të dhënave
- f. Identifikimi i resurseve ku është e nevojshme

Raporti do të vlerësohet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- Përmbushja e nevojave: A e trajton analiza gjinore në mënyrë adekuate dhe të qartë informacionin dhe a i përmbahet termave të referimit?
- Të dhëna të besueshme: A janë adekuate dhe mjaftueshëm të besueshme të dhënat e përzgjedhura parësore dhe dytësore?
- Analiza e shëndoshë: A është analizuar në mënyrë të duhur dhe sistematike analiza e informacionit sasior dhe cilësor?
- Propozime të dobishme: A janë të drejta dhe mjaftueshmërisht të detajuara rekomandimet për t'u zbatuar në mënyrë operative?

Dokumenti duhet të ketë deri në 50 faqe.

Termet e referimit

Konteksti

Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit (MSA), e cila hyri në fuqi në qershor 2016, Qeveria e Kosovës ka adoptuar Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA). Ndërsa PKZMSA-ja e parë e adoptuar në vitin 2016 kishte shumë pak referenca ndaj aspektit gjinor, në versionin e rishikuar të vitit 2017 janë shtuar disa referenca. Sidoqoftë, pikëpamja gjinore ende nuk është përfshirë mjaftueshëm në procesin e MSA-së në Kosovë, edhe pse kjo paraqet detyrim në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore:

Institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legislative dhe masat tjera duke përfshirë: 1.1. analizën e statusit të femrave dhe meshkujve në organizatat dhe fushat përkatëse; 1.2. miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për barazi gjinore; [dhe] 1.3. përfshirjen e integritit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion.

Kështu, PKZMSA-ja dhe të gjitha politikat dhe programet që lidhen me procesin e MSA-së të Kosovës duhet të përfshijnë analizën dhe shqyrtimin gjinor, drejt integritit të aspektit gjinor brenda tyre.

Zyra e Bashkimit Evropian (ZBE) ofron mbështetje financiare për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës në shënimin e përparimit drejt përmbytjes së kriterëve të MSA-së, duke përfshirë atë përmes Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimi (IPA), në mesin e mjeteve tjera. Dokumenti Strategjik Indikativ i IPA-s për Kosovën 2014-2020 (DSI) ka paraqitur prioritetet për asistencën financiare të BE-së në mbështetje të Kosovës për përmbytjen e kriterëve të aderimit gjatë periudhës 2014-2020. Në vitin 2016, është kryer rishikimi afatmesëm, që ka çuar në ndryshime të DSI-së, duke përfshirë disa përpjekje për integrimin e aspektit gjinor në DSI. Ndërkohë, është në zbatim e sipër ushtrimi i programimit lidhur me programet e ardhshme të mbështetura nga BE-ja, me zhvillimin, përditësimin dhe finalizimin e Dokumenteve të Planifikimit Sektorial (DPS) deri në qershor 2017. Në kuadër të çdo programi vjetor, Dokumentet e Veprimit (DV) përcaktojnë arsyeshmërinë e çdo Veprimi individual, objektivat specifike të tyre, aktivitetet e planifikuara dhe aranzhimet zbatuese (p.sh. llojet e financimit), ndër të tjera. Këto janë dokumente koncize, të cilat përfshijnë Matricën e Kuadrit Logjik (Logframe) si pjesë kyçe që përshkruan logjikën e ndërhyrjes. Për programin vjetor IPA 2018, identifikimi i veprimeve fillon në qershor të vitit 2017.

Ndërkohë, “Dokumenti i përbashkët i punës i stafit - Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: Transformimi i jetëve të vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020”, i njohur edhe si Plani i Veprimit Gjinor (PVGJ) të BE-së, u adoptua në vitin 2015. Ai përmban objektivin që: “Dëshmi të palëkundshme gjinore përdoren për të informuar të gjitha shpenzimet, programimin dhe politikë-bërjen e jashtme të BE-së”, duke përfshirë që “programet tematike, dypalëshe dhe rajonale përdorin analizën gjinore”, si dhe “konsultimet me mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore, OSHC-të, organizatat e grave” informojnë dizajnimin e veprimeve. Një nga treguesit e PVGJ-së të BE-së është aplikimi sistematik i shënjesit të politikave për barazi gjinore të OECD-së (G-marker), me zotimin ambicioz që 85% e programeve të reja do të shënohen me “1” ose “2” deri në vitin 2020. Në mënyrë që një program të shënohet me “1”, kriteri minimal është që programi ka përfshirë kryerjen e analizës gjinore gjatë fazës së planifikimit. Prandaj, ekziston nevoja urgjente për analizë gjinore për të informuar të gjitha programet me fonde nga ZBE-ja.

Në këtë kontekst, nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) u kërkua ta kryejë këtë analizë gjinore si pjesë e mbështetjes teknike të vazhdueshme që Rrjeti ofron me angazhim me kontratë për ZBE-në, Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), Ministrinë e Integritit European (MIE), dhe ministritë e linjës në kuadër të “Asistencës për integrimin e aspektit gjinor në programimin IPA 2016 në Kosovë”. Sipas kësaj kontrate, kjo analizë gjinore do të shërbejë si përditësim i edicionit të fundit të *Profilit Gjinor të Vendit*, i cili u hulumtua dhe u publikua në fillim të vitit 2014.¹¹ Edicioni i ri i kërkuar i “analizës gjinore” i përgjigjet thirrjes që bën PVGJ-ja e BE-së për analiza gjinore, dhe vjen në një kohë të rëndësishme për informimin e programimit të ardhshëm të IPA-s, si dhe përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për të shfrytëzuar më mirë

analizat gjinore në informimin e ligjeve, politikave dhe programeve të saj. Duhet të theksohet se ABGJ-ja në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) ka në plan të bëjë kërkime dhe të përpilojë edicionin e ri të *Profilit Gjinor të Vëndit* në 2018 me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Megjithatë, ZBE-ja ka kërkuar që kjo analizë e veçantë gjinore në përputhje me PVGJ-në të kryhet në vitin 2017, pasi që nevojitet urgjentisht informacioni specifik sipas sektorëve në veçanti për të informuar programimin aktual dhe të ardhshëm. Gjithashtu, ka të ngjarë që dy dokumentet do të kenë dallime për nga përmbajtja.

Kjo analizë gjinore synon të ofrojë informacion të konsoliduar dhe aktual në lidhje me situatën e grave dhe burrave në Kosovë, veçanërisht në lidhje me sektorët që marrin mbështetje nga BE-ja. Ajo do të shërbejë si dokument thelbësor për informimin e punës së ZBE-së, ministrive të linjës, donatorëve dhe aktorëve të tjerë në Kosovë. Analiza do të fokusohet në sektorët e IPA II të cilët mbulohen nga Dokumenti i Strategjisë Indikative të IPA-s për Kosovën 2014-2020. Meqenëse ndërhyrja e BE-së bazohet në këta sektorë, analiza do të përqendrohet në identifikimin e përparësive dhe mangësive në strategjitë sektoriale të Kosovës, nga pikëpamja gjinore.

Përfshirja e hisedarëve

Ky proces synon të jetë pjesëmarrës dhe konsultativ, duke siguruar që kjo analizë gjinore merr parasysh nevojat e informacionit të hisedarëve të llojllojshëm. Për këtë arsye, RrGK-ja do të ndërmarrë konsultime me ABGJ-në, MIE-në, ministrinë e linjës, zyrtarët për barazi gjinore, ambasadat e huaja, duke përfshirë veçanërisht Shtetet Anëtare të BE-së siç parashihet në PVGJ-në e BE-së, agjencitë e OKB-së, donatorët, shoqërinë akademike dhe organizata të llojllojshme të shoqërisë civile, përfshirë organizatat e grave në planifikimin, zbatimin dhe shqyrtimin e kësaj analize gjinore. Sigurimi i konsultimeve me mekanizmat kombëtarë për barazi gjinore dhe organizatat e grave kërkohet nga PVGJ-ja e BE-së.

Metodologjia

Metodologjia do të përbëhet nga shqyrtimi i gjerë në tavolinë, analiza e të dhënave parësore dhe dytësore, si dhe takimet me hisedarë. Kjo do të përfshijë shqyrtimin e statistikave të zbërthyer sipas gjinisë, të publikuara nga qeveria, si dhe raporte të ndryshme kërkimore të botuara nga organizatat vendase dhe ndërkombëtare.

Qëllimet

- 1) Të kuptohet më mirë barazia (dhe pabarazitë) gjinore në të gjitha nivelet në lidhje me ligjet, politikat, praktikat dhe programet e Kosovës në të gjithë sektorët.
- 2) Të rekomandohen hapa konkretë drejt adresimit të pabarazive të identifikuara, duke përfshirë objektivat, treguesit dhe caqet.

Shtojca 6. Të dhëna shtesë që lidhen me secilin sektor

Kjo Shtojcë përmban të dhëna shtesë, të organizuara sipas sektorëve. Aty ku mungojnë të dhënat ose potencialisht janë problematike, vihet re.

Demokracia dhe Qeverisje

Kuvendet Komunale të Kosovës

Gratë e zgjedhura në Kuvendin e Kosovës me kuotë dhe vota preferenciale¹²

Viti i Zgjedhjeve	Gjithsej gratë e zgjedhura	Të zgjedhura me kuotë	%	Të zgjedhura me votë preferenciale	%
2007	37	20	54%	17	46%
2010	40	25	68%	15	38%
2014	39	19	51%	20	51%
2017	38	17	46%	21	55%

Anëtarët e Kuvendit të Kosovës sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë, krahasuar me proporcionin e popullsisë (2017)¹³

Etniciteti	% e popullsisë gra	% e Grave në Kuvend		% e popullsisë burra	Burrat në Kuvend		Gjithsej % e popullsisë	Gjithsej në Kuvend në bazë të etnicitetit	
		#	%		#	%		#	%
Shqiptar	46.1%	31	25.8%	46.8%	69	57.5%	92.9%	100	83.3%
Serb	0.7%	4	3.3%	0.7%	7	5.8%	1.5%	11	9.2%
Rom	0.3%	0	0.0%	0.3%	1	0.8%	0.5%	1	0.8%
Ashkali	0.4%	0	0.0%	0.5%	2	1.7%	0.9%	2	1.7%
Egjiptian	0.3%	0	0.0%	0.3%	1	0.8%	0.7%	1	0.8%
Boshnjak	0.8%	2	1.7%	0.8%	1	0.8%	1.6%	3	2.5%
Turq	0.5%	1	0.8%	0.5%	1	0.8%	1.1%	2	1.7%
Goran	0.3%	0	0.0%	0.3%	0	0.0%	0.6%	0	0.0%
Gjithsej	49.4%	38	31.7%	50.2%	82	68.3%	99.8%	120	100.0%

Anëtarët e Kuvendeve Komunale sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë krahasuar me proporcionin e popullsisë (2017)

Etniciteti	% e popullsisë gra	# dhe % Grave në Kuvende	% e popullsisë burra	# dhe % e burrave në Kuvende	Gjithsej % e popullsisë	Gjithsej # dhe % e Asambleistëve
Shqiptar	46.1%	286 (28.7%)	46.8%	522 (52.3%)	92.9%	808 (81.0%)
Serb	0.7%	56 (5.6%)	0.7%	102 (10.2%)	1.5%	158 (15.8%)
Rom	0.3%	0 (0%)	0.3%	0 (0%)	0.5%	0 (0%)
Ashkali	0.4%	0 (0%)	0.5%	2 (0.2%)	0.9%	2 (0.2%)
Egjiptian	0.3%	0 (0%)	0.3%	1 (0.1%)	0.7%	1 (0.1%)
Boshnjak	0.8%	3 (0.3%)	0.8%	4 (0.4%)	1.6%	7 (0.7%)
Turq	0.5%	7 (0.7%)	0.5%	11 (1.1%)	1.1%	18 (1.8%)
Goran	0.3%	1 (0.1%)	0.3%	3 (0.3%)	0.6%	4 (0.4%)
Gjithsej	49.4%	353 (35.4%)	50.2%	645 (64.6%)	99.8%	998 (100%)

Të dhënat e ndara sipas moshës dhe gjinisë mbi tendencat e pjesëmarrjes së votuesve 2009-2014 për personat 18-29 vjeçarë ¹⁴

Grupmosha e votuesve	2009		2010		2013		2014		Të gjitha votat brenda grupmoshave
	Burra (%)	Gra (%)	Burra (%)	Gra (%)	Burra (%)	Gra (%)	Burra (%)	Gra (%)	
Të gjitha moshat	46%	37%	49%	38%	42%	49%	46%	36%	43%
18-21	55%	45%	58%	46%	51%	61%	54%	46%	52%
22-25	49%	34%	53%	35%	46%	50%	50%	37%	44%
26-29	43%	28%	47%	28%	40%	41%	45%	29%	38%

Emërimet Politike dhe Administrata Publike

Punonjësit/Punëtorët në nivelin qendror sipas gjinisë. 2017¹⁵

Institucioni	Gjithsej punonjësit	Burra (%)	Gra (%)
Zyra e Kryeministrit	550	56%	44%
MMPH	301	63%	37%
MTI	277	75%	25%
Ministria e Shëndetësisë	607	40%	60%
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	297	49%	51%
Ministria e Infrastrukturës	277	75%	25%
MPMS	785	56%	44%
Ministria e Administratës Publike	259	61%	39%
MASHT	566	56%	44%
Ministria e Financave	1,029	64%	36%
MBZHR	340	71%	29%
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	136	60%	40%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	133	54%	46%
Ministria për Komunitete dhe Kthim	87	66%	34%
Ministria e Punëve të Jashtme	258	68%	32%
Ministria e Drejtësisë	443	61%	39%
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës	167	73%	27%
Ministria e Punëve të Brendshme	935	58%	42%
Ministria e Diasporës	49	59%	41%
MEI	65	51%	49%
Presidenca	43	63%	37%
Sekretariati i Kuvendit të Kosovës	178	54%	46%
Dogana	73	63%	37%
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	72	71%	29%
Auditori i Përgjithshëm i Kosovës	25	52%	48%
Institucioni i Avokatit të Popullit	48	54%	46%
Universiteti i Prishtinës	398	49%	51%
Gjykata Kushtetuese	41	49%	51%
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1,089	45%	55%
Akademia e Drejtësisë së Kosovës	23	39%	61%
Këshilli Prokurorial i Kosovës	420	38%	62%
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	19	47%	53%
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	7	57%	43%
Komisioni i Pavarur i Mediave	29	48%	52%
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	69	68%	32%
Njësia për Intelejencë Financiare	18	61%	39%
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	28	54%	46%
Organi Shqyrtues i Prokurimit	18	61%	39%
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	26	42%	58%
Agjencia Kundër Korrupsionit	39	62%	38%

Institucioni	Gjithsej punonjësit	Burra (%)	Gra (%)
Agjencia Kosovare e Pronës	205	65%	35%
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës	27	63%	37%
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës	18	50%	50%
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	12	75%	25%
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	18	67%	33%
Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	33	70%	30%
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	15	67%	33%
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	9	56%	44%
Zyra e Rregullatorit për Energji	17	47%	53%
Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	12	67%	33%
Agjencia Kosovare e Privatizimit	247	55%	45%
Gjithsej	11,918	58%	42%

Punonjësit në pozita udhëheqëse në ministri dhe institucione të tjera të nivelit qendror sipas gjinisë. 2017 ¹⁶			
Institucioni	Total # i punëtorëve	Burra (%)	Gra (%)
Zyra e Kryeministrit	131	73%	27%
Ministria e Forcave të Sigurisë	36	75%	25%
MTI	62	74%	26%
Ministria e Shëndetësisë	82	50%	50%
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	58	69%	33%
Ministria e Infrastrukturës	42	88%	12%
MPMS	87	79%	21%
Ministria e Administratës Publike	45	67%	33%
MASHT	90	78%	22%
Ministria e Financave	209	73%	27%
MBPZHR	47	79%	21%
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	31	77%	23%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	23	61%	39%
MMPHK	62	69%	31%
Ministria e Drejtësisë	92	72%	28%
Ministria e Punëve të Brendshme	190	81%	19%
Ministria e Punëve të Jashtme	26	73%	27%
Ministria për Komunitete dhe Kthim	25	48%	12%
MEI	23	70%	30%
Ministria e Diasporës	15	93%	20%
Kuvendi i Kosovës	53	62%	38%
Presidenca	32	56%	44%
Gjithsej	1,461	72%	27%

Të dhënat e ndara sipas gjinisë për të punësuarit në misionet diplomatike 2014-2015 ¹⁷								
Pozita	2014				2015			
	Burra (#)	Gra (#)	Burra (%)	Gra (%)	Burra (#)	Gra (#)	Burra (%)	Gra (%)
Ambasadorë	20	4	80%	20%	15	7	68%	32%
Ministër Këshilltarë /Konsuj të përgjithshëm	16	3	86%	16%	16	2	89%	11%
Këshilltarë	12	6	67%	33%	16	6	73%	27%
Konsull / Sekretarët e parë	29	8	78%	22%	21	6	78%	22%
Zëvendës Konsuj / Sekretarë të Dytë	16	2	89%	11%	13	6	68%	32%
Sekretarët e tretë	2	3	40%	60%	2	0	100%	0%
Gjithsej	95	26	73%	27%	83	27	79%	21%

Nëpunësit civil në nivel qendror të ndarë sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë, 2017¹⁸

Etneciteti	Gra			Burra			Totali
	#	% e grupit etnik	% e përgjithshme	#	% e grupit etnik	% e përgjithshme	
Shqiptar	1,311	42%	38%	1,834	58%	53%	3,145
Ashkali	0	0%	0%	1	100%	0.0%	1
Boshnjak	24	57%	0.7%	18	43%	0.5%	42
Kroat	1	50%	0.0%	1	50%	0.0%	2
Egjiptian	0	0%	0.0%	1	100%	0.0%	1
Goran	4	67%	0.1%	2	33%	0.1%	6
Malazez	0	0%	0.0%	1	100%	0.0%	1
Rom	4	80%	0.1%	1	20%	0.0%	5
Serb	56	25%	1.6%	170	75%	4.9%	226
Turq	37	73%	1.1%	14	27%	0.4%	51
Gjithsej	1,437	41%	41%	2,043	59%	59%	3,480

Të dhënat e ndara sipas gjinisë për stafin e administratës së nivelit lokal 2017¹⁹

Komuna	Pozita Udhëheqëse					Stafi				
	Burra	%	Gra	%	Gjithsej	Burra	%	Gra	%	Gjithsej
Deçan	23	92%	2	8%	25	108	78%	30	22%	138
Dragash	17	89%	2	11%	19	87	88%	12	12%	99
Ferizaj	40	73%	15	27%	55	193	64%	108	36%	301
Fushë-Kosovë	8	53%	7	47%	15	67	58%	49	42%	116
Glllogovc	19	59%	13	41%	32	79	63%	47	37%	126
Gjakovë	21	78%	6	22%	27	139	65%	74	35%	213
Gjilan	29	97%	1	3%	30	239	68%	110	32%	349
Istog	23	72%	9	28%	32	105	67%	51	33%	156
Kaçanik	11	69%	5	31%	16	97	80%	25	20%	122
Kamenicë	35	95%	2	5%	37	158	84%	30	16%	188
Klinë	15	83%	3	17%	18	102	78%	29	22%	131
Lipjan	17	68%	8	32%	25	102	65%	56	35%	158
Malishevë	25	86%	4	14%	29	148	83%	30	17%	178
Mitrovicë	31	89%	4	11%	35	206	59%	145	41%	351
Mitrovica e Veriut						29	51%	28	49%	57
Novobërd	19	90%	2	10%	21	25	45%	31	55%	56
Obiliq	16	59%	11	41%	27	35	65%	19	35%	54
Pejë	28	65%	15	35%	43	73	55%	59	45%	132
Podujevë	23	96%	1	4%	24	198	56%	157	44%	355
Prishtinë	30	79%	8	21%	38	186	72%	74	28%	260
Prizren	25	74%	9	26%	34	281	54%	239	46%	520
Rahovec	20	91%	2	9%	22	303	69%	134	31%	437
Skënderaj	21	95%	1	5%	22	148	86%	24	14%	172
Suharekë	27	87%	4	13%	31	124	74%	44	26%	168
Shtërpce	14	78%	4	22%	18	156	73%	57	27%	213
Shtime	11	85%	2	15%	13	44	64%	25	36%	69
Viti	21	88%	3	13%	24	70	69%	32	31%	102
Vushtrri	28	85%	5	15%	33	134	81%	31	19%	165
Hani i Elezit	10	91%	1	9%	11	194	75%	65	25%	259
Mamushë	8	67%	4	33%	12	40	91%	4	9%	44
Junik	7	70%	3	30%	10	22	71%	9	29%	31
Partesh	7	88%	1	13%	8	37	79%	10	21%	47
Ranillug	12	86%	2	14%	14	28	68%	13	32%	41
Leposaviq						29	78%	8	22%	37
Zubin Potok						36	82%	8	18%	44
Zveçan						31	44%	39	56%	70

Kllokot	7	78%	2	22%	9	79	62%	48	38%	127
Gračanicë	6	60%	4	40%	10	118	52%	108	48%	226
Gjithsej	654	80%	165	20%	819	4,250	67%	2,062	33%	6,312

Nëpunësit civil në nivel komunal të ndarë sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë, 2017²⁰

Etniciteti	Gra			Burra			Gjiths ej
	#	% e Përkatësisë etnike	% e përgjithshme	#	% e Përkatësisë etnike	% e përgjithshme	
Shqiptar	26	23%	4.3%	89	77%	14.6%	115
Ashkali	5	36%	0.8%	9	64%	1.5%	14
Boshnjak	29	28%	4.8%	74	72%	12.2%	103
Egjiptian	0	0%	0.0%	12	100%	2.0%	12
Goran	3	50%	0.5%	3	50%	0.5%	6
Malazez	1	33%	0.2%	2	67%	0.3%	3
Rom	1	6%	0.2%	15	94%	2.5%	16
Serb	11	40%	19.4%	17	60%	29.1%	295
	8			7			
Turq	26	59%	4.3%	18	41%	3.0%	44
Gjithsej	209	34%	34.4%	399	66%	65.6%	608

Partitë Politike

Përfaqësimi i Grave në Partitë Politike, 2014²¹

Partia Politike	% e grave në Presidencë	% e grave në Këshillin e Përgjithshëm	% e anëtareve gra
VV	23%	22%	21%
AKR	21%	26%	--
AAK	30%	30%	30%
PDK	16%	29%	--
LDK	20%	23%	--
Gjithsej	22%	26%	--

Arsyet për mungesën e mundësive të barabarta për promovimin e grave krahasuar me burra²²

Arsyet	% e atyre që janë pajtuar
Besojnë që burrat janë liderë më të mirë	47%
Burrat janë më të përshtatshëm	7%
Besojnë se gratë nuk kanë kohë të mjaftueshme për shkak të obligimeve familjare	18%
Nepotizëm	13%
Mungesa e përkrahjes politike	16%

Të dhënat mbi sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore

Drejtësia dhe Institucionet Përgjegjëse

Policia e Kosovës sipas rajonit dhe gjinisë, 2017²³

Regjioni	Gra	Gra %	Burra	Burra %	Totali
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës	382	15%	2098	85%	2480
Ferizaj	78	15%	445	85%	523
Gjilan	123	19%	524	81%	647
Mitrovica e Veriut	78	14%	468	86%	546
Mitrovicë	80	16%	432	119%	512
Pejë	86	13%	553	87%	639
Policia Kufitare	99	7%	1226	93%	1325
Prishtinë	232	19%	987	81%	1219
Prizren	63	11%	496	89%	559
Gjakovë	25	7%	345	93%	370
Gjithsej	1246	14%	7574	86%	8820

Policia e Kosovës sipas pozitave dhe gjinisë, 2017 ²⁴					
Pozita	Gra	Gra %	Burra	Burra %	Totali
Drejtorë të Policisë	0	0%	1	100%	1
Kadetë					
Kapitenë	8	6%	127	94%	135
Kolonelë	2	11%	15	83%	18
Majorë	4	8%	46	92%	50
Togerë Kolonelë	3	8%	36	90%	40
Rreshterë	114	10%	1032	90%	1146
Staf Civil	364	34%	715	66%	1079
Togerë	36	10%	327	90%	363
Zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm të Policisë			2	100%	

Prokurorët sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, 2017 ²⁵							
	Gra	%	Burra	%	Shqiptar	Serb	Boshnjak
Prokurorë të Shtetit	2	33%	4	67%	6		
Prokurorë të Apelit	1	17%	5	83%	5		1
Prokuroria Themelore Prishtinë	26	48%	28	52%	53	1	
Prokuroria Themelore Prizren	7	35%	13	65%	20		
Prokuroria Themelore Pejë	9	56%	7	44%	15		1
Prokuroria Themelore Mitrovicë	4	33%	8	67%	11	1	
Prokuroria Themelore Gjakovë	3	25%	9	75%	12		
Prokuroria Themelore Gjilan	6	35%	11	65%	17		
Prokuroria Themelore Ferizaj	2	17%	10	83%	12		
Prokuroria Speciale	4	33%	8	67%	12		
Kryesuesë të Këshillit Prokurorial		0%	1	100%	1		
Totali	63	31%	138	69%			

Gjyqtarët sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, 2017 ²⁶									
	Gra	%	Burra	%	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Goran	RAE ²⁷
Kryetarë të Gjykatës	1	10%	9	90%	10				
Gjykata Supreme	9	36%	16	64%	23	1	1		
Gjykata Kushtetuese									
Gjykata e Apelit	10	28%	26	72%	34	1	1		
Gjykata Themelore Prishtinë	40	40%	60	60%	98	1	1		
Gjykata Themelore Prizren	11	24%	35	76%	40		5		1
Gjykata Themelore Pejë	11	27%	30	73%	41				
Gjykata Themelore Mitrovicë	5	17%	25	83%	26	3			
Gjykata Themelore Gjakovë	6	22%	21	78%	27				
Gjykata Themelore Gjilan	7	21%	27	79%	34				
Gjykata Themelore Ferizaj	8	26%	23	74%	30			1	
Kryesuesë të Këshillit Gjyqësor	1	10%		90%	1				
Numri total i gjykatësve	94	36%	258	64%					

Kërkesat për Udhër Mbrojtje të Përpiluara nga Mbrojtësit e Viktimave, 2016 ²⁸	
Lloji i Kërkesës	Numri
Urdhër Mbrojtjet e Rregullta	509
Urdhrat për mbrojtje emergjente	101
Urdhrat e Përkohshëm të Mbrojtjes së Emergjencave	1
